

KODI ZGJEDHOR
TEKSTI I KONSOLIDUAR

(version jo zyrtar i përgatitur nga Shërbimi profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve)

(Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11

– Tekst i pastruar dhe 142/12)

I. DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Me këtë kod rregullohen mënyra, kushtet dhe procedura për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: kryetari i Republikës), për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: deputetët), për anëtarët e këshillave të komunave dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: anëtarët e këshillave), për zgjedhjen e kryetarit të komunave dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: kryetari i komunës), mënyra dhe procedura e evidentimit të së drejtës zgjedhore, mbajtja e Listës zgjedhore, përcaktimi i kufijve të njërive zgjedhore dhe përcaktimi, ndryshimi dhe shpallja e vendeve zgjedhore, si dhe kushtet për funksionimin e vendeve zgjedhore.

1. Lista emërore

Neni 2

Nocione të caktuara në këtë kod e kanë kuptimin si vijon:

1. "Të drejtë zgjedhore" ka secili shtetas i Republikës së Maqedonisë, me moshë të mbushur 18 vjeçare dhe i aftë për punë;
2. "Listë zgjedhore" është dokumenti publik në të cilën janë të regjistruar qytetarët me të drejtë zgjedhjeje;
3. "Organe zgjedhore janë organet kompetente për zbatimin e zgjedhjeve, të përcaktuara me këtë kod;
4. "Anëtar i organit zgjedhor" janë kryetari, anëtarët dhe zëvendësit e tyre, të cilët i përbëjnë organet zgjedhore dhe i zbatojnë veprimet zgjedhore;
5. "Paraqitës i listës" janë partitë politike të regjistruara ose koalicionet e tyre të regjistruara në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, grupe zgjedhësish dhe deputetë;
6. "Kandidat" është shtetasi i Republikës së Maqedonisë, i verifikuar nga komisioni kompetent zgjedhor në pajtim me këtë kod, për të cilin do të votohet në zgjedhje;
7. "Kandidat i pavarur" është kandidati për t'u zgjedhur kryetar i Republikës, deputet, kryetar komune ose anëtar këshilli, i cili përkrahet nga "një grup zgjedhësish";
8. "Parti politike" është partia politike e regjistruar në pajtim me ligjin;
9. "Pozita" përbëhet nga partitë politike në pushtet, të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar më shumë vota;
10. "Opozita" përbëhet nga partitë politike në opozitë, të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar më shumë vota;
11. "Përfaqësues i autorizuar" është personi i autorizuar nga një kandidat i regjistruar, parti politike ose koalicion, për përfaqësimin e interesave të tyre para organeve zgjedhore;
12. "Koalicion" është bashkimi në bazë të kontratës së dy apo më shumë partive politike të regjistruara për paraqitje të përbashkët gjatë kohës së mbajtjes së zgjedhjeve;
13. "Fushatë zgjedhore" është paraqitja publike e kandidatëve të verifikuar nga organet kompetente zgjedhore dhe programet e tyre në periudhën parazgjedhore për një lloj të caktuar të zgjedhjeve;
14. "Pjesëmarrësi i fushatës zgjedhore" është personi i autorizuar nga partia politike, koalicioni ose një grup zgjedhësish që e organizojnë fushatën zgjedhore;
15. "Vëzhgues" janë përfaqësuesit e shoqatave të regjistruara të vendit ose të jashtme të qytetarëve, që kanë autorizim nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për vëzhgimin e zgjedhjeve;

16. „Përfaqësitë diplomatiko konzulare të Republikës së Maqedonisë” janë përfaqësi të Republikës së Maqedonisë në shtete tjera dhe në organizata ndërkombëtare të cilat kryejnë punë tjera të vërtetuara me ligj;
17. „Shtetas të Republikës së Maqedonisë në punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit”, në kuptimin e këtij ligji, janë shtetas të Republikës së Maqedonisë të cilët e kanë paraqitur vendbanimin e fundit në Republikën e Maqedonisë, ndërsa ditën e zgjedhjeve përkohësisht qëndrojnë jashtë vendit më shumë se tre muaj ose në punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit më shumë se një vit në pajtueshmëri me evidencën e organeve kompetente;”.
18. “Të punësuar në administratën publike” e përbëjnë kategorinë e personave të punësuar në veprimtaritë e arsimit, shëndetësisë, kulturës, shkencës dhe mbrojtjes sociale, të cilët sipas ligjit kryejnë detyra me interes publik;
19. “Të punësuar në administratën shtetërore, komunale dhe administratën e Qytetit të Shkupit” e përbëjnë kategorinë e personave me statusin e nëpunësit shtetëror në pajtim me ligjin dhe
20. “Administratë zgjedhore” e përbëjnë të punësuarit në shërbimin profesional të Komisionit Shtetëror Zgjedhor, anëtarët e organet zgjedhore, sekretarët e komisioneve komunale zgjedhore, zëvendësit e tyre dhe persona tjerë të angazhuar për procesin zgjedhor në organet ndihmëse të Komisionit Shtetëror Zgjedhor.
21. "Proces zgjedhor" është koha nga miratimi i aktit të shpalljes së zgjedhjeve deri në publikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të mbajtura, në nivel të komunës, qytetit të Shkupit, respektivisht njësinë zgjedhore ku kryhet zgjedhja;
22. "Forma të paraqitjes mediatike zgjedhore" janë: emisione ditore informative, programe që u mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë pjesëmarrësve të fushatës zgjedhore te zgjedhësit dhe emisionet e veçanta informative
- 23.,, "Emisione ditore informative" janë të gjitha emisionet e radios dhe të lajmeve dhe ditarëve televizivë;
24. "Qasje e drejtpërdrejtë te zgjedhësit" janë format e prezantimit falas politik dhe të reklamimit të paguar politik, përmes të cilëve pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore lirshëm i promovojnë programet, qëndrimet dhe kandidatët e vet;
- 25.,, "Prezantim falas politik" është qasje e drejtpërdrejtë e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore te zgjedhësit, përmes së cilës lirshëm dhe pa kompensim në para promovohen programet zgjedhore, qëndrimet dhe kandidatët;”
- 26"Reklamim i paguar politik" është një qasje e drejtpërdrejtë e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore te zgjedhësit, përmes së cilës me kompensim në para promovohen programet zgjedhore, qëndrimet dhe kandidatët; Llojet e reklamimit të paguar politik janë: shpalljet, kumtesat, reklamat politike zgjedhore, reklamat muzikore që funksionojnë si himne të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, transmetimet ose incizimet e mitingjeve, takimeve dhe paraqitjet e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore
- 27"Programe të veçanta informative " janë: programet e dedikuara për informimin e qytetarëve për mënyrën dhe teknikën e votimit dhe për realizimin e të drejtës zgjedhore dhe programe informative politike të zhanreve të realizuara si intervista, debate ose duele në radio dhe televizion: programe aktuale-informative, programe aktuale me qasje dokumentare dhe programe të specializuara tematike informative dhe
- 28"Prezantim zgjedhor mediatik" është promovimi (i drejtpërdrejtë ose indirekt) i qëndrimeve,

programeve, platformave, arritjeve, aktiviteteve etj, të partive politike, koalicioneve, grupeve të zgjedhësve dhe përfaqësuesve të tyre. “

2. E drejta e barabartë zgjedhore

Neni 3

(1) "Për veprimet, aktet, parashtresat dhe shkresat e tjera në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve, furnizimin me mallra, punë dhe shërbime për nevojat e procesit zgjedhor, nuk paguhet doganë dhe tatim."

(2) Askush nuk guxon ta thërrasë zgjedhësin në përgjegjësi për shkak të votimit, as të kërkojë prej tij të tregoj se për cilin ka votuar ose përse nuk ka votuar.

3. Modeli zgjedhor

Neni 4

- (1) Zgjedhja e kryetarit të Republikës bëhet në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në përfaqësi diplomatike – konsullore të Republikës së Maqedonisë në Evropë dhe Afrikë, në Amerikën Veriore dhe Jugore dhe në Australi dhe Azi, si një njësi zgjedhore sipas modelit të shumicës.
- (2) Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë zgjidhen 123 deputetë, prej të cilëve 120 deputetë zgjidhen sipas modelit proporcional, me ç'rast territori i Republikës së Maqedonisë ndahet në gjashtë njësi zgjedhore të përcaktuara me këtë kod dhe në secilën zgjidhen nga 20 deputetë dhe tre deputetë zgjidhen sipas modelit të shumicës në rrethin e parë të zgjedhjeve dhe atë nga një deputet nga tre njësitë zgjedhore në Evropë dhe Afrikë, në Amerikën Veriore dhe Jugore dhe në Australia dhe Azi të vërtetuara me këtë kod.
- (3) Në njësitë zgjedhore numri i zgjedhësve mund të shmanget më së tepërmi prej minus 5% deri plus 5% në raport me numrin mesatar të zgjedhësve në njësinë zgjedhore me përjashtim në njësitë zgjedhore në Evropë dhe Afrikë, në Amerikën Veriore dhe Jugore dhe në Australi dhe Azi.
- (4) Zgjedhja e anëtarëve të këshillave bëhet në rajonin e komunës, përkatësisht të qytetit të Shkupit sipas modelit proporcional.
- (5) Zgjedhja e kryetarit të komunës bëhet në rajonin e komunës, përkatësisht të qytetit të Shkupit sipas modelit të shumicës.

4. Lista zgjedhore

Neni 5

- (1) Lista zgjedhore është dokument publik dhe mbahet për tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.
- (2) Në bazë të Listës zgjedhore zbatohen zgjedhjet dhe referendumi në nivel shtetëror e lokal në Republikën e Maqedonisë.

5. E drejta të zgjedhë dhe të zgjidhet

Neni 6

- (1) Të drejtë për zgjedhje ka secili shtetas i Republikës së Maqedonisë që ka mbushur 18 vjet moshë dhe është i aftë për punë dhe ka vendbanim të përhershëm në njësinë zgjedhore, komunën, përkatësisht, në qytetin e Shkupit ku bëhet zgjedhja.
- (2) Shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët ditën e zgjedhjeve janë në punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit, ndërsa janë të regjistruar në Listën zgjedhore në bazë të evidencës nga organi kompetent dhe paraqitje për votim, votojnë për zgjedhje të kryetarit të Republikës dhe për zgjedhje të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në përfaqësitë diplomatike – konzulare në

Republikën e Maqedonisë jashtë vendit, përkatësisht zyre konsullore në pajtueshmëri me përcaktimet e këtij kodi.

Neni 7

- (1) Kandidat për kryetar të Republikës mund të jetë personi që i plotëson kushtet për zgjedhje të kryetarit të Republikës të përcaktuara me Kushtetutën.
- (2) Kandidat për deputet, anëtar i këshillit dhe kryetar i komunës mund të jetë secili shtetas i Republikës së Maqedonisë, nëse:
 - ka mbushur 18 vjet dhe
 - është i aftë për punë
- (3) Kandidat për deputet, anëtar i këshillit dhe kryetar i komunës nuk mund të jetë personi i cili:
 - është i denuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për dënim me burg pa kushtë mbi gjashtë muaj, vuajtja e të cilit akoma nuk ka filluar dhe
 - gjendet në vuajtje të dënimit me burg për vepër të kryer penale
- (4) Përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni, kandidati për anëtar të këshillit dhe kryetar i komunës mund të jetë secili qytetar me vendbanim të përhershëm në komunë dhe në qytetin e Shkupit ku bëhet zgjedhja.

6. Jokoherenca e funksionit kryetar i Republikës, deputet kryetar i komunës dhe anëtar i këshillit

Neni 8

- (1) Funksioni deputet, anëtar i këshillit dhe kryetar i komunës është jokohorent me funksionin kryetar i Republikës së Maqedonisë, kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministër, gjykatës, prokuror publik, avokati publik, avokati i popullit dhe me bartës të tjerë të funksioneve që i zgjedh ose i emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Qeveria).
- (2) Funksioni deputet është jokohorent me funksionin kryetar komune dhe me anëtar të këshillit në komunë dhe në qytetin e Shkupit.
- (3) Funksioni deputet dhe kryetar i komunës është jokohorent, me:
 - kryerjen e detyrave profesionale dhe administrative në organet e administratës shtetërore,
 - kryerjen e veprimtarisë ekonomike ose veprimtarisë tjetër fitimprurëse, dhe
 - anëtarësimin në këshilla drejtuese të ndërmarrjeve publike, institucioneve publike, fondeve, agjencive, enteve dhe në personat tjerë juridik, si dhe me zgjedhjen e përfaqësuesit të kapitalit shtetëror dhe shoqëror në shoqëritë tregtare.
- (4) Funksioni kryetar i qytetit të Shkupit dhe funksioni anëtar i Këshillit të qytetit të Shkupit është jokohorent me funksionin e kryetarit të komunës dhe funksionin anëtar i këshillit të komunave në rajonin e qytetit të Shkupit.
- (5) Me ditën e verifikimit të mandatit për deputet dhe kryetar të komunës, bartësve të funksioneve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, funksioni u shuhet.
- (6) Me ditën e verifikimit të mandatit për deputet dhe kryetar të komunës, personave nga paragrafi (3) alineja 1 e këtij neni, vendi i punës u pezullohet
- (7) Me ditën e verifikimit të mandatit për deputet dhe kryetar të komunës, personave nga paragrafi (3) alinetë 2 dhe 3 të këtij neni marrëdhënia e punës në veprimtaritë ekonomike ose veprimtari tjetër fitimprurëse u pezullohet, ndërsa anëtarësimi në këshillat drejtuese të ndërmarrjeve publike, institucionet publike, fondet, agjencitë, entet dhe në personat e tjerë juridik dhe si përfaqësues i kapitalit shtetëror e shoqëror në shoqëritë tregtare u pushon.
- (8) Me ditën e verifikimit të mandatit të anëtarit të këshillit, personave të punësuar në administratën komunale të komunës dhe administratën e qytetit të Shkupit, marrëdhënia e punës u pezullohet në pajtim me ligjin.

Neni 8-a

"(1) Nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Maqedonisë, deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve, si dhe nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve për kryetar komune ose anëtarë të këshillit, respektivisht deri në konstituimin e këshillit komunal dhe qytetit të Shkupit nuk mund:

- të disponohet me mjete buxhetore të Republikës së Maqedonisë, mjete të buxheteve të komunave dhe qytetit të Shkupit, të fondeve publike dhe mjete të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike ose personave juridikë që disponojnë me kapital shtetëror,

- të fillojë ndërtimi me mjete nga buxheti ose nga fonde publike ose mjete të ndërmarrjeve publike dhe personave tjerë juridikë që disponojnë me kapital shtetëror të objekteve të reja të infrastrukturës si rrugë, ujësjellës, largpërçues, kanalizim, terrene sportive dhe objekte tjera; ose objekte për veprimtari shoqërore, shkolla, çerdhe dhe objekte tjera, përveç nëse për këtë qëllim paraprakisht janë siguruar mjete nga buxheti, respektivisht bëhet fjalë për realizimin e programit të miratuar në bazë të ligjit në vitin vijues dhe

të kryhen pagesa të rrogave, pensioneve, ndihmës sociale ose pagesa tjera dhe kompensime materiale nga mjete buxhetore ose nga mjete të fondeve publike që nuk janë mjete pagesore të rregullta mujore, respektivisht të gjitha transferet njëvjeçare dhe pagesa të transfereve të njëhershme nga mjete buxhetore ose nga mjete të fondeve publike, as të tjetërsohet kapitali shtetëror ose të nënshkruhen marrëveshje kolektive.

(2) Në periudhë prej 20 ditësh para fillimit të fushatës zgjedhore deri në përfundimin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Maqedonisë, deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjen e Qeverisë së

Republikës së Maqedonisë në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve, si dhe nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve për kryetar komune ose anëtarë të këshillit, respektivisht deri në konstituimin e këshillit komunal dhe qytetit të Shkupit nuk mund:

- të paguhen subvencionet që nuk janë pagesa të rregullta mujore dhe

- të mbahen ngjarje publike me rastin e fillimit të ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objekteve me mjete nga Buxheti ose fonde publike, ose me mjetet e ndërmarrjeve publike ose personave tjerë juridikë që disponojnë me kapital shtetëror, në infrastrukturë si rrugë, ujësjellës, largpërçues, kanalizim, terrene sportive ose objekte për veprimtari shoqërore, çerdhe si dhe objekte të tjera. Me ndalim të mbajtjes së ngjarjeve publike nuk nënkuptohet, veçanërisht: dhënia e deklaratës publike e bartësit të funksionit publik ose kandidatit për bartës të funksionit publik në miting, intervistë në medie, debat në medie ose përgjigje të pyetjes së gazetarëve.

- (3) Nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Maqedonisë, deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve, si dhe nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve për kryetar komune ose anëtarë të këshillit, respektivisht deri në konstituimin e këshillit komunal dhe qytetit të Shkupit, Ministria e Financave është e obliguar që tërë pagesat buxhetore, përveç rrogave të rregullta, pensionet dhe shpenzimet komunale, t'i publikojë në faqen e internetit në bazë të veçantë të shpenzimeve buxhetore në periudhën zgjedhore.

(4) Ministria e Financave, dy javë pas shpalljes së zgjedhjeve parashtron raport parazgjedhor financiar në të cilin do të përfshihet pasqyrimi i të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara nga Buxheti sipas zërave, në periudhën prej fillimit të vitit fiskal deri në ditën e parashtrimit të raportit që publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Financave

Neni 9

- (1) Pjesëtarëve të forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë, pjesëtarëve të pjesës së uniformuar të policisë, personave zyrtarë të autorizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Agjencinë për Zbulim, nga dita kur do të konfirmohen si kandidatë, vendi i punës u pezullohet.
- (2) Me ditën e verifikimit të mandatit të personave nga paragrafi (1) i këtij neni, vendi i punës u pezullohet.

7. Profesionaliteti dhe parevokueshmëria e funksionit

Neni 10

- (1) Deputetët nuk mund të revokohen.
- (2) Funksioni deputet dhe kryetar i komunës kryhet profesionalisht.

8. Lirimi nga pagesa e tatimit, doganës dhe taksës

Neni 11

- (1) Për veprimet, aktet, parashtrësat dhe shkresat e tjera lidhur me zbatimin e zgjedhjeve, në procedurën zgjedhore, shërbimi botimi i fletëvotimeve dhe furnizimi dhe importi i materialit zgjedhor nuk paguhet doganë dhe tatim.
- (2) Të gjitha veprimet dhe aktet e organeve shtetërore, të gjitha parashtrësat dhe dëshmitë lidhur me evidencën e së drejtës zgjedhore, lirohen nga pagesa e taksave dhe tatimit.
- (3) Ministri i Financave do të miratojë dispozita me të cilat në mënyrë unike do të rregullojë veprimin gjatë tatimit me tatim mbi vlerën e shtuar të qarkullimit të fletëvotimeve dhe materialit zgjedhor, të nevojshëm për realizimin e zgjedhjeve si dhe doganimin e tyre.

II. SHPALLJA DHE MBAJTJA E ZGJEDHJEVE

1. Shpallja e zgjedhjeve

Neni 12

- (1) Akti për shpalljen e zgjedhjeve e merr kryetari i Kuvendit dhe me të caktohet dita kur fillojnë të rrjedhin afatet për zbatimin e veprimeve zgjedhore dhe dita e mbajtjes së zgjedhjeve.

- (2) Akti për shpalljen e zgjedhjeve dorëzohet te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve , Ministria e PUNEVE te Jashteme dhe te Ministria e Drejtësisë.
- (3) Akti për shpalljen e zgjedhjeve shpallet në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.
- (4) Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, nuk mund të kalojnë më shumë se 90 ditë, as më pak se 70 ditë.

2. Njoftimi për mbajtjen e zgjedhjeve

Neni 13

- (1) Qytetarët për mbajtjen e zgjedhjeve njoftohen përmes thirrjes publike dhe vendosjes së afisheve në vende të dukshme.
- (2) Njoftimin nga paragrafi (1) i këtij neni, e bën komisioni kompetent i zgjedhjeve.

3. Mbajtja e zgjedhjeve

Për kryetar të Republikës

Neni 14

- (1) Zgjedhja e kryetarit të Republikës bëhet në 60 ditët e fundit të mandatit të kryetarit të mëparshëm.
- (2) Në rastin e ndërprerjes së mandatit të kryetarit të Republikës, për çfarëdo shkaqesh, zgjedhja për kryetar të ri bëhet në afat prej 40 ditësh, nga dita e ndërprerjes së mandatit.

Për deputetë

Neni 15

- (1) Zgjedhjet për deputetë mbahen në çdo katër vjet, në 90 ditët e fundit të mandatit të përbërjes paraprake të deputetëve, ose në afat prej 60 ditësh nga dita e shpërndarjes së shpërndarjes së Kuvendit.
- (2) Zgjedhje të parakohshme për deputetë zbatohet/n në pajtueshmëri me dispozitat e këtij kodi, ndërsa të gjitha afatet për veprimet zgjedhore shkurtohen për pesë ditë, përveç afatit të përcaktuar për zbatimin e fushatës zgjedhore.
- (3) Afatet për zbatimin e veprimeve zgjedhore nga paragrafi (2) i këtij neni me afate i përcakton Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.
- (4) Mandati i deputetëve zgjat nga dita e verifikimit të tij, deri në ditën e verifikimit të mandatit të deputetëve të rinj të zgjedhur, por jo më gjatë se katër vite.

Për anëtarë të këshillit dhe për kryetar të komunës

Neni 16

- (1) Zgjedhjet për anëtarë të këshillit dhe për kryetar të komunës mbahen në çdo katër vite njëkohësisht në të gjitha komunat, **në gjysmën e parë të muajit maj**.
- (2) Zgjedhjet e parakohshme për anëtarë të këshillit dhe për kryetar të komunës, shpallen dhe zbatohen sipas dispozitave të këtij kodi, kurse pas plotësimit të kushteve për ndërprerjen e mandatit, të përcaktuar me Ligjin për vetëqeverisje lokale.
- (3) Zgjedhjet e parakohshme për anëtarë të këshillit dhe për kryetar të komunës nuk mund të zbatohen nëse deri në zgjedhjet e rregullta ka më pak se gjashtë muaj.

III. ORGANE PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

1. Llojet e organeve zgjedhore

Neni 17

Organet për zbatimin e zgjedhjeve janë:

- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve,

- Komisionet komunale zgjedhore dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit
- Këshillat zgjedhore dhe
- Këshilli zgjedhor për votim në përfaqësitë diplomatike konsullore në Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejme :PDK) **“përkatësisht zyra konsullore”.**

2. Anëtar i organit zgjedhor

Neni 18

- (1) Anëtar i organit zgjedhor nuk mund të jetë:
 - personi i dënuar për vepër ndëshkuese lidhur me zgjedhjet, dhe
 - Personi që paraprakisht ka marrë pjesë në zbatimin e zgjedhjeve dhe në punën e të cilit si anëtarë i organit zgjedhor, janë konfirmuar parregullsi për të cilat është anuluar votimi.
 - **personi që nuk i plotëson kushtet e veçanta të përcaktuara me këtë ligj**
- (2) Në komisionin komunal të zgjedhjeve, përkatësisht Këshilli zgjedhor i Qytetit të Shkupit dhe Këshilli zgjedhor, anëtarë nuk mund të jenë as:
 - funksionarë të zgjedhur ose të emëruar nga Qeveria, përkatësisht Kuvendi, dhe persona të punësuar në administratën shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Sektoriat për legjislacion, Enti Shtetëror i Statistikës, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Qendra për Menaxhim me Krizat, shërbimi profesional i Gjykatës administrative, shërbimi profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, shërbimi profesional i Komisionit shtetëror për ndalim të korrupsionit **dhe të punësuarit në Shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike**
- (3) Personi i zgjedhur për anëtarë të organit zgjedhor, mund të mos pranojë që ta kryejë atë detyrë, vetëm për shkaqe shëndetësore ose familjare, me ç’rast për mospranimin e anëtarit vendos organi që e ka zgjedhur, në bazë të dokumentacionit përkatës të ofruar.
- (4) Kryerja e punëve dhe e detyrave të punësuarve në organet e pushtetit shtetëror në ditën e zgjedhjeve, ndërsa për shkak realizimit të së drejtës së tyre te zgjedhjes, organizohet me ndëresa .

Neni 19

- (1) Kryetari dhe anëtarët e organeve zgjedhore, funksionin e tyre e kryejnë pa anim, me vetëdije dhe përgjegjësi në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë kod.
- (2) Kryetari dhe anëtarët e organeve zgjedhore, **dhe administratës zgjedhore”.** kanë të drejtë kompensimi që përcaktohet me aktin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

3. Jokoherenca e funksionit anëtar i organit zgjedhor

Neni 20

Nëse kryetari, anëtari i organit zgjedhor, sekretari, si dhe zëvendësi i tyre, e pranon kandidimin për kryetar të Republikës, deputet, anëtarë të këshillit dhe kryetar komune, funksioni i kryetarit, anëtarit, sekretarit, përkatësisht zëvendësit në organet zgjedhore, u pushon.

4. Parimi i përfaqësimit përkatës e të drejtë dhe gjinor në organet zgjedhore

Neni 21

- (1) Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, zbatohet principi i përfaqësimit përkatës dhe të drejtë.
- (2) Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe këshillave zgjedhore, përkatësisht në Komisioni zgjedhor i qytetit të Shkupit, në komunat ku jetojnë së paku 20% të

qytetarëve pjesëtarë të bashkësive të tjera, shprehet principi i përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të të gjitha bashkësive.

- (3) Në përbërjen e organeve zgjedhore, secila gjini do të përfaqësohet së paku me 30%.
- (4) **Për zbatimin e paragrafeve (1), (2) dhe (3) të këtij neni, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, me akt e përcakton përbërjen e anëtarëve të komisioneve zgjedhore komunale, respektivisht Komisionit Zgjedhor të qytetit të Shkupit dhe këshillat zgjedhore.**
- (5) Vendimet për emërimin e anëtarëve të komisioneve komunale përkatësisht Komisionit Zgjedhor të Qytetit të Shkupit botohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

5. Propozimi i përfaqësuesit të parashtruesit të listës

Neni 22

- (1) Secili paraqitës i listës së kandidatëve për zgjedhjen e kryetarit të Republikës, të deputetëve, të anëtarëve të këshillit dhe kryetarit të komunës, ka të drejtë të caktojë përfaqësuesin dhe zëvendësin e tij, të cilët do ta përcjellin punën e organeve zgjedhore prej fillimit të zgjedhjeve deri në verifikimin dhe shpalljen e rezultateve.
- (2) Secili parashtrues i listës së kandidatëve për zgjedhje të kryetarit të Republikës ose deputetëve për votim në njësitë zgjedhore në Evropë dhe Afrikë, Amerika Veriore dhe Jugore dhe Australi dhe Azi, përcakton përfaqësues të autorizuar dhe zëvendës të tij në Republikën e Maqedonisë të cilët do ta vëzhgojnë punën e organeve zgjedhore nga fillimi i zgjedhjeve deri te verifikimi dhe paraqitja e rezultateve përfundimtare.
- (3) Përfaqësuesi i autorizuar dhe zëvendësi i tij para organeve zgjedhore nga neni (1) dhe (2) i këtij neni , nuk mund të jetë person i paraqitur si kandidat”.
- (4) Parashtruesi i listës , përfaqësuesit i jep autorizim dhe për këtë i njofton organet zgjedhore, më vonë dy ditë para ditë së zgjedhjeve.
- (5) Përfaqësuesi i paraqitësit të listës në mbledhjen e organeve zgjedhore, mund të paralajmërojë për parregullsitë në punën e tyre, e nëse nuk pranohet paralajmërimi, mund të kërkojë që ky të futet në procesverbal.
- (6) “Përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesit të listës është i detyruar të mbajë identifikim me numrin e vendvotimit për të cilën është e autorizuar të kryej mbikëqyrje”.
- (7) Përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesit të listës ka të drejtë në mbledhje të organit zgjedhor të kërkojë dhe të kryej mbikëqyrje të plotë në dokumentimin e plotë të organit zgjedhor.

6. Mënyra e punës së organeve zgjedhore

Neni 23

- (1) Organet zgjedhore mund të punojnë dhe të marrin vendime nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve, ndërsa vendimet i marrin me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.
- (2) Në rast të mungesës së anëtarit të komisionit komunal të zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni zgjedhor i qytetit të Shkupit, ose të anëtarit të këshillit zgjedhor, në punën e mbledhjeve marrin pjesë zëvendësit e tyre.
- (3) Gjatë zbatimit të zgjedhjeve në punën e komisioneve komunale të zgjedhjeve, përkatësisht, Komisioni zgjedhor i qytetit të Shkupit dhe këshillat zgjedhorë, në komunat ku së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare që dallon nga gjuha maqedonase, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik,

në përdorim zyrtar është edhe gjuha dhe alfabeti të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve të asaj komune.

Neni 24

Puna e organeve zgjedhore është publike dhe të drejtë pjesëmarrjeje në punën e organeve zgjedhore kanë përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave dhe vëzhguesit e akredituar.

7. Përkrahja e punës së organeve zgjedhore

Neni 25

- (1) Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Enti Shtetëror i Statistikës dhe Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta në Qeverinë dhe njësitë rajonale të tyre, si dhe komunat dhe qyteti i Shkupit, janë të obliguara që organeve për zbatimin e zgjedhjeve t'u sigurojnë kushte teknike, hapësinore dhe të tjera për punë.
- (2) Për kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, organeve u sigurohen mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

8. KOMISIONI SHETETËROR I ZGJEDHJEVE

8.1. Përbërja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve

Neni 26

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe pesë anëtarë.
- (2) Kryetari dhe nënkryetari janë anëtarë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (3) Kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, funksionin e kryejnë në mënyrë profesionale me të drejtë rizgjedhje.
- (4) Kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve zgjidhen në afat prej 60 ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes konstitutive në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë /për kohë prej katër vjetësh.
- (5) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka sekretar të përgjithshëm dhe zëvendësin e tij.
- (6) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka cilësinë e personit juridik.
- (7) Mjetet për punën e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.
- (8) Sipas rregullës mbledhje të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve konvokon dhe me të udhëheq kryetari i Komisionit Shtetëror Zgjedhor.
- (9) Në rast të mungesës ose paaftësisë së kryetarit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, mbledhjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve e cakton dhe me të udhëheq kryetari i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (10) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve do të mbaj mbledhje dhe në propozim të antarit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, nëse propozimi mbeshtet nga shumica e numrit të përgjithëm të anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Zgjedhja e përbërjes së Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve

Neni 27

- (1) Për kryetar, nënkryetarë dhe anëtarë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, mund të zgjidhet personi që i plotëson kushtet, si vijojnë:
 - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë;
 - të jetë jurist i diplomuar dhe së paku tetë vjet përvojë pune në sferën juridike.

- të mos jetë anëtar i organit të partisë politike.
- (2) Kuvendi e shpall zgjedhjen e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në shtypin ditor. Shpallja zgjat tetë ditë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".
- (3) Komisioni për çështjet e zgjedhje dhe emërimi i Kuvendit, përgatit propozim-listën nga kandidatët e paraqitur dhe e dorëzon në Kuvend.
- (4) Nga kandidatët e propozim-listës, partitë politike në opozitë propozojnë kryetarin dhe dy anëtarë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërsa partitë në pushtet propozojnë nënkryetar dhe tre anëtarë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (5) Kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve i zgjedh Kuvendi me shumicë prej dy të tretat e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.
- (6) Kryetarit, nënkryetari dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nga dita e zgjedhjes, u pezullohet marrëdhënia e punës.

Përfundimi i funksionit në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve para skadimit të mandatit.

Neni 28

- (1) Funksioni i kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve u pushon para skadimit të mandatit:
 - nëse ndërpritet njëri nga shkaqet e përcaktuara në nenin 27 paragrafi (1) të këtij kodi:
 - me kërkesën e tyre personale;
 - për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të papërgjegjshme të funksionit;
 - për shkak të plotësisht të kushteve për pension të pleqërisë me ligj;
 - për shkak të vdekjes; dhe
 - nëse është dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me dënim me burg mbi gjashtë muaj.
- (2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, mund të paraqesë propozim në Komisionin për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve të Kuvendit, për shkarkimin e anëtarit të tij për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit.

Afati për propozimin e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve

Neni 29

- (1) Kryetari i Kuvendit i njofton partitë politike nga neni 27 paragrafi (4) i këtij kodi në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të njoftimit, që t'ia dorëzojë propozimin për kryetar dhe dy anëtarë, përkatësisht nënkryetar dhe anëtarë dhe tre anëtarë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (2) Nëse partitë politike nuk i verifikojnë dhe nuk i paraqesin emrat e kryetarit dhe nënkryetarit dhe anëtarit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në afatin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, kryetarin nënkryetarin dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve i propozon Komisioni për çështjet e zgjedhjeve dhe emërimeve i Kuvendit.

8.2. Shërbimi profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve

Neni 30

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve emëron sekretarin e përgjithshëm dhe zëvendësin e tij nga radhët e juristëve të diplomuar në kohëzgjatje prej pesë vjetësh.
- (2) Sekretari i përgjithshëm nuk hyn në përbërjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe nuk ka të drejtë vote.
- (3) Sekretari i përgjithshëm punën e tij e kryen profesionalisht.

- (4) Për kryerjen e punëve profesionale administrative dhe teknike organizative të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, formohet shërbimi profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (5) Me shërbimin profesional udhëheq sekretari i përgjithshëm i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (6) Sekretari i përgjithshëm dhe të punësuarit në shërbimin profesional të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, kanë statusin e nëpunësve shtetërorë.

8.3. **Kompetencat e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve**

Neni 31

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve kujdeset për ligjshmërinë në përgatitjen dhe realizimin e zgjedhjeve në pajtim me këtë kod dhe bën mbikëqyrje të punës së organeve zgjedhore.
- (2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
 - 1) kërkon të dhëna nga organet kompetente për të punësuarit në administratën shtetërore, komunale dhe të Qytetit të Shkupit, si dhe për administratën publike dhe e emëron përbërjen e komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe Komisionin Zgjedhor të Qytetit të Shkupit;
 - 2) jep udhëzime, sqarime dhe rekomandime për zbatimin e dispozitave të këtij kodi dhe të ligjeve të tjera, që kanë të bëjnë me çështje të lidhura me zgjedhjet;
 - 3) e shkarkon secilin anëtar të organit zgjedhor në rast të punës së kundërligjshme;
 - 4) e kontrollon ligjshmërinë në punën e organeve zgjedhore dhe ndërmerr masa kur konstatohet cenimi i ligjshmërisë në përgatitjen, procedurën e kandidimit, zbatimin dhe konfirmimin e rezultateve nga zgjedhjet, si dhe në zbatimin e udhëzimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga ai;
 - 5) i konfirmon dhe shpall listat e kandidatëve për zgjedhjen e kryetarit, dhe për zgjedhjen e deputetëve dhe me short e përcakton radhitjen e tyre;
 - 5a) me short e përcakton radhitjen e listës së vetme të kandidatëve për anëtarë të këshillit, përkatësisht kryetar të komunës.
 - 6) miraton program dhe zbaton standarde për edukimin e detyrueshëm të të gjitha organeve zgjedhore dhe e koordinon të njëjtin;
 - 7) bën edukimin e detyrueshëm të anëtarëve të komisioneve komunale zgjedhore, përkatësisht Komisionit Zgjedhor të Qytetit të Shkupit para çdo zgjedhje dhe u lëshon certifikata, në mënyrë dhe afate të përcaktuara me program;
 - 8) e përpilon formularin e certifikatës për përcjelljen e trajnimit të anëtarëve të organeve zgjedhore;
 - 9) përcakton standarde unike për materialin zgjedhor, kujdeset për sigurimin e tij dhe e përcakton llojin e mjetit me të cilin shënohen dhe kontrollohen personat që kanë votuar (llambat UV, spërkatja dhe jastëku prej grafiti);
 - 10) përpilon formularë për zbatimin e zgjedhjeve dhe formularë për grumbullimin e nënshkrimeve nga zgjedhësit dhe deputetët për propozimin e kandidatëve, dhe i shpall në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë";
 - 11) e përcakton mënyrën e përdorimit dhe ruajtjes së materialit zgjedhor;
 - 12) e përcakton cilësinë, formën, madhësinë, ngjyrën dhe numrat serikë të fletëvotimeve;
 - 13) e organizon shtypjen e fletëvotimeve dhe të listave të kandidatëve dhe furnizimi i sistemit të identifikimit të zgjedhësit
 - 14) e dorëzon, pranon dhe ruan materialin zgjedhor në komisione dhe prej komisioneve komunale të zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit;
 - 14a) E ruan materialin zgjedhor nga zgjedhjet për kryetar të Republikës, për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe referendum në nivel shtetëror.
 - 15) e informon dhe edukon opinionin për mënyrën e votimit dhe për zbatimin e së drejtës zgjedhore;
 - 16) miraton kodeksin për rregullat e vëzhgimit në zgjedhje të vëzhguesve vendorë dhe të huaj në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe u siguron dokumente për identifikim;
 - 17) bën kontrollin e vendvotimeve në ditën e zbatimit të zgjedhjeve ku janë paraqitur parregullsi gjatë

- votimit;
- 18) i konfirmon me aktvendim listat e pranuar të kandidatëve ose i refuzon, nëse nuk janë përpiluar në pajtim me dispozitat e këtij kodi;
 - 19) miraton rregullore me të cilën përcaktohen kriteret për mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes dhe shkarkimit të kryetarit, zëvendësit të tij, anëtarëve dhe zëvendësve të tyre në organet zgjedhore;
 - 20) i mbledh dhe konfirmon rezultatet nga votimi për listat e kandidatëve në nivelin e njësisë zgjedhore;
 - 21) i shpall rezultatet e para nga zgjedhjet e zbatuara për kryetar të Republikës, për deputetë, për këshilltarë dhe kryetar të komunës, në bazë të të dhënave nga procesverbalet e organeve zgjedhore;
 - 22) i shpall rezultatet përfundimtare nga zgjedhjet e zbatuara;
 - 23) u lëshon certifikata kandidatit të zgjedhur për kryetar të Republikës dhe kandidatëve të zgjedhur për deputetë;
 - 24) miraton rregullore dhe udhëzim për kompensimin e anëtarëve të organeve zgjedhore dhe administratën zgjedhore, në bazë të numrit të zgjedhësve, llojit, ndërlikueshmëria si dhe vëllimi i punëve dhe kohëzgjatja e përfundimit të tyre;
 - 25) në Kuvend paraqet raport për zgjedhjet e zbatuara dhe pasqyrën financiare, dhe e shpall në faqen e vet të internetit;
 - 26) bën shpërndarjen e kompensimit të shpenzimeve kandidatëve të zgjedhur pas raportit financiar të paraqitur, dhe e shpall në faqen e vet të internetit;
 - 27) e miraton aktin për organizimin dhe sistematizimin e shërbimit profesional të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe formon organe ndihmëse;
 - 28) i boton në shtypin ditor përshkrimet e vendvotimeve;
 - 29) bën evidencë të së drejtës për zgjedhje dhe kujdeset për të dhënat personale të qytetarëve të përmbajtura në Listën zgjedhore;
 - 30) bën kontrollin e integritetit të bazës së të dhënave të Listës zgjedhore;
 - 31) e nënshkruan Listën zgjedhore, përkatësisht ekstraktet e Listës zgjedhore në të cilat votohet, më së voni 15 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve;
 - 32) realizon kontakte me asociacionet dhe organizatat ndërkombëtare që kanë autorizim t'i vëzhgojnë zgjedhjet, përkatësisht referendumin në nivel shtetëror, për çështje të lidhura me Listën zgjedhore;
 - 33) paraqet të dhëna në mjetet e informimit publik për numrin e zgjedhësve të regjistruar në Listën zgjedhore të nënshkruar, përkatësisht certifikatat;
 - 34) miraton Rregullore me të cilën rregullohet mënyra e punës dhe vendosja e anëtarëve në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - 35) vendos për kundërshtimet në bazë të inspektimit në materialin zgjedhor dhe provave të tjera
 - 36) në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, miraton rregullore për mënyrën e veprimit të policisë gjatë kohës së mbajtjes së zgjedhjeve;
 - 37) sjell udhëzim për zgjidhje të kundërshtimeve dhe ankesave;
 - 38) e vëzhgon fillimin dhe përfundimin e fushatës zgjedhore dhe merr masa të parapara me këtë kod;
 - 39) e cakton formularin për paraqitje të votimit në PDK **përkatësisht zyra konsullore;**
 - 40) i formon këshillat e zgjedhjeve për votim të PDK **dhe këshilli zgjedhor për votim të anëtarëve të këshillave zgjedhore në PDK, respektivisht zyrat konsullore**
 - 41) **40-a) miraton Udhëzim për organizimin e votimit për anëtarët e këshillave zgjedhore në PDK, respektivisht në zyrat konsullore**
 - 42) e dorëzon dhe e pranon materialin zgjedhor të dhe nga këshilli zgjedhor për votim të PDK, nëpërmjet Ministrisë të Punëve të Brendshme;

- 43) i mbledh dhe i verifikon rezultatet nga votimi për listën e kandidatit për zgjedhje të tre deputetëve, nga një nga njësia zgjedhore për teorinë në Evropë dhe Afrikë, në Amerikën Veriore dhe Jugore dhe në Australi dhe Azi;
- 44) plotëson dhe dorëzon të dhëna statistikore për nevojat e Entit Shtetëror të Statistikës të Republikës së Maqedonisë;
- 43-a) publikisht i shpall çmimet e mediave të shtypura dhe të radios në faqen e tyre të internetit;
- 43b) për seancat e veta ka procesverbale dhe procesverbalet e miratura i publikon në faqen e tyre të internetit në afat prej 48 orësh nga dita e miratimit".

dhe

- 45) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me këtë kod.
- (3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ngrit iniciativë për procedurë disiplinore, udhëheq procedurë të shkeljes, ose parashtron akuzë penale deri te organi kompetent, gjatë ekzistimit të bazave për dyshim se është bërë shkelje e dispozitave të këtij kodi.
- (4) Formularët dhe materiali i tërësishëm zgjedhor në komunat ku së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare që dallon nga gjuha maqedonase, shtypen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin që e flasin së paku 20% të qytetarëve të asaj komune.
- (5) Formularët dhe materiali i plotë i zgjedhjeve për njësitë zgjedhore me numër 7, 8 dhe 9 nga ky ligj, ku së paku 20% e votuesve të regjistruar në listën zgjedhore për atë njësi zgjedhore, flasin gjuhë zyrtare që dallon nga gjuha maqedone, shtypen në gjuhën maqedone dhe alfabetin e saj cirilik në listën zgjedhore për atë njësi zgjedhore.
- (6) Të drejtë pjesëmarrjeje gjatë punës dhe vendimmarrjes të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve kanë përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave, për kundërshtimet e të cilëve vendoset.

Neni 32

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në afat prej tri ditësh nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, paraqet kërkesë në organin e administratës shtetërore kompetent për udhëheqje të evidencës të nëpunësve shtetëror dhe publik dhe organet kompetente për paraqitjen e të dhënave për të punësuarit në administratën shtetërore dhe komunale, në administratën e Qytetit të Shkupit, si dhe në administratën publike, të sistemuar nëpër komuna sipas adresës së vendbanimit.
- (2) Organet nga paragrafi (1) i këtij neni, të dhënat në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve i dorëzojnë në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

9. KOMISIOM KOMUNAL I ZGJEDHJEVE

9.1. Zgjedhja dhe përbërja e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve

Neni 33

- (1) Komisionet komunale të zgjedhjeve formohen në:

Komunat me seli në qytet	Komunat me seli në fshat	Komunat në qytetin e Shkupit
1) komuna e Berovës	34) komuna e Haračinës	71) komuna e Aerodromit
2) komuna e Manastirit	35) komuna e Bosilevës	72) komuna e Butelit
3) komuna e Bogdancit	36) komuna e Bërvenicës	73) komuna e Gazi Babës
4) komuna e Valandovës	37) komuna e Vasilevës	74) komuna e Gjorçe Petrovit
5) komuna e Velesit	38) komuna e Vevčanit	75) komuna e Karposhit
6) komuna e Vinicës	39) komuna e Vrapçishtës	76) komuna e Kisella Vodës
7) komuna e Gjevgjelijës	40) komuna e Gradskos	77) komuna e Sarajit
8) komuna e Gostivarit	41) komuna e Debarcës	78) komuna e Qendrës

- | | | |
|-----------------------------------|-------------------------------------|--|
| 9) komuna e Dibrës | 42) komuna e Dojranit | 79) komuna e Çairit |
| 10) komuna e Dellçevës | 43) komuna e Dollnenit | 80) komuna e Shuto Orizarit |
| 11) komuna e Demir Kapisë | 44) komuna e Zhelinës | 81) qyteti i Shkupit (ky komision zgjedhor formohet vetëm për zbatimin e zgjedhjeve për kryetar të komunës dhe anëtarë të Këshillit të qytetit të Shkupit) |
| 12) komuna e Demir Hisarit | 45) komuna e Zelenikovës | |
| 13) komuna e Kavadarcit | 46) komuna e Zërnovcit | |
| 14) komuna e Kërçovës | 47) komuna e Ilindenit | |
| 15) komuna e Koçanit | 48) komuna e Jegunovcit | |
| 16) komuna e Kratovës | 49) komuna e Bogovinjës | |
| 17) komuna e Kriva Pallankës | 50) komuna e Karbincit | |
| 18) komuna e Krushevës | 51) komuna e Konçës | |
| 19) komuna e Kumanovës | 52) komuna e Krivogashtanit | |
| 20) komuna e Makedonska Kamenicës | 53) komuna e Likovës | |
| 21) komuna e Makedonski Brod | 54) komuna e Llozovës | |
| 22) komuna e Negotinës | 55) komuna e Mavrovës dhe Rostushës | |
| 23) komuna e Ohrit | 56) komuna e Mogillës | |
| 24) komuna e Pehçevës | 57) komuna e Novacit | |
| 25) komuna e Prilepit | 58) komuna e Novo Sellës | |
| 26) komuna e Probishtipit | 59) komuna e Petrovecit | |
| 27) komuna e Radovishit | 60) komuna e Pllasnicës | |
| 28) komuna e Resnjës | 61) komuna e Rankovcit | |
| 29) komuna e Sveti Nikollës | 62) komuna e Rosomanit | |
| 30) komuna e Strugës | 63) komuna e Sopishtes | |
| 31) komuna e Strumicës | 64) komuna e Nagoriçit të Vjetër | |
| 32) komuna e Tetovës | 65) komuna e Studeniçanit | |
| 33) komuna e Shtipit | 66) komuna e Tearcës | |
| | 67) komuna e Qendrës Zhupa | |
| | 68) komuna e Çashkës | |
| | 69) komuna e Çeshinovës Obleshevës | |
| | 70) komuna Çuçer – Sandevë | |

(2) Komisionet komunale të zgjedhjeve janë me seli në komunat e përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, dhe janë kompetente për zbatimin e veprimeve zgjedhore në njësitë zgjedhore dhe vendvotimet e përcaktuara me këtë kod

Neni 34

- (1) Komisioni Komunal i Zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë.
- (2) Kryetari dhe nenet nga paragrafi (1) të këtij neni kanë zëvendës.
- (3) Kryetarët e komisioneve komunale, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, ka sekretar dhe zëvendës i tij që zgjidhen nga të punësuarit në administratën shtetërore, administratën komunale dhe administratën e qytetit të Shkupit, me arsimim sipëror sipas zgjedhjes së rastit në kohëzgjatje prej pesë vitesh.
- (4) Kryetarët e komisioneve komunale të zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit dhe zëvendësit e tyre, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga të punësuarit në administratën shtetërore, komunale të qytetit të Shkupit, me arsimim sipëror sipas zgjedhjes së rastit në kohëzgjatje prej pesë vitesh.
- (5) Sekretari dhe zëvendësi i tij nga paragrafi (2) i këtij neni, kryejnë punët profesionale administrative dhe organizative teknike të Komisionit komunal të zgjedhjeve.

Neni 35

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në afat prej pesë ditësh nga dita e marrjes së të dhënave në pajtim me nenin 32 të këtij kodë, i formon komisionet komunale të zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit. Vendimet me të cilat formohen komisionet komunale zgjedhore, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit shpallen në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".
- (2) Mënyra dhe procedura për emërimin e kryetarit, zëvendësit të tij, anëtarëve dhe zëvendësve të tyre të komisioneve komunale të zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, rregullohen me aktin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (3) Mënyra dhe procedura për përcaktimin e përgjegjësishë për punën e paligjshme të kryetarit, zëvendësit të tij, anëtarëve dhe zëvendësve të tyre, të komisioneve komunale të zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit rregullohen me Ligjin për nëpunësit shtetërorë.

Neni 36

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit dhe zëvendësit e tyre, sipas rregullës kanë vendbanim në rajonin e komunës për të cilën është formuar Komisioni Komunal i Zgjedhjeve.

9.2. Kompetenca e Komisionit komunal të zgjedhjeve dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit

Neni 37

- (1) Komisioni komunal i zgjedhjeve dhe Komisioni zgjedhor i qytetit të Shkupit, kujdeset për ligjshmërinë në përgatitjen dhe zbatimin e zgjedhjeve në pajtim me këtë kod dhe bën mbikëqyrjen e punës së këshillave zgjedhore.
- (2) Komisioni komunal i zgjedhjeve dhe Komisioni zgjedhor i qytetit të Shkupit:
 - 1) e emëron përbërjen e këshillave zgjedhore me aktvendim, dhe me nënshkrime të deponuara të anëtarëve e dorëzon te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve;
 - 2) i shkarkon anëtarët e këshillit zgjedhor në rast të punës së tyre të kundërligjshme para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve;
 - 3) jep udhëzim për punën e këshillave zgjedhore;
 - 4) i shpall listat e përcaktuara të kandidatëve;
 - 5) e organizon dhe zbaton edukimin e anëtarëve të këshillave zgjedhore sipas plan-programit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve para çdo zgjedhje dhe u lëshon certifikata për trajnimin e kryer;
 - 6) ndërmerr përgatitje teknike për zbatimin e zgjedhjeve sipas udhëzimeve dhe instruksioneve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - 7) e kontrollon ligjshmërinë e punës së këshillave zgjedhore dhe intervenon në rastet kur konstatohet cenimi i ligjshmërisë në përgatitjen, kandidimin e zbatimin dhe konfirmimin e rezultateve nga zgjedhjet, si dhe të udhëzimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga ai;
 - 8) përgatit raportin dhe e dorëzon në Komisionin shtetëror të zgjedhjeve;
 - 9) i informon qytetarët për vendin e votimit;
 - 10) i evidenton dhe konfirmon përfaqësuesit e autorizuar për përcjelljen e punës së Komisionit Komunal të Zgjedhjeve dhe të këshillave zgjedhore dhe u jep identifikime me numrin e vendvotimit të përfaqësuesve të autorizuar të cilat do të përcjellin punën e këshillave të zgjedhjeve;
 - 11) i dorëzon dhe grumbullon materialet e zgjedhjeve në këshillat zgjedhore dhe nga këshillat zgjedhore, në mënyrën e përcaktuar me këtë kod;
 - 12) pas zbatimit të zgjedhjeve për kryetar të Republikës i mbledh rezultatet nga votimi i listës së kandidatëve, përpilon procesverbal dhe bashkë me materialin e përgjithshëm zgjedhor, e dorëzon

në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve menjëherë, e më së voni 12 orë pas përfundimit të votimit;

- 13) plotëson dhe dorëzon të dhëna statistikore për nevojat e Entit Shtetëror të Statistikës;
 - 14) pas zbatimit të zgjedhjeve për deputetë në Kuvend, në bazë të procesverbaleve nga vendvotimet i mbledh rezultatet sipas njësive zgjedhore për vendvotimet për të cilat ajo është kompetente dhe sipas përkatësisë së tyre në njësinë zgjedhore;
 - 15) në afat prej pesë orë nga pranimi i materialit të plotë zgjedhor të këshillit zgjedhor i përmbledh rezultatet nga votimi për listat e kandidatëve nga vendvotimet për të cilën është kompetente, përpilon procesverbal dhe të njëjtat ia dorëzon Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - 16) vendos me kundërshtim në pajtim me këtë kod;
 - 17) siguron material dëshmie gjatë vendosjes sipas mjeteve juridike.
- (3) Gjatë zbatimit të zgjedhjeve lokale, Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit i kryen kompetencat e përcaktuara në paragrafët (2) të këtij neni, përveç kompetencave të përcaktuara në paragrafët 1, 2, 3, 5, 10, 11, 12 dhe 14.
- (4) Gjatë zbatimit të zgjedhjeve lokale, përveç kompetencave të përcaktuara në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit:
- 1) verifikon nëse listat e propozuara të kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit dhe lista e kandidatit për kryetar të komunës, janë paraqitur në pajtim me këtë kod;
 - 2) i verifikon listat e kandidatëve të propozuar;
 - 3) e ruan materialin zgjedhor nga zgjedhjet lokale;
 - 4) i konfirmon rezultatet nga votimi në komunë dhe në Qytetin e Shkupit, dhe kandidatëve të zgjedhur për anëtarë të këshillit, përkatësisht kryetarin të zgjedhur të komunës, u lëshon certifikatë për zgjedhjen menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve; dhe
 - 5) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me këtë kod.

10. KËSHILLI ZGJEDHOR

10.1. Zgjedhja dhe përbërja e këshillit zgjedhorë

Neni 38

- (1) Këshilli zgjedhor formohet për secilin vendvotim.
- (2) Këshillat zgjedhorë përbëhen nga kryetari dhe katër anëtarë.
- (3) Kryetari dhe anëtarët kanë zëvendësit e tyre.
- (4) Kryetari i këshillit zgjedhor dhe zëvendësit e tyre, zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike, komunale dhe administratën e qytetit të Shkupit, me arsim të lartë dy anëtarët dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga radhët e administratës shtetërore, publike dhe komunale të qytetit të Shkupit me së paku arsim të mesëm, me zgjidhje sipas rastit në kohëzgjatje prej katër vite.
- (5) Një anëtarë i këshillit zgjedhor dhe zëvendësi i tij emërohet në propozim të partive politike në opozitë, të cilët në zgjedhjet e fundit për deputetë kanë fituar shumicën e votave.
- (6) Një anëtarë i këshillit zgjedhorë dhe zëvendësi i tyre emërohet në propozim të partive në qeveri, të cilët në zgjedhjet e fundit për deputetë kanë fituar shumicën e votave.
- (7) Partitë politike nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, propozimet për anëtarë të këshillave zgjedhor dhe zëvendësit e tyre i dorëzojnë në komisionin komunal zgjedhor në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimi të lajmërimit nga komisioni komunal zgjedhor.
- (8) Partitë politike nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni, për çdo zgjedhje dorëzojnë propozime të reja për anëtarë të këshillave zgjedhore dhe zëvendësit e tyre
- (9) Nëse partitë politike nuk e dorëzojnë propozimin në afat të verifikuar në paragrafin (7) nga ky nen, emërimin e anëtarëve e kryen komisioni komunal zgjedhor në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni.

Neni 38-a

(1) Votimi në PDK zbatohet nga këshilli zgjedhor i përbërë nga kryetari dhe katër anëtarë.

(2) Kryetari dhe anëtarët kanë zëvendës.

(3) Kryetari zgjidhet nga radhët e diplomatëve, të punësuarit në PDK përkatëse me zgjedhje të rastësishme për kohë prej katër vitesh.

(4) Zëvendëskryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike, komunale dhe të qytetit të Shkupit, me zgjedhje të rastësishme për kohë prej katër vitesh

(5) Anëtarët dhe zëvendësit tjerë zgjidhen në pajtim me nenin 38 të këtij ligji

Neni 39

(1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në afat prej 3 ditësh nga dita e formimit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit dorëzon të dhëna në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në pajtim me nenin 32 të këtij kodi për formimin e këshillave zgjedhorë.

(2) Komisioni Komunal i Zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, në afat prej 5 ditësh nga dita e marrjes së të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, i formon këshillat zgjedhorë për vendvotimet që janë në kompetencën e tij.

(3) Mënyra dhe procedura për emërimin e kryetarit, zëvendësit të tij, anëtarëve dhe zëvendësve të tyre në këshillat zgjedhorë, rregullohen me aktin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

(4) Mënyra dhe procedura për përcaktimin e përgjegjësisë për punën e paligjshme të kryetarit, zëvendësit të tij, anëtarëve dhe zëvendësve të tyre në këshillat zgjedhorë, rregullohen me Ligjin për nëpunësit shtetërorë dhe Ligjin për marrëdhënie pune.

10.2. Kompetenca e këshillit zgjedhor

Neni 40

(1) Këshilli zgjedhor kujdeset për zbatimin e ligjshëm të zgjedhjeve.

(2) Këshilli zgjedhor:

1) drejtpërdrejt e zbaton votimin në vendvotim;

2) siguron rregullsinë dhe fshehtësinë e votimit;

3) siguron mbajtjen e lire dhe të qetë të votimit;

4) e konfirmon dhe grumbullon rezultatin nga votimi në vendvotim;

5) rezultatet e votimit i shpall në vendin ku është zbatuar votimi; dhe

6) përgatit raportin dhe mban ditarin për punën e vet, dhe i dorëzon në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit.

(3) Këshilli zgjedhor përpilon procesverbal për punëndhe mbledhjen e rezultateve në formularin unik të përcaktuar dhe të verifikuar me vulë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe bashkë me materialin zgjedhor e dorëzon në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit.

(4) Në rast të gabimit gjatë plotësimit të procesverbalit, këshilli zgjedhor vepron sipas udhëzimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

(5) Këshilli zgjedhor, punët nga kompetenca e vet i kryen në pajtim me këtë kod dhe udhëzimet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

- (6) Këshilli zgjedhor në PDK **përkatësisht zyra konsullore** i kryen punët në pajtim me kompetencat e verifikuara në këtë nen.

IV. EVIDENCA E SË DREJTËS ZGJEDHORE

1. Mbajtja e Listës zgjedhore

Neni 41

- (1) Listën zgjedhore e udhëheq Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.
- (2) Lista zgjedhore udhëhiqet sipas Regjistrimit të shtetasve në formë të regjistrimit të zgjedhësve me përpunimin automatik të të dhënave në medium magnetik.
- (3) Të dhënat personale të qytetarëve në Listën zgjedhore regjistrohen në gjuhët dhe alfabetet në të cilat mbahen të dhënat në evidencat burimore, në pajtim me ligjin.
- (4) Në Listën zgjedhore regjistrohen të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet, që kanë vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë, e që kanë letërnjoftim ose dokument udhëtimi të vlefshëm.
- (5) Në Listën zgjedhore regjistrohen edhe të gjithë shtetasit e Republikës së Maqedonisë që janë me qëndrim ose punë të përkohshme jashtë vendit, me vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe me dokument të vlefshëm udhëtimi. Këta persona regjistrohen sipas vendbanimit të tyre të fundit në Republikën e Maqedonisë, para shkuarjes jashtë vendit.
- (6) Në Listën zgjedhore nuk regjistrohen qytetarët, të cilëve me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor u është marrë aftësia e punës.
- (7) Në Listën zgjedhore qytetarët regjistrohen sipas komunës në rajonin e së cilës kanë vendbanim.
- (8) Nga Lista zgjedhore përgatiten certifikata për secilën njësi zgjedhore, komunë dhe vend zgjedhor.
- (9) Për zgjedhjet që mbahen njëkohësisht, lëshohen aq certifikata të nënshkruara nga Lista zgjedhore për secilin vend zgjedhor, aq sa ka lloje të zgjedhjeve përkatësisht rrethe zgjedhore.
- (10) Përmbajtja e Listës zgjedhore, përkatësisht ekstraktet në ditën e zgjedhjeve (rrethi i parë) nuk mund të ndryshojnë deri në mbarimin e zgjedhjeve.
- (11) Mjetet për përditësimin dhe përgatitjen e Listës zgjedhore, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 42

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve kryen regjistrimin, plotësimin dhe fshirjen në Listën zgjedhore me detyrë zyrtare në bazë të të dhënave nga librat amë, evidenca e vendbanimit dhe shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, evidencat e tjera zyrtare dhe me kontrollin e drejtpërdrejtë.
- (2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve kryen regjistrimin, plotësimin dhe fshirjen në Listën zgjedhore edhe me kërkesën e qytetarëve, në bazë të letërnjoftimit dhe dokumentit të udhëimitit.
- (3) Komisioni Shtetëror Zgjedhor kryen fshirje në Listën zgjedhore të personit të ndjerë ose person që për çfarëdo lloj arsye e ka humbur të drejtën e zgjedhjes me kërkesë të partisë politike me dorëzimin e të dhënave për personin e ndjerë, ose për çfarëdo lloj arsye e ka humbur të drejtën e zgjedhjes, në bazë të verifikimit të mëparshëm në të dhënat e librave amë, evidencë të vendbanimit dhe për shtetësinë në Republikën e Maqedonisë, evidencat e tjera zyrtare dhe me kontrollin e drejtpërdrejtë.
- (4) Regjistrimi i shtetasve në Republikën e Maqedonisë të cilët janë në punë të përkohshme ose qëndrim në vend të huaj, kryhet në bazë të paraqitjes së dorëzuar në PDK **përkatësisht zyra konsullore**

2. Kompetenca e organeve për dorëzimin e të dhënave për evidence në Listën zgjedhore

Neni 43

- (1) Ministria e Punëve të Brendshme dorëzon në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve të dhëna për qytetarët:
 - që kanë mbushur 18 vjet, në ditën e zgjedhjeve, të cilët kanë letërnjoftim ose dokument udhëtimi të vlefshëm;

- që kanë mbushur 18 vjet, të cilët kanë vdekur;
 - që kanë mbushur 18 vjet, të cilët kanë ardhur ose janë shpërngulur nga një komunë e caktuar, ose e kanë ndërruar adresën e vendbanimit në komunë;
 - që kanë mbushur 18 vjet, të cilët e kanë ndryshuar emrin ose mbiemrin;
 - që kanë mbushur 18 vjet, të cilët e kanë marrë ose e kanë humbur shtetësinë e Republikës së Maqedonisë;
- dhe
- që kanë mbushur 18 vjet, të cilët janë me punë ose në qëndrim të përkohshëm jashtë vendit.

(2) Gjykatat themelore në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve të dhëna për personat, të cilëve me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor u është marrë aftësia e punës dhe të dhëna për persona të cilët vuajnë dënimin me paraburgim shtëpiak.

(3) Të dhënat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, dorëzohen katër herë në vit prej një deri më dhjetë shkurt dhe prej një deri më dhjetë qershor. Në rastet kur shpallen zgjedhjet ose referendumi, të dhënat dorëzohen ditën e ardhshme nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, përkatësisht referendumit, në mediumin magnetik dhe detyrimisht e përmbajnë numrin unik amë të qytetarit (NUAQ).

Neni 44

- (1) Organi kompetent për zbatimin e sanksioneve, më së voni 30 ditë para ditës së caktuar për zgjedhje, përkatësisht referendum në nivel shtetëror, dorëzon të dhëna për personat të cilët janë në paraburgim ose që vuajnë dënimin me burg në bazë të evidencës që e udhëheq ky organ deri te Komisioni Shtetëror Zgjedhor.
- (2) Të dhënat dorëzohen në medium magnetik dhe detyrimisht e përmbajnë numrin unik amë të qytetarit (NUAQ).

3. Përmbajtja e Listës zgjedhore dhe ekstrakteve të shtypura

Neni 45

- (1) Lista zgjedhore i përmban të dhënat si vijojnë: numrin unik amë të qytetarëve (NUAQ), mbiemrin, emrin e njërit prind dhe emrin, gjininë, adresën ku jeton (komuna, vendbanimi, rruga, numri i shtëpisë, hyrja dhe banesa), datën e regjistrimit dhe fshirjes dhe datën e llojin e plotësimit të të dhënave.
- (2) Ekstraktet e shtypura nga Lista zgjedhore dhe ekstraktet e veçanta nga Lista zgjedhore, mbahen sipas alfabetit në mbiemrin e qytetarit dhe i përmbajnë rubrikat si vijojnë, përkatësisht të dhënat: numrin rendor, mbiemrin, emrin, gjininë, datëlindjen dhe adresën ku jeton (vendbanimi, rruga, numri i shtëpisë, hyrja dhe banesa), nënshkrimin ose gjurmën e zgjedhësit.
- (3) Qytetarët të cilët gjatë kohës së zgjedhjeve gjenden në punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit, ndërsa kanë dorëzuar formular për votim në PDK përkatësisht zyra konsullore, nuk regjistrohen në certifikatat e Listës zgjedhore në të cilat votohet në Republikën e Maqedonisë.

"(4) Qytetarët që gjatë zgjedhjeve gjenden në punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit, e që nuk kanë dorëzuar fletëparaqitje për votim në PDK shënohen në lista të veçanta të Listës zgjedhore për votim në Republikën e Maqedonisë

4. Shtypja e ekstrakteve të veçanta nga Lista zgjedhore

Neni 46

Për zbatimin e votimit në PDK përkatësisht zyra konsullore në institucionet në Komisionin shtetëror të zgjedhjeve, përgatiten ekstrakte të veçanta nga Lista zgjedhore, si vijon:

- për votimin e qytetarëve përkatësisht zyra konsullore të cilën në kohën e zgjedhjeve gjenden në punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit, në bazë të formularit për votim,
- për votimin e qytetarëve të cilët në kohën e zgjedhjeve gjenden në paraburgim ose vuajnë dënimin me burg.

-për votimin e anëtarëve të këshillave zgjedhore për votim në PDK, respektivisht zyra konsullore."

Neni 47

Ekstraktet e veçanta nga Lista zgjedhore nga neni 46 i këtij kodi përgatiten në dy ekzemplarë si vijon:

- për qytetarët që në kohën e mbajtjes së zgjedhjeve gjenden në punë të përkohshme ose qëndrim në jashtë vendit , njëri ekzemplarë sistemohet sipas vendvotimit ose komunës dhe njësia zgjedhore dhe në vërejtje gjendet vendi ku qytetari është në punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit dhe vendin e PDK përkatësisht zyra konsullore, ndërsa ekzemplari i dytë sistemohet sipas vendit ku qytetarët janë në punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit, vendi i PDK përkatësisht zyra konsullore dhe në vërejte shënohet numri i vendvotimit dhe njësisë zgjedhore dhe
- për qytetarët që në kohën e zgjedhjeve gjenden në paraburgim ose në vuajtjen e dënimit me burg, njëri ekzemplar sistemohet sipas vendvotimit ose komunës dhe në vërejtje shënohet komuna në të cilën gjendet institucioni ndëshkues përmirësues, ndërsa ekzemplari i dytë sistemohet sipas institucionit ndëshkues përmirësues dhe komunës në të cilën gjendet, dhe në vërejte qëndron numri i vendvotimit dhe komuna të cilës i takon ai vendvotim.
- për anëtarët e këshillave zgjedhore për votim në PDK përkatësisht zyra konsullore, respektivisht në zyrat konsullore, njëri ekzemplar sistematizohet sipas vendit zgjedhor, komunës dhe njësisë zgjedhore dhe në vërejtje qëndron KSHZ, kurse ekzemplari i dytë sistematizohet sipas KSHZ, e në vërejtje qëndron vendi zgjedhor, komuna dhe njësia zgjedhore

5. Kontrolli i të dhënave në Listën zgjedhore

Neni 48

- (1) Qytetari gjatë tërë vitit mund të kërkojë të bëjë shikim në ekstraktin e Listës zgjedhore, në hapësirat zyrtare të seksioneve rajonale të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, PDK përkatësisht zyra konsullore si dhe nëpërmjet Internetit.
- (2) Nëse gjatë shikimit konfirmohet se ai ose qytetari tjetër nuk është i regjistruar në Listën zgjedhore, ose konfirmohet se duhet të bëhet regjistrimi, plotësimi ose fshirja e të dhënave, në seksionin rajonal të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ka të drejtë të paraqesë kërkesë për regjistrimin, plotësimin ose fshirjen e të dhënave me të cilën ofron edhe dokumentacionin përkatës.
- (3) Shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët janë në punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit, ku gjatë shikimit në PDK përkatësisht zyra konsullore vërtetojnë se ai ose qytetari tjetër nuk është i regjistruar në Listën zgjedhore ose vërtetohet se duhet të kryhet regjistrim, plotësim ose fshirje e të dhënave, kërkesa për regjistrim, plotësim ose fshirje të të dhënave me të cilën bashkangjitet dokumenti përkatës, dorëzohen me postë elektronike nëpërmjet PDK përkatësisht zyra konsullore deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ose në mënyrë të drejtpërdrejtë në Komisioni Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (4) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, do ta kontrollojë saktësinë e të dhënave dhe dokumenteve të ofruara nga qytetari, dhe nëse konfirmon se

kërkesa ka bazë, me aktvendim në bazë të dokumentacionit të besueshëm do ta bëjë regjistrimin, plotësimin ose fshirjen e të dhënave në Listën zgjedhore, në të kundërtën do të marrë aktvendim me të cilin do ta refuzojë kërkesën.

- (5) Kundër aktvendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve qytetari në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, mund të paraqesë padi për marrjen e kontestit administrativ deri te Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë
- (6) Për padinë nga paragrafi (4) i këtij neni, Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë vendos në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të ankesës.
- (7) Aktvendimi i plotfuqishëm i Gjykatës Administrative të Republikës së Maqedonisë i marrë pas padisë është bazë për regjistrimin, ndryshimin dhe fshirjen e të dhënave në Listën zgjedhore.
- (8) Shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët janë në punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit, padi kundër aktvendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve mund të parashtrojnë nëpërmjet postës elektronike nëpërmjet PDK **përkatësisht zyra konsullore** deri te Gjykata Administrative ose në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Administrative.

6. Shikimi publik i Listës zgjedhore

Neni 49

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, më së voni 15 ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, Listën zgjedhore e ofron për shikim publik në seksionet e veta rajonale dhe zyrat e vendit në përbërjen e tyre, me gjendjen e të dhënave për:
 - qytetarët që kanë mbushur 18 vjet, në ditën e zgjedhjeve (rrethi i parë i votimit);
 - personat e ndjerë, 30 ditë para ditës së shpalljes së zgjedhjeve; dhe
 - të dhëna të tjera nga Lista zgjedhore, në ditën e shpalljes së zgjedhjeve.
- (2) Komisioni Shtetëror Zgjedhor nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme i dorëzon në PDK **përkatësisht zyra konsullore** ekstratet e veçanta nga Lista zgjedhore për personat me punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit në bazë të evidencës nga organi kompetent, për vënie në shikim publik.
- (3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve pas paraqitjes së ekstrakteve nga Lista zgjedhore në shikim publik, përmes mjeteve publike të informimit, i njofton qytetarët për vendin ku do të bëhet shikimi, mënyra me të cilën kryhet shikimi, kohëzgjatja e shikimit dhe mundësia e regjistrimit, plotësimit ose fshirjes së të dhënave nga Lista zgjedhore.
- (4) Shikimi publik zgjat 15 ditë
- (5) Partitë politike gjatë shikimit publik deri te përfundimi dhe firmosja e Listës zgjedhore mund të bëjnë shikim në të dhënat e Listës zgjedhore.

"Neni 49-a

(1) Në afat prej pesë ditësh nga dita e përfundimit të shikimit publik, Komisioni Shtetëror Zgjedhor dhe listën zgjedhore ua dorëzon partive politike.

(2) Partitë politike në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të listës zgjedhore në Komisionin Shtetëror Zgjedhor dorëzojnë kërkesë për regjistrimin, plotësimin ose fshirjen e të dhënave.

(3) Komisioni Shtetëror Zgjedhor pas parashtrimit të kërkesës vendos me vendim në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (3) i këtij neni, mund të parashtrohet padi në Gjykatën Administrative në afat prej 24 orësh nga pranimi i aktvendimit.

(5) Gjykata Administrative obligohet të vendosë në afat prej 24 orësh nga dita e pranimit të padisë."

7. Ndryshimi i të dhënave në Listën zgjedhore të paraqitur për shikim publik

Neni 50

- (1) Kërkesë për regjistrim, plotësim ose fshirje të të dhënave në ekstraktet e Listës zgjedhore që janë paraqitur për shikim publik, në afatin nga neni 49 paragrafi (4) i këtij kodi, mund të paraqesë secili qytetar nëse:
 - ai ose ndonjë qytetar tjetër nuk është regjistruar në Listën zgjedhore;
 - është regjistruar personi që nuk ka të drejtë vote ose nuk ka vendbanim në rajonin e komunës ose personi që ka vdekur, dhe
 - emri personal dhe adresa e personit ose emri personal dhe adresa e personit tjetër janë regjistruar në mënyrë të parregullt.
- (2) Kërkesa për regjistrimin, plotësimin ose fshirjen e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, paraqitet me shkrim në seksionin rajonal të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ose në zyrën vendore të rajonit të vendbanimit.
- (3) Me kërkesën ofrohen edhe dëshmitë e nevojshme.

7-a Paraqitje dhe shikim në Listën zgjedhore për votim jashtë vendit

Neni 50-a

- (1) Komisioni Shtetëror Zgjedhor, menjëherë, dhe më së voni dy ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve në Ministrinë e Punëve të Jashtme dorëzon lajmërim për shpalljen e thirrjes publike për shpallje të zgjedhjeve.
- (2) Ministria e Punëve të Jashtme, menjëherë, më së voni në afat prej tre ditë nga dita e pranimit të lajmërimit nga paragrafi (1) të këtij neni është i obliguar ta dorëzojë në PDK **përkatësisht zyra konsullore** për shkak shpalljes në vendin përkatës.
- (3) Lajmërimi nga paragrafi 1 i këtij neni shpallet në gjuhën maqedonase dhe shkrimit të tij cirilik, të gjuhëve dhe shkrimeve të komuniteteve të shënuara në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe të gjuhës zyrtare të vendit përkatës në së paku një deri tre gazeta kombëtare më me tirazh, të cilët në vitin e kaluar kanë vlerë më të lartë të tatimeve të paguara, në më së paku një të katërtën e faqes.
- (4) Lajmërimi nga paragrafi (1) i këtij neni, përmban të dhëna për llojin e zgjedhjeve për të cilat votohet, thirrje për shikim publik në listën zgjedhore dhe për paraqitje të votimit, ditën e fillimit dhe përfundimit të paraqitjes për votim, dokumentet e nevojshme, si dhe sqarime kush mund të voton dhe ku do të zbatohet votimi.
- (5) Thirrja publike në afat të vërtetuar në paragrafin (1) të këtij neni, shpallet edhe në ueb-faqen e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komisionin Shtetëror i Zgjedhjeve dhe PDK **përkatësisht zyra konsullore**.
- (6) Kërkesa për regjistrim, plotësim ose fshirje e të dhënave të ekstrateve të veçanta nga Lista zgjedhore gjatë kohës së shikimit publik, shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët janë me punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit, mund ta parashtrojnë nëpërmjet postës elektronike nëpërmjet PDK **përkatësisht zyra konsullore** së deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ose deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

- (7) Në ekstraktet e veçanta të Listës zgjedhore regjistrohen shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët janë me punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit me vendbanim të fundit të paraqitur në Republikën e Maqedonisë dhe të cilët kanë dorëzuar paraqitje për votim për zgjedhjet paraprake deri te PDK **përkatësisht zyra konsullore** e Republikës së Maqedonisë në vendin përkatës.
- (8) Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e shikimit publik, shtetasit e Republikës së Maqedonisë nga paragrafi (7) i këtij neni mund të dorëzojnë deklaratë të shkruar me dorë ose të dërguar me postë elektronike me të cilën paraqiten për votim në zgjedhjet paraprake.
- (9) Në zgjedhjet për zgjedhje të kryetarit dhe deputetëve mund të votojnë shtetas të Republikës së Maqedonisë të cilët janë me punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit të cilët kanë dorëzuar deklaratë për votim dhe janë regjistruar në ekstraktet e veçanta të Listës zgjedhore.
- (10) Kërkesa nga paragrafi (6) dhe deklarata nga paragrafi (8) i këtij neni, PDK **përkatësisht zyra konsullore** menjëherë, më së voni në afat prej dy ditësh pas përfundimit të shikimit publik i dorëzon nëpërmjet postës elektronike deri te Ministria e Punëve të Jashtme, ndërsa Ministria për Punë të Brendshme menjëherë dhe më së voni në afat prej 24 orësh nga dita e pranimit të të njëjtave i dorëzon deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

Neni 51

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve sipas kërkesave **dhe fletëparaqitjet** të qytetarëve nga **neni 50-a** i këtij kodi është e obliguar që të vendosë me aktvendim në afat prej 24 orësh nga dita e pranimit të kërkesës dhe nëse konfirmon se kërkesa ka bazë, me aktvendim do ta bëjë regjistrimin, plotësimin ose fshirjen e të dhënave në Listën zgjedhore, e në të kundërtën do të marrë aktvendim me të cilin do ta refuzojë kërkesën.
- (2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, qytetari në afat prej 24 orësh nga pranimi i aktvendimit mund të paraqesë padi deri te Gjykata Administrative.
- (3) Pas padisë nga paragrafi (2) i këtij neni, Gjykata Administrative vendos në afat prej 24 orësh pas pranimit të padisë.
- (4) Aktvendimi i plotfuqishëm i Gjykatës Administrative të Republikës së Maqedonisë i marrë sipas padisë për regjistrimin, ndryshimin dhe fshirjen, është pjesë përbërëse e Listës zgjedhore të nënshkruar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

8. Përmbyllja dhe firmosja e Listës zgjedhore

Neni 52

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Listën zgjedhore në të cilën janë kryer të gjitha ndryshimet që kanë dalë nga shikimi publik, të shtypur në formë të ekstrakteve, e përmbyll më së voni 15 ditë pas përfundimit të shikimit publik.

Neni 53

- (1) Lista zgjedhore përkatësisht ekstrakti, përmbillet me shënimin e: numrit të faqeve që i ka ajo listë përkatësisht ekstrakti, numrit të zgjedhësve të regjistruar (të shënuar me numra dhe shkronja), momentit kritik të të dhënave të përcaktuara në nenin **49** paragrafi (1) i këtij kodi, datës së përmbylljes, nënshkrimit të personit të autorizuar dhe vulës;
- (2) Lista zgjedhore e përmbyllur i përmban edhe të dhënat për qytetarët kërkesat e të cilëve për fshirjen, regjistrimin ose ndryshimin e të dhënave nga Lista zgjedhore, janë zgjidhur pozitivisht nga Ministria e Drejtësisë, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë.

Neni 54

SHLYHET

9. Mbrojtja e të dhënave në Listën zgjedhore

Neni 55

- (1) Të dhënat personale të përmbajtura në Listën zgjedhore janë të mbrojtura në pajtim me ligjin dhe nuk guxojnë të përdoren për kurrfarë qëllimi tjetër, përveç për realizimin e së drejtës së zgjedhjes të qytetarëve në pajtim me këtë kod.
- (2) Partive politike të regjistruara dhe kandidatëve të pavarur gjatë pjesëmarrjes në zgjedhje, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, pas kërkesës paraprake me shkrim, u ofron në formë të shtypit ose elektronike në CD-rom të dhëna nga ekstrakti i Listës zgjedhore të nënshkruar ose të përgatitur paraprakisht për secilin vendvotim, në të cilat përmbahen të dhënat nga neni 45 paragrafi (2) i këtij kodi në afat prej dhjetë ditë dhe ekstraktet e Listës zgjedhore për votim në PDK **përkatësisht zyra konsullore**.
- (3) Parashtruesit e kërkesës i bartin shpenzimet reale për përpunimin e të dhënave nga Lista zgjedhore në formë shtypi ose elektronike.
- (4) Partitë politike të regjistruara, koalicionet dhe kandidatët e pavarur, përkatësisht përfaqësuesit e autorizuar dhe zëvendësit e tyre, të parashtruesve të listës së kandidatëve, nuk mund t'i shfrytëzojnë listat zgjedhore në ditën e zgjedhjeve për evidentimin e personave që kanë votuar.

Neni 56

Nëpunësi i autorizuar ose cilido person tjetër, trup ose organ që është i njoftuar me të dhënat personale të përmbajtura në Listën zgjedhore, janë të obliguar që t'i ruajë dhe mbrojë në pajtim me nenin 55 të këtij kodi.

V. KANDIDIMI

1. Propozimi i kandidatëve

Neni 57

- (1) Propozimi i kandidatëve për t'u zgjedhur kryetar Republike, kandidatëve për deputetë, kandidatëve për anëtarë të këshillit dhe për kryetar të komunës, bëhet me paraqitjen e listës së kandidatit për kryetar të Republikës, listës së kandidatëve për deputetë, listës së kandidatëve për anëtarë të këshillit, përkatësisht listës së kandidatëve për kryetar të komunës.
- (2) Kandidati për kryetar të Republikës, deputetë, kandidatët për anëtarë të këshillit dhe për kryetar të komunës mund të propozohen vetëm në një listë.

2. Paraqitësi i listës

Neni 58

- (1) Paraqitësi i listës mund të paraqesë vetëm një listë të kandidatit për kryetar të Republikës, kandidatëve për deputetë, kandidatëve për anëtarë të këshillit si dhe një listë të kandidatit për kryetar komune.
- (2) Gjatë zbatimit të zgjedhjeve lokale, paraqitësi i listave nga paragrafi (1) i këtij neni në njësinë e vetëadministrimit lokal në të cilën së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare që ndryshon nga gjuha maqedonase, paraqitja e listave të kandidatëve, përkatësisht listës së kandidatëve për kryetar komune, bëhet në gjuhën dhe alfabetin që e përdorin qytetarët në atë njësi të vetëadministrimit lokal.
- (3) Gjatë zbatimit të zgjedhjeve parlamentare, paraqitësi i listave nga paragrafi (1) i këtij neni në njësitë zgjedhore në të cilat së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare që ndryshon nga gjuha maqedonase, paraqitja e listave të kandidatëve mund të bëhet përveç në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdorin qytetarët në atë njësi të vetëadministrimit lokal.

Paraqitësi i listës së kandidatit për kryetar të Republikës

Neni 59

(1) Të drejtën për të paraqitur listë të kandidatit për kryetar të Republikës e kanë së paku 10.000 zgjedhës ose 30 deputetë.

(2) Kur paraqitës i listës së kandidatit për kryetar të Republikës është një grup zgjedhësish, duhet të grumbullohen së paku 10.000 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në Listën zgjedhore.

(3) Kur paraqitës të listës së kandidatit për kryetar të Republikës janë deputetë, duhet të grumbullohen së paku 30 nënshkrime nga deputetët.

Paraqitësi i listës së kandidatëve për deputetë, anëtarë të këshillit dhe kryetar të komunës

Neni 60

- (1) Të drejtë të paraqesin listë të kandidatëve për deputetë, listë të kandidatëve për anëtarë të këshillit, përkatësisht listë të kandidatit për kryetar të komunës, kanë partitë politike të regjistruara në mënyrë të pavarur, koalicionet, si dhe një grupi i zgjedhësve (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i listës).
- (2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve e konfirmon subjektivitetin e paraqitësit të listës së kandidatëve, për zgjedhje të deputetëve në bazë të marrëveshjes së partive politike që marrin pjesë si koalicion në zgjedhje.
- (3) Komisioni Komunal i Zgjedhjeve dhe Komisioni i Zgjedhjeve në qytetin e Shkupit e konfirmon subjekti i paraqitësit të listës të kandidatëve për zgjedhje të anëtarëve të këshillit dhe kryetar të komunës në bazë të marrëveshjes së partive politike që marrin pjesë si koalicion të zgjedhjeve për zgjedhje të anëtarëve të këshillit dhe kryetarëve të komunave.
- (4) Marrëveshja për koalicion nga paragrafi (2) dhe (3) i këtij neni e përfshijnë përfaqësuesit e partive politike të cilët marrin pjesë së bashku dhe ai e përmban emrin e koalicionit, simbolin, komunës, përkatësisht njësitë zgjedhore në të cilën marrin pjesë së bashku.
- (5) Listën e kandidatëve e nënshkruan personalisht përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të listës.
- (6) Emri i listës shënohet sipas emrit të parashtruesit të listës.
- (7) Nëse parashtruesi i listës së kandidatëve është grup zgjedhësish, titulli i listës shënohet me “grup zgjedhësish” dhe emrin dhe mbiemrin e kandidatit.

Parashtruesi i listës së kandidatëve për deputetë me nënshkrime të grumbulluara

Neni 61

- (1) Kur parashtruesi i listës së kandidatëve për deputetë është një grup zgjedhësish, duhet të grumbullohen së paku 1 000 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore të njësisë zgjedhore.
- (2) Kur parashtruesi i listës së kandidatëve për deputetë është grup zgjedhësish nga njësitë zgjedhore për votim jashtë vendit, është e nevojshme të mblidhen së paku 1000 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për ato njësi zgjedhore para nëpunësve të PDK **përkatësisht zyra konsullore** të ekzemplarit të nënshkruar nga ana e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Paraqitësi i listës së kandidatëve për anëtarë të këshillit dhe kryetar komune me nënshkrime të grumbulluara

Neni 62

- (1) Nëse parashtruesi i listës së kandidatëve për anëtarë të këshillit, përkatësisht listës së kandidatit për kryetar komune është një grup zgjedhësish, duhet të grumbullohen:
 - në komunën deri 10 000 banorë, së paku 100 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e

Listës zgjedhore për komunën;

- në komunën prej 10 001 deri 30 000 banorë, së paku 150 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për komunën;
- në komunën prej 30 001 deri 50 000 banorë, së paku 250 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për komunën;
- në komunën prej 50 001 deri 100 000 banorë, së paku 350 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për komunën;
- në komunën mbi 100 001 banorë, së paku 450 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për komunën, dhe
- në Qytetin e Shkupit së paku 1 000 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për rajonin e Qytetit të Shkupit.

3. Procedura për grumbullimin e nënshkrimeve për propozimin e kandidatit

Neni 63

- (1) Nënshkrimet e zgjedhësve në procedurën e kandidimit, grumbullohen para personave zyrtarë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në formularin që përmban emrin dhe mbiemrin, vendbanimin e përhershëm, profesionin dhe numrin unik amë të kandidatëve të propozuar, si dhe emrin e mbiemrin dhe numrin unik amë të zgjedhësit që e nënshkruan propozimin.
- (2) Grumbullimi i nënshkrimeve para Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve fillon në ditën e pesëmbëdhjetë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe zgjat 15 ditë.
- (3) Secili zgjedhës nënshkrimin e vet mund ta japë vetëm në një listë të kandidatit për kryetar të Republikës, kandidatëve për deputetë, për anëtarë të këshillit, si dhe të kandidatit për kryetar të komunës.
- (4) Zgjedhësit që e parashtrojnë listën, duhet të kenë të drejtën e zgjedhjes dhe vendbanim të përhershëm në rajonin e njësisë zgjedhore, komunën, përkatësisht Qytetin e Shkupit.

4. Paraqitja e listës që parashtrohet

Neni 64

- (1) Lista e paraqitur e kandidatit për kryetar të Republikës përmban: emrin e listës, emrin dhe simbolin nëse e ka të parashtruesit të listës, emrin dhe mbiemrin e kandidatit të propozuar për kryetar me shënimin e vendbanimit të tij të përhershëm, profesionit dhe numrit unik amë të qytetarit.
- (2) Lista e parashtruar e kandidatëve për deputetë përmban: numrin e njësisë zgjedhore, emrin e listës, emrin dhe simbolin nëse e ka të parashtruesit të listës, emrin dhe mbiemrin e bartësit të listës, emrin dhe mbiemrin e secilit kandidat për deputetë dhe përmban aq kandidatë sa zgjidhen në njësinë zgjedhore, me shënimin e vendbanimit të tyre të përhershëm, profesionit dhe numrit unik amë të qytetarit dhe deklaratë për përkatësinë e bashkësisë së caktuar.
- (3) Lista e parashtruar e kandidatëve për anëtarë të këshillit, përkatësisht lista e kandidatit për kryetar të komunë përmban: shënimin e këshillit të komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit për të cilët kryhet zgjedhja, emrin e listës, emrin dhe simbolin nëse e ka të parashtruesit të listës, emrin dhe mbiemrin e bartësit të listës, emrin dhe mbiemrin e secilit kandidat dhe përmban aq kandidatë sa zgjidhen për anëtarë të këshillit, me shënimin e vendbanimit të tyre të përhershëm, profesionit dhe numrit unik amë të qytetarit.
- (4) Lista e parashtruar e kandidatit për kryetar të komunës përmban: emrin e komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit për të cilin propozohet, emrin e listës, emrin dhe simbolin nëse e ka të parashtruesit të listës, emrin dhe mbiemrin e kandidatit të propozuar për kryetar komune me shënimin e vendbanimit të tyre të përhershëm, profesionit dhe numrit unik amë të qytetarit.
- (5) Në listën e parashtruar të kandidatëve për deputetë nga paragrafi (2) i këtij neni dhe për anëtarë të

këshillit komunal dhe të qytetit të Shkupit nga paragrafi (3) i këtij neni, në çdo tre vende të listës së paku një vend i takon gjinisë më pak të përfaqësuar.

"(6) Marrëveshja për koalicion, vërtetimi nga Regjistri qendror dhe aktvendimi nga gjykata kompetente për regjistrimin e partisë politike, që dorëzohen në shtesë të listës së parashtruar të kandidatëve, parashtrohen në origjinal ose në kopje të vërtetuar te noteri.

(7) Me përjashtim të paragrafit (6) të këtij neni, marrëveshja për koalicion, vërtetimi nga Regjistrit qendror dhe aktvendimi nga gjykata kompetente për regjistrimin e partisë politike, që dorëzohen në shtesë të listës së parashtruar të kandidatëve për anëtarë të këshillit, parashtrohen në origjinal ose në kopje. Nëse parashtrohen në kopje, origjinali i marrëveshjes për koalicion, vërtetimi i regjistrit qendror dhe aktvendimi i gjykatës kompetente për partinë politike deponohen në Komisionin Shtetëror Zgjedhor"

5. Procedura për paraqitjen e listës

Neni 65

- (1) Lista e kandidatit, përkatësisht kandidatëve, parashtrohet në formular të përcaktuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.
- (2) Nëse parashtruesi i listës së kandidatit, përkatësisht kandidatëve është partia politike, doemos duhet të bashkëngjisë vërtetimin e regjistrimit në gjyqin kompetent.
- (3) Nëse parashtruesi i listës së kandidatit, përkatësisht kandidatëve është koalicioni, doemos duhet ta bashkëngjisë marrëveshjen nga neni 60 paragrafi (4) i këtij kodi.
- (4) Nëse parashtruesi i listës së kandidatit, përkatësisht kandidatëve është një grup zgjedhësish, doemos duhet të paraqitet edhe numri i nevojshëm i nënshkrimeve, të përcaktuara në nenin 61, përkatësisht nenin 62 të këtij kodi.
- (5) Për secilën kandidaturë nevojitet pajtimi me shkrim (deklarata) e kandidatit, e cila është e parevokueshme.
- (6) Radhitjen e kandidatëve në listën e kandidatëve e përcakton parashtruesi i listës, në pajtim me nenin 64 të këtij kodi.

Neni 66

- (1) Listën e kandidatit për kryetar të Republikës, përfaqësuesit e autorizuar të propozuesve e dorëzojnë në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (2) Listat e kandidatëve për deputetë, përfaqësuesit e autorizuar të propozuesve i dorëzojnë në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (3) Listat e kandidatëve për anëtarë të këshillit, përkatësisht listën e kandidatit për kryetar komune, përfaqësuesit e autorizuar të propozuesve i dorëzojnë në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve dhe Komisioni Zgjedhor të Qytetit të Shkupit.
- (4) Listat e kandidatëve nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, dorëzohen te komisioni kompetent i zgjedhjeve, më së voni 35 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 67

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, përkatësisht komunal, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit nga neni 66 i këtij kodi, pas pranimit të listës së kandidatit, përkatësisht kandidatëve, konfirmon nëse e njëjta është paraqitur në afatin e përcaktuar dhe e përpiluar në pajtim me dispozitat e këtij kodi.

- (2) Nëse Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, përkatësisht komunal, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, konfirmon se në listë ka parregullsi të caktuara, do ta thërrasë përfaqësuesin e autorizuar të parashtruesit të listës, përkatësisht deputetin e pare të nënshkruar të listës së kandidatit, që t'i evitojnë parregullsitë në afat prej 48 orësh nga pranimi i listave.
- (3) Nëse Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, përkatësisht komunal, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, konfirmon se lista është paraqitur në afatin e caktuar dhe është përpiluar në pajtim me dispozitat e këtij kodi, përkatësisht lëshimet dhe parregullsitë e konstatuara, parashtruesit e listës i kanë mënjeluar në afatin e përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, listën e paraqitur do ta konfirmojë me aktvendim.
- (4) Nëse Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, përkatësisht komunal, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, konfirmon se listat nuk janë paraqitur me kohë, përkatësisht lëshimet dhe parregullsitë e konstatuara paraqitësit e listave nuk i kanë mënjeluar në afatin e përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, listat nuk janë paraqitur do ta hedhë poshtë me aktvendim, në afat prej 24 orësh nga pranimi i listave.
- (5) Kundër aktvendimit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, përkatësisht Komisionit Zgjedhor të Qytetit të Shkupit nga paragrafi (4) i këtij neni, mund të parashtrrojë padi deri te Gjykata Administrative, në afat prej 24 orësh nga pranimi i aktvendimit.
- (6) Kundër aktvendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nga paragrafi (4) i këtij neni, mund të parashtrohet padi deri te Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë përmes Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në afat prej 24 orësh nga pranimi i aktvendimit.
- (7) Gjykata Administrative është e obliguar të parashtrroj vendim në afat prej 24 orësh nga pranimi i padisë.
- (8) Paraqitja e kundërshtimit dhe padisë me postë, nuk lejohet.
- (9) Dorëzimi i kundërshtimit dhe padisë për votim të njëjësive zgjedhore në Evropë dhe Afrikë, Amerikën Veriore dhe Jugore dhe Australi dhe Azi me postë nuk është e lejuar, ndërsa kryhet nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar të kandidatëve për ato njësi zgjedhore në Republikën e Maqedonisë.

“6. Procedura në rast të vdekjes së kandidatit të listës

së vërtetuar të kandidatëve për anëtar të këshillit komunal dhe Qytetit të Shkupit

Neni 67-a

(1) Nëse ndonjë nga kandidatët e listës së vërtetuar të kandidatëve vdes në periudhën nga dita e vërtetimit të listave të kandidatëve, partia politike respektivisht koalicioni që e kanë propozuar atë kandidat, mundën në vendin e të njëjtit të propozojnë kandidat tjetër, e nëse është propozuar nga grupi i zgjedhësve mundën në vend të tij të propozojnë kandidat tjetër mbledhur nënshkrime në procedurën e kandidimit të përcaktuar me këtë ligj, në periudhë prej dhjetë ditësh para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

- (2) Kandidati që ka vdekur do të fshihet nga lista e kandidatëve, e kandidati me të cilin është plotësuar lista e kandidatëve do të vihet në vendin ku është propozuar kandidati i vdekur ose i vendosur në vendin e fundit të listës së kandidatëve, me ç'rast, renditja e kandidatëve tjerë të

propozuar nga lista nën kandidatin që ka vdekur zhvendoset për një vend më lartë.

(3) Nëse dikush nga kandidatët e vërtetuar të listave të kandidatëve vdes në periudhë më të shkurtër se dhjetë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, zëvendësimi i kandidatit të listës së kandidatëve do të kryhet në procedurën e përcaktuar në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, e komisioni zgjedhor kompetent në bashkëpunim me KQZ do të përcaktojë zhvendosjen e datës së mbajtjes së zgjedhjeve për atë komunë për 14 ditë.

(4) Lista e kandidatëve e plotësuar me kandidat të ri në pajtim me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni publikohet në mënyrë përcaktuar me këtë ligj për publikimin e listës unike në afat prej 24 orësh nga dita e plotësimit të listës së kandidatëve.

(5) Nëse dikush nga kandidatët e vërtetuar të listave të kandidatëve vdes në periudhë më të gjatë se dhjetë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, lista e kandidatëve mbetet në fuqi.

7. Procedura në rast të vdekjes së kandidatit të listës së vërtetuar për zgjedhjen e kryetarit të komunës

Neni 67-b

(1) Nëse kandidati nga lista e vërtetuar për zgjedhjen e kryetarit të komunës vdes në periudhë nga dita e vërtetimit të listës së kandidatëve, partia politike respektivisht koalicioni, të cilët e kanë propozuar atë kandidat, mundën në vend të të njëjtit të propozojnë kandidat tjetër, e nëse është propozuar nga grupi i zgjedhësve mundën në vend të tij të propozojnë kandidat tjetër pa mbledhur nënshkrime në procedurë për kandidim të përcaktuar me këtë ligj, në periudhë prej dhjetë ditësh nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Lista e kandidatëve e zëvendësuar me kandidat të ri në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, publikohet në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj për publikimin e listës unike në afat prej 24 orësh nga dita e ndryshimit të kandidatit të listës së kandidatëve.

(3) Nëse dikush nga kandidatët e vërtetuar të listave të kandidatëve vdes në periudhë më të shkurtër se dhjetë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, zëvendësimi i kandidatit të listës së kandidatëve do të kryhet në procedurën e përcaktuar në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, e komisioni zgjedhor kompetent në bashkëpunim me KQZ do të përcaktojë zhvendosjen e datës së mbajtjes së zgjedhjeve për atë komunë për 14 ditë.

8. Procedura në rast të vdekjes së kandidatit të listës së vërtetuar për zgjedhjen e deputetëve

Neni 67-v

(1) Nëse ndonjë nga kandidatët të cilët janë propozuar më listën e vërtetuar për zgjedhje për deputetë vdes në periudhën nga dita e vërtetimit të listës së kandidatëve, partia politike respektivisht koalicioni, të cilët e kanë propozuar atë kandidat, mundën në vend të të njëjtit të propozojnë kandidat tjetër, e nëse është propozuar nga grupi i zgjedhësve mundën në vend të tij të propozojnë kandidat tjetër pa mbledhur nënshkrime në procedurë për kandidim të përcaktuar me këtë ligj, më së voni dhjetë ditë nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Lista e kandidatëve e zëvendësuar me kandidat të ri në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni publikohet në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj për publikimin e listës unike në afat prej 24 orësh nga dita e ndryshimit të kandidatit të listës së kandidatëve.

(3) Nëse dikush nga kandidatët e vërtetuara të listës së kandidatëve vdes në periudhë më të shkurtë se dhjetë ditë para fillimit të mbajtjes së zgjedhjeve, do të vepohet në mënyrë që kandidati i cili ka vdekur, e është zgjedhur deputet do të zëvendësohet me kandidatin e parë të ardhshëm i cili nuk është zgjedhur e është propozuara nga partia politike që e ka propozuar listën e kandidatëve, respektivisht njëri nga kandidatët e ardhshëm i cili nuk është zgjedhur, e që do ta propozojë bartësi i koalicionit. Kandidati i cili ka vdekur e është zgjedhur nga lista e pavarur në njësinë zgjedhore, zëvendësohet me kandidatin e parë të ardhshëm i cili nuk është zgjedhur nga ajo listë.

Neni 68

- (1) Radhitja e kandidatëve në listën e kandidatit, përkatësisht radhitja e listave të kandidatëve, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve e konfirmon me shor dhe ai numër është i njëjtë në të gjitha njësitë zgjedhore, përkatësisht komunë, ndërsa në njësinë zgjedhore përkatësisht komuna ku nuk do të ketë përfaqësues të tij, numri përkatës i bartësit vijues pa lërjen e vendit të zbrazët.
- (2) Lista e kandidatëve për anëtarë të këshillit dhe lista e kandidatëve për kryetar të komunës, të cilët janë të parashtruar nga parashtrues të njëjtë, fitojnë numër të njëjtë rendor në të gjitha komunat (ose vetëm në komunë).
- (3) Listat e kandidatëve të propozuara nga koalicioni i udhëhequr nga partia e njëjtë politike, pa dallim të numrit të partive politike në koalicion në komuna të ndryshme respektivisht njësi zgjedhore, kanë numër të njëjtë rendor në të gjitha komunat, respektivisht në të gjitha njësitë zgjedhore
- (4) Komisioni Komunal i Zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit pas konfirmimit të listave të kandidatëve për anëtarë të këshillit dhe listat e kandidatëve për kryetar të komunës i dorëzon deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për shkak vërtetimit të radhitjes në listën e vetme të kandidatëve në pajtim me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.
- (5) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, për aktivitetet që do t'i marrin në pajtim me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, më parë doemos duhet t'i paralajmëroj përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave.

6. Shpallja e listave të verifikuara

Neni 69

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve listën unike të verifikuar të kandidatit për zgjedhjen e kryetarit të Republikës do ta shpallë më së voni 25 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".
- (2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve listat unike të verifikuara të kandidatëve për deputetë në njësitë zgjedhore do t'i shpallë në shtypin ditor nga të cilat njëri është në gjuhën e komunitetit që e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, më së voni 23 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.
- (3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme në afat prej 48 orësh, listat unike të verifikuara do t'i dorëzoj deri te PDK përkatësisht zyra konsullore, për shkak shpalljes publike.
- (4) Komisioni Komunal i Zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, listat unike të verifikuara të kandidatëve për anëtarë të këshillit, përkatësisht listën e kandidatit për kryetar të komunës, do t'i shpallë më së voni 25 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve në të gjitha vendbanimet dhe në vendvotimet e komunës.
- (5) Komisionet komunale të zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, listat unike të verifikuara të kandidatëve për deputetë, do t'i shpallin në vendvotimet në komunat për të cilat janë kompetentë.
- (6) Listat e verifikuara të kandidatëve në komunat ku së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare që dallon nga gjuha maqedonase, shpallen përveç në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik edhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin që e përdorin qytetarët e asaj komune.

VI. FUSHATA ZGJEDHORE

1. Organizuesi i fushatës zgjedhore

Neni 69-a

- (1) Për fushatën zgjedhore konsiderohet grumbullim publik dhe ngjarje të tjera publike të organizuara nga ana e organizuesit të fushatës, shfaqje publike të afisheve, video prezantime në vende publike, paraqitje të zgjedhjeve në media dhe internet, shpërndarja e materialeve të shtypura dhe paraqitja publike e kandidatëve të konfirmuar nga organet kompetente zgjedhore dhe programet e tyre.
- (2) Fushata zgjedhore fillon 20 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe në rrethin e parë dhe të dytë të votimit nuk guxon të zgjasë 24 orë para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve.
- (3) (3) Në rast të parashtrimit të ankesës për mosrespektim të dispozitave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, Komisionit Shtetëror Zgjedhor është i obliguar që t'i shqyrtojë konstatimet dhe të veprojë për ankesën e parashtruar në afat jo më të gjatë se shtatë ditë nga dita e parashtrimit të ankesës

Neni 70

- (1) Parashtruesi i listës së kandidatëve, listat e të cilit për kandidatë për zgjedhjen e kryetarit të Republikës, deputetëve, anëtarëve të këshillit, përkatësisht listës së kandidatit për kryetar të komunës janë konfirmuar nga komisioni kompetent zgjedhor, kanë të drejtë të organizojnë fushatë zgjedhore (në tekstin e mëtejme: organizues të fushatës zgjedhore).
- (2) Organizuesit e fushatës zgjedhore kanë të drejtë pjesëmarrjeje të barabartë dhe në kushte të njëjta t'i shfrytëzojnë të gjitha llojet e propagandës politike, njoftimit dhe format e tjera të propagandës, qëllimi

i së cilës është të ndikohet në vendimin e zgjedhësve gjatë votimit.

- (3) Personat e huaj juridikë e fizikë nuk mund të organizojnë fushatë zgjedhore.

Neni 71

- (1) Për shkak grumbullimit të mjeteve për financim të fushatës zgjedhore, partia politike, koalicioni, bartësi i listës së pavarur nga grupi zgjedhor përkatësisht personave të cilët kanë synim të kandidohen, para organit mbikëqyrës doemos sigurojnë NUT me shenjë „për fushatë zgjedhore” dhe te bartësi i qarkullimit pagesor në Republikën e Maqedonisë hapin llogari të transakcionit me shenjë „për fushatë zgjedhore” dhe të njëjtat nuk mund të shfritëzohen për dedikim tjetër.
- (2) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar të sigurojnë NUT dhe ta hapin llogarinë transakcioni nga paragrafi (1) i këtij neni më së voni 48 orë pas konfirmimit të listës për kandidatët, ndërsa më herët 48 orë pas shpalljes së zgjedhjeve dhe në atë afat prej 48 orësh, dëshmia për NUT të siguruar dhe llogaria e hapur transakcioni dorëzohet deri te komisioni kompetent zgjedhor.
- (3) Sigurimi i NUT dhe hapja e llogarisë së transakcionit nga paragrafi (1) i këtij neni për koalicion, parti politike, grup zgjedhësish, përkatësisht persona të cilat kanë për qëllim të kandidohen, rregullohet me marrëveshje për koalicion, përkatësisht deklaratë të dëshirës të verifikuar në noter për parti politike, grup zgjedhësish, përkatësisht persona të cilët kanë për qëllim të kandidohen.
- (4) Nëse partia politike, koalicioni, bartësi i listës së pavarur nga grupa e zgjedhësve, përkatësisht persona të cilët kanë për qëllim të kandidohen nuk sigurojnë NUT dhe nuk hapin llogari të transakcionit në afatet e paragrafit (2) të këtij neni, lista e kandidatëve refuzohet me aktvendim të komisionit kompetent zgjedhor.
- (5) Kur llogaria e transakcionit është e hapur nga ana e bartësit të listës së pavarur nga grup zgjedhësish, përkatësisht persona të cilët kanë për qëllim të kandidohen, nënshkruet i llogarisë të transakcionit është bartësi i listës së pavarur ose personi i autorizuar prej tij.
- (6) Në llogarinë e transakcionit nga paragrafi (1) i këtij neni, do të deponohen të gjitha mjetet e fituara nga personat juridik ose fizik, për financim të fushatës zgjedhore. Donacione për financime të fushatës zgjedhore mund të paguhet në llogarinë e transakcionit nga paragrafi (1) i këtij neni, më së voni deri në afatin e përcaktuar për dorëzimin e raportit financiar të fushatës zgjedhore të verifikuar në nenin 85 paragrafi (1) nga ky kod.
- (7) Në rast të mos parashtrimit, përkatësisht të mos verifikimit të listës së kandidatëve, subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni të cilët kanë siguruar NUT dhe kanë hapur llogari të transakcionit, janë të obliguar që donacionet e pashpenzuara t'i kthejnë te donatorët në përpjestueshmëri me vlerën e donuar në afat prej 60 ditësh.
- (8) Në rast të bashkimit për paraqitje të përbashkët gjatë kohës së mbajtjes së zgjedhjeve të subjekteve nga paragrafi (1) i këtij neni, të cilët para nënshkrimit të marveshjes për koalicion kanë siguruar NUT dhe kanë hapur llogari transakcioni, janë të obliguar NUT ta shlyejnë nga regjistri i organit kompetent, ndërsa llogarinë e hapur të transakcionit ta mbyllin me transferimin e mjeteve, të drejtat dhe obligimet e llogarisë së transakcionit, të hapur në pajtim me marveshjen për koalicion dhe NUT të siguruar në afatet nga paragrafi (2) i këtij neni.
- (9) Të gjitha mjetet të dedikuara për financimit të fushatës zgjedhore paguhet në llogari transakcioni nga paragrafi (1) i këtij neni dhe të gjitha shpenzimet për fushatën, do të mbulohen nga mjetet e asaj llogarie.

Neni 72

- (1) Për ligjshmërinë e zbatimit të fushatës zgjedhore, përgjegjës është organizuesi i fushatës zgjedhore.
- (2) Organizuesi i fushatës zgjedhore mban përgjegjësi edhe për ato veprime të fushatës zgjedhore për të cilat do të autorizojë persona të tjerë.

Neni 73

- (1) Kandidatët kanë të drejtë që, nëse në kohën e fushatës zgjedhore, përkatësisht në paraqitjet ose njoftimet propaganduese të organizuesve të veçantë të fushatës zgjedhore u cenohen të drejtat (me pengimin dhe pamundësimin e fushatës së kundërkandidatëve), menjëherë të ngritin procedurë për mbrojtjen e të drejtave të tyre në gjyqin themelor kompetent.
- (2) Për kërkesën për mbrojtjen e të drejtave, gjyqi themelor do të vendosë në afat prej 48 orësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.
- (3) Kundër vendimit të gjyqit themelor, mund të paraqitet ankesë në afat prej 48 orësh nga dita e pranimit të vendimit në gjyqin kompetent të apelit.
- (4) Gjyqi kompetent i apelit vendos në afat prej 48 orësh nga dita e paraqitjes së ankesës.
- (5) Vendimi i plotfuqishëm, menjëherë shpallet në gazetatat publike.

Neni 74

Nga dita e sjelljes së Vendimit për shpallje të zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve të kryetarit të Republikës së Maqedonisë, deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjes së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në pajtim me rezultatin e zgjedhjeve, si dhe nga dita e sjelljes së vendimit për shpallje të zgjedhjeve e deri në përfundimin e zgjedhjeve për zgjedhje të kryetarit të komunës ose anëtarëve të këshillit, përkatësisht deri në konstituimin e Këshillit të komunave dhe Qytetit të Shkupit nuk mund të kryhet asnjë pagesë në mënyrë të jashtëzakonshme të pagave, pensioneve, ndihmës sociale ose pagesave tjera nga mjetet e buxhetit ose mjetet e fondeve publike.

"(2) Në rast të parashtrimit të ankesës për mosrespektim të dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit është i obliguar që t'i shqyrtojë konstatimet dhe të veprojë për ankesën e parashtruar në afat jo më të gjatë se shtatë ditë nga dita e parashtrimit të ankesës.

2. Prezantimi në media

Neni 75

"(1) Radiodifuzerët, respektivisht Servisi publik i radiodifuzionit dhe shoqëritë tregtare radiodifuzive që kanë vendosur t'i mbulojnë zgjedhjet, janë të obliguara që këtë ta bëjnë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme në në programin e tyre të përgjithshëm.

(2) Radiodifuzerët, pa marrë parasysh gjuhën në të cilën e emitojnë servisin e tyre programor, janë të obliguar që në kohën e fushatës zgjedhore pjesëmarrësve në fushatë t'u mundësojnë kushte të barabarta të qasjes të gjitha format e përfaqësimit zgjedhor mediatik - lajme, programe të veçanta informative (intervista, debate radiotelevizive, ballafaqime, programe informative aktuale me qasje dokumentare dhe programe informative tematike të specializuara), përfaqësim politik pa pagesë dhe reklamim të paguar politik. (3) Programet e dedikuara për publikun e mitur nuk mund të shfrytëzohen për prezantim zgjedhor mediatik."

Neni 75-a

"(1) Radiodifuzerët do të sigurojnë mbulim të balancuar të zgjedhjeve në të gjitha format e prezantimit zgjedhor mediatik në mënyrën në vijim:

a) për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, në pajtim me principin e barazisë së të gjithë kandidatëve për President edhe në rrethin e parë edhe në rrethin e dytë të zgjedhjeve;

b) për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në pajtim me principin e proporcionalitetit sipas numrit të listave të vërtetuara të kandidatëve për deputetë dhe

v) për zgjedhje lokale:

-për zgjedhjen e kryetarit të komunës, respektivisht kryetarit të qytetit të Shkupit, në pajtim me principin e barazisë për të gjithë kandidatët për kryetarë të komunës edhe në rrethin e parë edhe në rrethin e dytë të zgjedhjeve dhe

- për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave të komunave, respektivisht anëtarëve të këshillit të qytetit të Shkupit, për radiodifuzerët në nivel shtetëror dhe rajonal në pajtim me principin e proporcionalitetin sipas numrit të listave të vërtetuara të kandidatëve për anëtarë të këshillave të komunave, respektivisht anëtarë të qytetit të Shkupit, e për radiodifuzerët në nivel lokal në pajtim me principin e barazisë.

(2) Gjatë përcaktimit të balancimit në mbulimin e zgjedhjeve do të kihet parasysh intensiteti i aktiviteteve në suaza të fushatës së pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore.

(3) Nga principi i proporcionalitetin, respektivisht barazisë, përjashtohet reklamimi i paguar politik."

Neni 76

- (1) Reklamimi i paguar politik duhet të jetë në mënyrë përkatëse dhe të dukshme e shënuar si „reklamim i paguar politik” dhe në mënyrë të qartë e ndarë nga përmbajtjet e tjera të mediave.
- (2) Në të gjitha format të reklamimit të paguar politik, porositi i reklamimit duhet të jetë në mënyrë të qartë e shënuar.
- (3) Nuk është e lejuar pjesëmarrja e të miturve në reklamimin e paguar politik.
- (4) Radiodifuzerët nuk guxojnë të emitojnë reklamim të paguar politik në lajme, programe të veçanta informative, programe edukative, programe për fëmijë, dhe në transmetim nga eventet fetare, sportive, kulturore, argëtuese e të tjera.
- (5) Servisi publik i radiodifuzionit nuk guxon të emitojë reklamim të paguar politik.

"(6) Me qëllim votuesit objektivisht të informohen gjatë fushatës zgjedhore, e për shkak të mbrojtjes së profesionit të gazetarit nga çfarëdo ndikimi politik në kohën e prezantimit mediatik zgjedhor, programet e veçanta informative nuk guxojnë të shfrytëzohen si formë e reklamimit të paguar politik.

(1) Fushata e Komisionit Shtetëror Zgjedhor për edukim të votuesve për realizimin e të drejtës zgjedhore dhe për zgjedhje të drejta dhe demokratike nuk konsiderohen si reklamim i paguar politik. Ato duhet të ndahen nga pjesa tjetër e programit dhe porositi i tyre të shënohet qartë."

Neni 76-a

Neni 76-a ndryshohet si vijon:

- (1) Servisi Radiodifuziv Publik është i obliguar, që pa kompensim në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror Zgjedhor t'i informojë qytetarët për mënyrën dhe teknikën e votimit dhe të emitojë informata tjera lidhur me procesin zgjedhor.
- (2) Në kohën e fushatës zgjedhore, Servisi Publik Radiodifuziv është i obliguar që të sigurojë qasje të barabartë në programin informativ me ç'rast: një e treta nga koha e emituar për ngjarjet ditore nga vendi dhe bota, një e treta nga koha e aktiviteteve nga fushata e partive politike në pushtet dhe një e treta nga koha për aktivitetet e partive politike në opozitë.
- (3) Koha e informimit për aktivitet e fushatës së partive politike në pushtet dhe opozitë do të ndahet në pajtim me rezultatet nga zgjedhjet e fundit parlamentare.
- (4) Servisi Publik Radiodifuziv është i obliguar që të sigurojë informim të rregullt për procesin zgjedhor edhe për personat me dëgjim të dëmtuar.
- (5) Në kohën e fushatës zgjedhore edhe në rrethin e parë edhe në rrethin e dytë të votimit, Servisi Publik Radiodifuziv është i obliguar që të emitojë pa pagesë prezantim politik të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor në pajtim me principet për mbulim të balancuar të zgjedhjeve të përcaktuara në nenin 75-a të këtij ligji.
- (6) Data dhe radhitja për emitimin pa pagesë të prezantimit politik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore përcaktohet me short.
- (7) Prezantimi pa pagesë politik i serviseve programore televizive të Servisit Publik Radiodifuziv duhet të emitohet në periudhën prej orës 16:00 deri në ora 23:00.
- (8) Servisi programor i dedikuar për emitim të aktiviteteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në kohëzgjatje prej tri orësh do të sigurojë prezantim politik pa pagesë të fushatës së partive politike në pushtet dhe të partive politike në opozitë në pajtim me rezultatet nga zgjedhjet e fundit parlamentare.
- (9) Prezantimi pa pagesë politik duhet të jetë i shënuar në mënyrë përkatëse dhe të dukshme si "prezantimi politik pa pagesë" gjatë tërë kohëzgjatjes së emitimit".

Neni 76-b

- (1) Këshilli për radiodifuzion është i obliguar ta monitoroj paraqitjen zgjedhore në media dhe servisin programor të radiodifuzerëve në Republikën e Maqedonisë, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundim të votimit të ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.
- (2) Këshilli për radiodifuzion është i obliguar, pas konfirmimit të parregullësive, të fillojë procedurën e kundërvajtjes para gjykatës kompetente kundër radiodifuzerëve që e kanë shkelur dispozitën nga ky

kod.

- (3) Gjykata kompetente është e obliguar pas kërkesës për procedurë kundërvajtëse nga paragrafi (2) i këtij neni të vendos në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës
- (4) Kundër vendimit të gjykatës kompetente, mund të paraqitet ankesë në afat prej 48 orësh nga pranimi i vendimit.
- (5) Gjykata e shkallës së dytë, është e obliguar pas ankesës të vendos në afat prej 48 orësh nga dita e pranimit të ankesës.

"Neni 76-v

- (1) Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike është e obliguar që ta ndjekë prezantimin zgjedhor mediatik dhe servisin programor të radiodifuzorëve në Republikën e Maqedonisë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e votimit në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve.
- (2) Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike është e obliguar që në afat prej tri ditësh pas konstatimit të shkeljeve të dispozitave të Kodit zgjedhor, kundër radiodifuzorëve që i ka shkelur dispozitat, të ngritë procedurën kundërvajtëse në gjykatën kompetente.
- (3) Gjykata kompetente është e obliguar me kërkesë për procedurën kundërvajtëse nga paragrafi (2) i këtij neni që të vendosë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.
- (4) Kundër vendimit të gjykatës kompetente mund të paraqitet ankesë në afat prej 48 orësh nga pranimi i vendimit.
- (5) Gjykata e shkallës së dytë është e obliguar që për ankesën të vendosë në afat prej 48 orësh nga dita e pranimit të ankesës.
- (6) Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike nëse konstaton shkelje të dispozitave për mbulimin e balancuar të zgjedhjeve nga ana e Serivisit publik radiodifuziv, do të parashtojë propozim për ngritjen e procedurës për shkarkimin e drejtorit të Serivisit publik radiodifuziv.

Neni 76-g

- (1) Për plotësimin e obligimeve ligjore të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike, mjetet financiare sigurohen nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, që paguhen në llogari të veçantë të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike.
- (2) Këto mjete janë të dedikuara vetëm për financimin e aktiviteteve të Agjencisë në kohën e procesit zgjedhor.
- (3) Nëse mjetet e miratuara janë më të mëdha se shpenzimet e bëra reale për aktivitetet e Agjencisë në lidhje me procesin zgjedhor, pjesa tjetër e mjeteve Agjencia obligohet që ta kthejë në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë."

4. Hulumtimi i mendimit publik

Neni 77

- (1) Rezultatet nga hulumtimet e mendimit publik, lidhur me pjesëmarrësit në procesin zgjedhor shpallen më së voni pesë ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve për rrethin e parë dhe të dytë të votimit..
- (2) Gjatë shpalljes së rezultateve nga hulumtimi i mendimit publik, lidhur me pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, mediat janë të obliguara të shënojnë të dhëna për emrin e porositësit që e ka kërkuar dhe e ka paguar hulumtimi, institutin që e ka kryer këtë hulumtim, metodologjia e përdorur, madhësia dhe struktura e shembullit të hulumtuar dhe periudha në të cilën është zbatuar hulumtimi.

"(3) Rezultatet nga hulumtimet e mendimit publik të realizuara në ditën e zgjedhjeve nuk guxojnë të shpallen para orës 19:00, përkatësisht para mbylljes së vendeve zgjedhore."

5. Afishet zgjedhore

Neni 78

- (1) Afishet zgjedhore lejohet të vendosen pa kompensim në vendet që i përcakton komuna, përkatësisht Qyteti i Shkupit.
- (2) Komuna dhe Qyteti i Shkupit kanë për obligim t'i shënojnë vendet nga paragrafi (1) i këtij neni, për çdo parashtrues të listave veç e veç.
- (3) Komuna dhe Qyteti i Shkupit mund të përcaktojnë edhe vende plotësuese për vendosjen e afisheve zgjedhore me kompensim.
- (4) Një pjesë të mjeteve nga paragrafi (3) i këtij neni, komuna dhe Qyteti i Shkupit drejtpërdrejtë pas mbarimit të zgjedhjeve, janë të obliguar t'i shfrytëzojnë për mënjanimin e mbeturinës të bërë në kohën e fushatës zgjedhore.
- (5) Komuna dhe Qyteti i Shkupit, janë të obliguar t'i shpallin kushtet për marrjen e së drejtës së shfrytëzimit të vendeve për vendosjen e afisheve zgjedhore, më së voni 50 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.
- (6) Komuna dhe Qyteti i Shkupit, janë të obliguar të sigurojnë kushte të barabarta për të gjithë organizuesit e fushatës zgjedhore, gjatë vendosjes së afisheve në vendet e përcaktuara.
- (7) Afishet zgjedhore mund të vendosen edhe në objektet e banimit ose objekte të tjera private, me pajtimin paraprak të pronarit të objektit.
- (8) Nuk lejohet vendosja e afisheve nga fushata, në objektet ku gjendet vendvotimi ose hapësira ku mbahet votimi.

Neni 79

- (1) Prishja e afisheve zgjedhore ose ngjitja e afisheve mbi afishe të organizuesve të tjerë të fushatës zgjedhore, ndalohet.
- (2) Organizuesi i fushatës zgjedhore obligohet që në afat prej 30 ditësh pas mbarimit të zgjedhjeve, ta heqë mbeturinën nga afishet.

6. Tubimet parazgjedhore

Neni 80

- (1) Tubimet parazgjedhore janë publike.

(2) Për mbajtjen e rendit në tubimet, kujdeset organi kompetent i punëve të brendshme.

Neni 81

Organizuesi i fushatës zgjedhore për organizimin e tubimit parazgjedhor në vendet publike dhe në vendet ku zhvillohet transporti publik, me shkrim e njofton organin kompetent të punëve të brendshme, përmes njësisë rajonale të tij, më së voni 48 orë para ditës së mbajtjes së tubimit.

Neni 82

(1) Tubimet parazgjedhore nuk guxojnë të mbahen në objektet ushtarake, objektet fetare, spitale, shtëpi të pleqve, shkolla, kopshte të fëmijëve dhe institucione të tjera publike.

(2) Me përjashtim, organizuesve mund t'u lejohet që të mbajnë tubime parazgjedhore në lokalet e shkollave ose qendrave kulturore, nëse në komunë nuk ka objekt tjetër që të mbahet tubimi.

(3) Lejen për mbajtjen e tubimeve parazgjedhore e jep personi përgjegjës i institucionit, në kushte të njëjta për të gjithë organizuesit e fushatës zgjedhore.

(4) Për nevojat e fushatës zgjedhore nuk lejohet të shfrytëzohen lokalet, pajisja ose prona tjetër që është dedikuar për punën e organeve shtetërore dhe organeve të komunës e të Qytetit të Shkupit.

(5) Me përjashtim, mund të shfrytëzohen lokalet e organeve nga paragrafi (4) i këtij neni, nëse në atë vend nuk ekzistojnë kurrfarë lokalesh të tjera përkatëse për nevojat e fushatës zgjedhore.

(6) Lejen e jep personi përgjegjës i organit në kushte të njëjta për të gjithë organizuesit e fushatës zgjedhore.

7. Financimi i zgjedhjeve

Neni 83

(1) Fushata zgjedhore nuk guxon të financohet nga:

- mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, përveç mjeteve të përcaktuara në nenin 86 paragrafi (2) i këtij kodi;
- mjetet nga buxhetet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit, përveç mjeteve të përcaktuara në nenin 86 paragrafi (2) i këtij kodi;
- mjetet nga ndërmarrjet publike dhe institucionet publike;
- mjetet nga shoqatat e qytetarëve, bashkësitë fetare, grupet religjioze dhe fondacionet;
- mjetet nga qeveritë e huaja, institucionet ndërkombëtare, organet dhe organizatat e shteteve të huaja dhe personat e tjerë të huaj;
- mjetet nga ndërmarrja me kapital të përzier ku dominues është kapitali i huaj.
- mjetet nga burimet e pa identifikuar.

(2) Fushata zgjedhore mund të financohet nga:

- anëtarësia në partinë politike,
 - personat fizikë në vlerë prej 5 000 euro në kundërvlerë me denarë, dhe
 - personat juridikë në vlerë prej 50 000 euro në kundërvlerë në denarë".
- (3) Fushata zgjedhore mund të financohet nga donacionet nga personat fizik dhe juridik në mjete parash, të mirave dhe shërbimeve vlera e të cilës nuk guxon ta tejkalon shumën e konfirmuar me paragrafin (2) alinetë 2 dhe 3 të këtij neni.
- (4) Nëse lartësia e donacionit është më e lartë se shuma e konfirmuar në paragrafin (2) alinetë 2 dhe 3 të këtij neni, organizuesi i fushatës zgjedhore është i obliguar në afat prej pesë ditëve nga dita e marrjes së donacionit, dallimi në mes vlerës së lejuar dhe të deponuar ta transferon në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

- (5) Nëse nuk mund të konfirmohet prejardhja e donacionit, organizuesi i fushatës zgjedhore është i obliguar në afat prej pesë ditëve nga dita e marrjes së donacionit të vlerës së deponuar që ta transferon në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 83–a

- (1) Si donacion nga neni 83 i këtij Kodi, konsiderohet edhe:
- dhënia e shërbimeve falë të organizuesit të fushatës zgjedhore,
 - dhënia e shërbimeve të organizuesit të fushatës zgjedhore për të cilin paguan person i tretë dhe
 - shitja e mallrave ose dhënia e shërbimeve të organizuesit të fushatës zgjedhore për çmime të ulëta nga tregjet.
- (2) Shitësi i mallit, përkatësisht ofruesi i shërbimit është i obliguar që ta lajmëron organizuesin e fushatës zgjedhore për çmimin e tregut të mallit të shitur, përkatësisht shërbimit të përfunduar dhe për atë i jep faturë.
- (3) Dallimi në mes vlerës tregtare dhe vlerës së faturuar konsiderohet për donacion.
- (4) Ndërmarrjet publike janë të obliguara të ofrojnë çmime të barabarta për shërbimet e tyre për të gjithë pjesëmarrësit e fushatës nëpërmjet çmimeve zyrtare.
- (5) Radiodifuzerët dhe mediat e shtypura, lëshimet në çmim që i japin për reklamim politik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, konsiderohen për donacion të shprehur me vlerë, **por jo më e lartë se 50 000 euro në kundërvlerë në denarë”.**

Neni 83–b

- (1) Organizatori i fushatës zgjedhore gjatë fushatës zgjedhore mban regjistër të donacioneve me këto të dhëna:
- emrin, përkatësisht emërtimin e çdo donatori veç e veç;
 - llojin dhe vlerën e donacionit dhe
 - datën e marrjes së donacionit.
- (2) Regjistri i donacioneve përmban të dhëna edhe për donacionet e paguara të subjekteve që janë të ndërlidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte me partinë politike ose janë nën kontrollin e saj.
- (3) Regjistri i donacioneve mbahet në formular të përcaktuar me rregullore që e nxjerr ministri i Financave, në të cilën përcaktohet forma, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të donacioneve."

Neni 84

Gjatë financimit të fushatës zgjedhore, organizuesi i fushatës zgjedhore mund të shpenzojë më së shumti deri 180 denarë për zgjedhës të regjistruar në njësinë zgjedhore, përkatësisht komunën për të cilën e ka paraqitur listën e kandidatëve, përkatësisht listën e kandidatit **në rrethin e parë dhe të dytë të votimit”.**

Neni 84-a

Nga dita e marrjes së vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në ditën e mbarimit të zgjedhjeve, organet shtetërore dhe organet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit nuk guxojnë të shpallin reklama të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht nga buxheti i komunave dhe i Qytetit të Shkupit."

Neni 84-b

- (1) Organizuesi i fushatës zgjedhore është i obliguar që ditën e 11-të nga dita e fushatës zgjedhore të dorëzon raport financiar për të ardhurat dhe të dalat e xhiro-llogarisë për fushatën zgjedhore nga dita e hapjes së saj deri në përfundim të ditës së 10-të nga fushata zgjedhore
- “(2) Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore detyrohet një ditë para mbajtjes së rrethit të dytë të**

votimit të parashtrorë raport financiar për të hyrat dhe shpenzimet në llogarinë e transaksionit për fushatën zgjedhore për rrethin e dytë të votimit.”

- (3) Organizuesi i fushatës zgjedhore është i obliguar një ditë pas përfundimit të fushatës zgjedhore të dorëzon raport financiar për të ardhurat dhe të dalat në xhiro-llogarinë për fushatën zgjedhore për gjysmën e dytë nga fushata zgjedhore.
- (4) Raportet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, parashtrihen në formular të nënshkruar nga Ministri për Financa në të cilin janë përmbajtur të dhënat për emrin, përkatësisht emrin e donatorit, llojin dhe vlerën e donacioneve, datën e marrjes së donacioneve dhe të dalat për çdo donacion dhe të ardhurat dhe të dalat gjatë kohës së fushatës zgjedhore.
- (5) Pjesa përmbajtëse e formularit nga paragrafi (3) i këtij neni është Udhëzimi për mënyrën e plotësimit të formularit të raportit
- (6) Raportet parashtrihen deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Enti Shtetëror për Revizion dhe deri te Komisioni shtetëror për ndalim të korrupsionit, që janë të obliguar t'i shpallin në ueb-faqet e tyre.

8. Raporti financiar

Neni 85

- (1) Organizuesi i fushatës zgjedhore është i obliguar që menjëherë ose më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të fushatës zgjedhore për rrethin e parë, përkatësisht të dytë të dërgon raport të përgjithshëm financiar për fushatën zgjedhore.
- (2) Raporti financiar për fushatën zgjedhore dërgohet në formularin nga neni 86-b paragrafi (3) nga ky kod.
- (3) Raporti financiar dërgohet te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Enti Shtetëror për Revizion, Komisioni shtetëror për për ndalimin e korrupsionit dhe Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, ndërsa për zgjedhjet lokale edhe deri te Këshilli i komunës dhe te Këshilli i Qytetit të Shkupit.
- (4) Raporti financiar nga paragrafi (3) i këtij neni, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Enti Shtetëror për Revizion dhe Komisioni shtetëror për ndalimin e korrupsionit publik i paraqesin në ueb-faqet e tyre.
- (5) Organizuesi i fushatës zgjedhore të grupit të zgjedhësve, tepicën e mjeteve të grumbulluara do t'i dhurojë për qëllime bamirëse.
- (6) Enti Shtetëror për Revizion në afat prej 60 ditësh nga dita e dorëzimit të raportit nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar të realizon revizion. Revizioni realizohet nga dita e hapjes së llogarisë të transaksionit për fushatën zgjedhore deri në përfundim të transaksioneve të asaj llogarie.
- (7) Enti Shtetëror i Revizionit nëse konfirmon parregullsi në raportin financiar të organizuesit të fushatës zgjedhore, që janë zgjedhore në kundërshtim me dispozitat e këtij kodi, dërgon kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje ose paraqitje deri te prokurori publik kompetent në afat prej 30 ditëve nga dita e vërtetimit të parregullsive.
- (8) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Enti Shtetëror për Revizion dhe Komisioni shtetëror për ndalim të korrupsionit kontraktajnë Memorandum për bashkëpunim në lidhje me realizimin e dispozitave për financim të fushatës zgjedhore për këmbim të informatave për parregullsi të konfirmuara në lidhje me raportet e dorëzuara financiare dhe masat e ndërmarra nga ana e tyre ndaj subjektit që është mjet i mbikëqyrjes.

Neni 85–a

- (1) Radiodifuzerët dhe mediat e shkruara në Republikën e Maqedonisë janë të detyruar të dorëzojnë raport për hapësirën reklamuese të shfrytëzuar prej secilit organizator të fushatës zgjedhore dhe mjetet

të cilat janë arkëtuar ose kërkohen në bazë të saj.

- (2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet më së voni 15 ditë pas ditës së mbarimit të fushatës zgjedhore.
- (3) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni i dorëzohet Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Entit Shtetëror për Revizion dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, të cilët janë të detyruar ta publikojnë në internet faqet e tyre.
- (4) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet në formular të përcaktuar nga ministri i Financave

Neni 85–b

Raportet revizore nga revizionet e bëra mbi raportet financiare të organizatorëve të fushatës zgjedhore, Entit Shtetëror për Revizion i shpall në ueb faqen e vet në afat të përcaktuar me ligj."

9. Kompensimi i shpenzimeve për zgjedhje

Neni 86

- (1) Të drejtë kompensimi për shpenzimet e zgjedhjeve kanë organizuesit e fushatës zgjedhore nga lista për kandidat të të cilëve janë zgjedhur kandidati për kryetar të Republikës, kandidatët për deputetë, anëtarët e këshillit, përkatësisht kandidati për kryetar të komunës, në vlerë prej 15 denarësh për votë të fituar.
- (2) Të drejtë kompensimi për shpenzimet e zgjedhjeve kanë organizuesit e fushatës zgjedhore nga lista për kandidat të të cilëve nuk janë zgjedhur kandidati për kryetar të Republikës, kandidatët për deputetë, anëtarët e këshillit, përkatësisht kandidati për kryetar të komunës, në vlerë prej 15 denarësh për votë të fituar. Nëse kanë marrë së paku 1,5% nga numri i përgjithshëm i votave nga qytetarët që kanë votuar në nivel të Republikës, njësia zgjedhore përkatësisht komuna.
- (3) Kompensimi i shpenzimeve për zgjedhje do të paguhet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht Buxheti i komunës dhe i Qytetit të Shkupit, më së voni në afat prej tre muajsh pas paraqitjes së raportit financiar për fushatën zgjedhore, në bazë të raportit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për zgjedhjet e zbatuara.
- (4) Kompensimi i shpenzimeve për zgjedhje përcaktohet me vendimin e Kuvendit, këshillit të komunës dhe të Qytetit të Shkupit.

Neni 87

(1) Organi kompetent në bazë të vendimit nga neni 86 paragrafi (4) i këtij kodi, do të marrë aktvendim për mospagimin e kompensimit për shpenzime, organizuesve të fushatës zgjedhore, në pajtim me nenin 85 paragrafi (7) i këtij kodi.

VII. ZBATIMII ZGJEDHJEVE

1. Mjetet për zbatimin e zgjedhjeve

Neni 88

(1) Mjetet për realizimin e zgjedhjeve, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe me ato disponon Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

(2) Nga mjetet e dedikuara për zgjedhje, dy të tretat shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve lidhur me veprimet zgjedhore të organeve për realizimin e zgjedhjeve.

(3) Një e treta e mjeteve për zbatimin e zgjedhjeve shërben për mbulimin e një pjese të shpenzimeve që i kanë bërë organizuesit e fushatës zgjedhore, kandidatët e të cilëve janë zgjedhur.

(4) Për zbatimin e zgjedhjeve lokale, mjetet sigurohen nga Buxheti i komunës dhe i Qytetit të Shkupit dhe me ato disponon Komisioni Komunal i Zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni i Zgjedhjeve i Qytetit të Shkupit, ndërsa

mjetet për materialin zgjedhor sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe me ato disponon Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

“(5) Me përjashtim nga paragrafi (4) i këtij neni, në rast të pamundësisë për sigurimin e mjeteve për zbatimin e zgjedhjeve lokale për shkak xhirollogarisë së bllokuar nga ana e komunës dhe Qytetit të Shkupit, mjetet për zbatimin e zgjedhjeve lokale sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, dhe me to disponon komisioni komunal i zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni i zgjedhjeve i Qytetit të Shkupit.”

2. Materiali zgjedhor

Neni 89

Materiali zgjedhor për realizimin e zgjedhjeve përbëhet nga:

- kutitë e votimit dhe paravanët;
- formularët e procesverbaleve dhe ditarët e punës së këshillit zgjedhor;
- blloku me fletëvotime sipas ekstraktit të Listës zgjedhore;
- lista e kandidatëve;
- ekstrakti i nënshkruar i Listës zgjedhore;
- mjetet për shënimin e personave që kanë votuar (“Ngjyrë të dukshme dhe mbështetësi prej grafiti);
- vulat;

“- skener me sensor biometrik,

-kompjuter, lexues i letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtimit me të dhëna biometrike,”.

- udhëzimi për votim, dhe
- materiali tjetër i nevojshëm për votim.

Neni 90

(1) Udhëzimi për votim vendoset në vend të dukshëm të paravanit të votimit dhe në vende të tjera të dukshme, në pajtim me Udhëzimin e lëshuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Udhëzimi është i shtypur në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhët dhe alfabetet e bashkësive të shënuara në Preambulën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

(2) Listat e kandidatëve do të vendosen në hapësirën e votimit.

3. Dorëzimi i materialit zgjedhor

Neni 91

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, materialin zgjedhor ua dorëzon komisioneve komunale të zgjedhjeve, më së voni në afat prej 72 orësh para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.
- (2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve materialin zgjedhor për votim në PDK përkatësisht zyra konsullore e dorëzon te personi i autorizuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme më së voni pesë ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.
- (3) Ministria për Punë të Jashtme materialin zgjedhor të PDK përkatësisht zyra konsullore e dërgon menjëherë, dhe më së voni në afat prej 24 orëve para pranimit.
- (4) Per dorëzimin e materialit zgjedhor përpilohet procesverbali, në të cilin posaçërisht duhet të shënohet numri i përgjithshëm i fletëvotimeve me numrat serikë dhe numri i duhur i listave të kandidatëve që vendosen në hapësirat e votimit .

Neni 92

- (1) Komisioni Komunal i Zgjedhjeve është i obliguar që një ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve, t'ua dorëzojë materialin zgjedhor këshillave zgjedhore të territorit të Republikës së Maqedonisë.
- (2) Për dorëzimin e materialit zgjedhor nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve të këshillave zgjedhore, përpilohet procesverballi në të cilin duhet të shënohet numri i përgjithshëm e fletëvotimeve me numrat serikë, dhe materiali tjetër i nevojshëm për votim.
- (3) Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e këshillit zgjedhor, dhe anëtari i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve që e dorëzon materialin.
- (4) Nëse përfaqësuesit e pranishëm të parashtruesve të listave kanë vërejtje për dorëzimin e materialit zgjedhor, ata kanë të drejtë t'u mundësohet që të evidentohen në procesverbal dhe ato të jenë bazë në procedurën për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.
- (5) Nëse përfaqësuesve të pranishëm të parashtruesve të listave nuk u evidentohen vërejtjet nga paragrafi (4) i këtij neni në procesverbal, kanë të drejtë vërejtjet t'i dorëzojnë në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, në afat prej pesë orësh pas nënshkrimit të procesverbalit.
- (6) Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor, të drejtë prezantimi kanë edhe vëzhguesit e autorizuar.

4. Fletëvotimi

Neni 93

- (1) Fletëvotimi shtypet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.
- (2) Emri i parashtruesit të listës, emri dhe mbiemri i kandidatit, përkatësisht bartësit të listës, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.
- (3) Për pjesëtarët e bashkësive, emri i parashtruesit të listës dhe emri e mbiemri i kandidatit, përkatësisht bartësit të listës, shkruhen në gjuhën maqedonishte dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin e bashkësisë së cilës ata i takojnë.
- (4) Në komunat ku së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare që ndryshon nga gjuha maqedonishte, fletëvotimet e zgjedhjeve shtypen përveç në gjuhën maqedonishte dhe alfabetin e saj cirilik edhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin që e përdorin qytetarët e asaj komune.

Neni 94

- (1) Në fletëvotim nëse ka kandidatë, përkatësisht bartës të listave me emër dhe mbiemër të njëjtë, atëherë shënohet edhe shkronja e parë e emrit të mesëm të tyre.
- (2) Në fletëvotim kandidatët përkatësisht bartësit e listave, shënohen sipas radhës së përcaktuar në listën unike të kandidatëve.
- (3) Fletëvotimi përmban pjesën për të votuar dhe pjesë që mbetet në amë.

Për kryetarin e Republikës

Neni 95

- Pjesa prej fletëvotimit për votimin për zgjedhjen e kryetarit të Republikës përmban:
 - emrin e fletëvotimit, komunën dhe numrin e vendvotimit për votim në Republikën e Maqedonisë,
 - emri i fletëvotimit, selisë së PDK **përkatësisht zyra konsullore** për votim jashtë vendit,
 - numrin rendor, emrin dhe simbolin (nëse e ka) të parashtruesit të listës, dhe
 - emrin dhe mbiemrin e kandidatët në bazë të të dhënave prej evidencës amë.
- Pjesa e fletëvotimit e cila mbetet në bllokun, e përmban numrin serik të fletëvotimit, komunës përkatësisht selisë së PDK **përkatësisht zyra konsullore** -së dhe numrin e vendvotimit.
- Në emrin e fletëvotimit përmbahet flamuri i Republikës së Maqedonisë.

Për deputetët

Neni 96

(1) Pjesa e fletëvotimit për votimit për zgjedhjen e deputetëve, përmban:

- emrin e fletëvotimit, numrin e njësisë zgjedhore, komunës dhe numrin e vendvotimit;
- numrin rendor, emrin dhe simbolin (nëse e ka) të parashtruesit të listës, dhe
- emrin dhe mbiemrin të bartësi listës në bazë të të dhënave prej evidencës amë.

(2) Pjesa e fletëvotimit e cila mbetet në bllokun, e përmban numrin serik të fletëvotimit, numrin e njësisë zgjedhore, komunës dhe numrin e vendvotimit.

(3) Në emrin e fletëvotimit përmbahen numri i njësisë zgjedhore dhe flamuri i Republikës së Maqedonisë.

Për anëtarë të këshillit

Neni 97

(1) Pjesa prej fletëvotimit për votimin për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit, përmban:

- emrin e fletëvotimit, numrin e vendvotimit dhe komunës;
- numrin rendor, emrin dhe simbolin (nëse e ka) të parashtruesit të listës, dhe
- emrin dhe mbiemrin të bartësi listës në bazë të të dhënave prej evidencës amë.

(2) Pjesa e fletëvotimit e cila mbetet në bllok, e përmban numrin serik të fletëvotimit, komunës dhe numrin e vendvotimit.

(3) Në emrin e fletëvotimit për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit përmban emrin e komunës, gjegjësisht qytetit të Shkupit, për të cilat bëhet zgjedhja.

Për kryetar të komunës

Neni 98

(1) Pjesa e fletëvotimit për votimin për zgjedhjen e kryetarit të komunës, përmban:

- emrin e fletëvotimit, numrin e vendvotimit dhe komunës;
- numrin rendor, emrin dhe simbolin (nëse e ka) të parashtruesit të listës;
- numrin rendor, emrin dhe mbiemrin e kandidatët në bazë të të dhënave prej evidences amë.

(2) Pjesa e fletëvotimit e cila mbetet në bllokun, e përmban numrin serik të fletëvotimit, komunës dhe numrin e vendvotimit.

(3) Në emrin e fletëvotimit për zgjedhjen e kryetarit të komunës përmbahet emri i komunës, gjegjësisht qyteti i Shkupit, për të cilët bëhet zgjedhja.

5. Vendvotimi

Neni 99

(1) Për secilin vendvotim caktohet vendi (hapësira i objektit) në të cilin bëhet votimi (në tekstin e mëtejme: vendvotimi).

(2) Në hapësirën e vendit të caktuar për votim vendosen listat e kandidatëve.

Neni 100

(1) Kryetari edhe anëtarët e këshillit të zgjedhjeve një ore para fillimit të votimit tubohen në hapësirën për votim dhe verifikojnë:

- nëse hapësira është në gjendjen e njëjtë siç e kanë lënë në ditën para zgjedhjeve,
- nëse materiali zgjedhor është në gjendjen e njëjtë siç ka qenë në ditën para zgjedhjeve, dhe

- nëse kutia zgjedhore është e zbrazët.

(2) Këshilli i zgjedhjeve bën procesverbal për gjendjen e konfirmuar, të cilin e nënshkruan kryetari dhe anëtarët e këshillit.

(3) Vërejtjet e kryetarit dhe anëtarëve të këshillit të zgjedhjeve konstatohen në procesverbal.

(4) Nëse përfaqësuesit e autorizuar të pranishëm të parashtruesve të listave kanë vërejtje, kryetari është i obliguar t'u mundësojë të evidentohen në procesverbal dhe ato të jenë bazë në procesin për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.

(5) Nëse vërejtjet e përfaqësuesve të autorizuar të pranishëm të parashtruesve të listave nga paragrafi (4) i këtij neni nuk do të evidentohen në procesverbal, kanë të drejtë që vërejtjet t'i dorëzojnë te komisioni komunal i zgjedhjeve në afat prej pesë orësh pas nënshkrimit të procesverbalit.

(6) Të drejtë për prezencë gjatë verifikimit të gjendjes para fillimit të votimit kanë edhe mbikëqyrësit/vezhguesit e autorizuar.

6. Kohëzgjatja e votimit

Neni 101

- (1) Votimi fillon në orën 7,00 dhe zgjat pandërprerë deri në orën 19:00, ndërsa në PDK **përkatësisht zyra konsullore** respektohet dallimi i kohëzgjatjes në vend, përkatësisht prej orës 07:00 deri 19:00 në pajtim me numërimin e kohës në vendin përkatës.
- (2) Në orën 19:00 vendvotim mbyllet, kurse zgjedhësve të cilët janë gjendur në objektin ku votohet, u mundësohet të votojnë.
- (3) Këshilli zgjedhor mundet ta mbyllë vendvotimin edhe para mbarimit të afatit nga paragrafi (1) i të këtij neni, me pajtimin paraprak të komisionit komunal kompetent të zgjedhjeve, nëse kanë votuar të gjithë zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin nga Lista zgjedhore, por nuk fillon me numërimin e votave para orës 19:00.

7. Sigurimi i vendvotimit

Neni 102

- (1) Policia e siguron vendvotimin pa ndërprerë, duke filluar prej orës 6:00 deri në orën 19:00
- (2) Pas mbylljes të vendvotimit, për kohën e grumbullimit të rezultateve, policia e siguron objektin dhe hapësira ku është vendosur vendvotimi dhe këshilli zgjedhor, dhe i largon të gjithë personat e paautorizuar nga objekti.
- (3) Policia e siguron këshillin zgjedhor deri në dorëzimin e procesverbalit dhe materialit zgjedhor pranë komisionit komunal të zgjedhjeve përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit nëse kjo është kërkuar nga ana e këshillit zgjedhor.

8. Kompetencat e këshillit zgjedhor gjatë kohës së votimit

Neni 103

- (1) Këshilli zgjedhor kujdeset për mbajtjen e rendit dhe qetësisë në vendvotimin.
- (2) Këshilli zgjedhor mund ta largojë secilin person i cili e prish rendin dhe qetësinë në vendvotim.
- (3) Objektin në të cilin është vendosur vendvotimi dhe hyrjen deri te ai për kohën e mbajtjes së votimit e siguron policia.
- (4) Këshilli zgjedhor mund të kërkojë ndihmë prej policisë për vendosjen e rendit në vendvotim.
- (5) Asnjë nuk guxon të vijë në vendvotim i armatosur, përveç policisë në rastin e parashikuar në paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni.
- (6) Në objektin dhe hapësirën ku do të mbahet votimi dhe në afërsi të tij, këshilli zgjedhor në bashkëpunim me policinë është i detyruar t'i heqë materialet propagandistike.

(7) Policia me kërkesën e kryetarit ose zëvendëskryetarit të këshillit zgjedhor ka për detyrë t'i largojë personat prezentë të pautorizuar në objekt dhe hapësirën e votimit, si dhe personat prezentë të pautorizuar prej objektit ku edhe mbahet votimi në radius prej 100 metrash.

Neni 104

- (1) Këshilli zgjedhor mund ta ndërpresë votimin, nëse në vendvotim priset rendi deri sa ai nuk vendoset.
- (2) Votimi mund të ndërpritet edhe në rast të fatkeqësive kohore ose rrethanave të tjera të jashtëzakonshme.
- (3) Këshilli zgjedhor do ta ndërpresë votimin nëse hyrjen deri te vendvotimi nuk e siguron policia, kurse për këtë ka pasur nevojë ose nëse ajo është thirrur dhe nuk i është përgjigjur thirrjes.
- (4) Kryetari ose zëvendëskryetari i këshillit zgjedhor mund ta thërrasë policinë në hapësirën në të cilin votohet në qoftë se ka nevojë për atë.
- (5) Nëse votimi është ndërprerë më shumë se një orë, votimi do të vazhdojë për aq kohë sa ka zgjatur ndërprerja, por jo më shumë se tri ore.
- (6) Shkaqet për ndërprerjen e votimit dhe koha e ndërprerjes së votimit do të evidentohet në procesverbal.

9. Të drejtat dhe obligimet e parashtruesve të listave dhe mbikëqyrësve të autorizuar për kohën e votimit

Neni 105

- (1) Përfaqësuesit e paraqitësve të listave, në qoftë se kanë vërejtje në punën e këshillit zgjedhor për kohën e votimit, mund t'i theksojnë parregullsitë, me qëllim që të njëjtat të mënjanohen.
- (2) Kryetari i këshillit zgjedhor ka për detyrë që përfaqësuesve prezentë të paraqitësve të listave, nëse kanë vërejtje, t'u mundësohet të evidentohen në procesverbal, dhe ato të jenë bazë në procedurën për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.
- (3) Nëse vërejtjet nga paragrafi (2) i këtij neni të përfaqësuesve të autorizuar të pranishëm të bartësve të listave nuk evidentohen në procesverbal, ata kanë të drejtë t'i dërgojnë pranë komisionit komunal të zgjedhjeve në afat prej pesë orësh pas nënshkrimit të procesverbalit.
- (4) Mbikëqyrësit të akredituar në qoftë se kanë vërejtje për punën e këshillit zgjedhor, kanë të drejtë t'i evidentojnë në ditarin e vendvotimit.
- (5) Përfaqësuesit e parashtruesve të listave dhe mbikëqyrësit të akredituar mund nga afër ta ndjekin konfirmimin e identitetit të zgjedhësit i cili i qaset votimit.

Neni 106

- (1) Kryetari, anëtarët e komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe këshillat zgjedhorë përkatësisht këshilli zgjedhor për votim në MDK dhe zëvendësit e tyre, si dhe përfaqësuesit e parashtruesve të listave dhe mbikëqyrësit gjatë kohës së votimit dhe në vendvotim nuk guxojnë të mbajnë shenja ose simbole të partisë politike, koalicionit ose kandidatit.
- (2) Përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave gjatë kohës së votimit dhe të vendvotimit mbajnë kartë identifikimi me numrin e vendvotimit për të cilin janë autorizuar.
- (3) Këshilli zgjedhor mund ta largon çdo person i cili gjatë votimit përdor telefon celular ose aparat për fotografimin e fletëvotimit.

10. Votimi

Neni 107

- (1) Votimi bëhet personalisht në vendvotime në Republikën e Maqedonisë dhe në PDK **përkatësisht zyra konsullore.**

(2) Votimi për person tjetër ndalohet, përveç në rastet e parashikuara në nenin 111 të këtij kodi.

Verifikimi i identitetit të votuesit

Neni 108

(1) Zgjedhësit votojnë një nga një.

Kur zgjedhësi i voton, këshilli zgjedhor kontrollon nëse zgjedhësi është në vendvotimin përkatës dhe kontrollon nëse ka shenjë nga ngjyra e dukshme”.

(2) në thoin dhe gishtin e madh të dorës së djathtë.

(3) Kur zgjedhësi voton, këshilli zgjedhor e kontrollon identitetin e tij personal.

(4) Identitetin personal zgjedhësi e dëshmon me letërnjoftim apo me dokument udhëtimi.

(5) Këshilli zgjedhor, pas verifikimit të identitetit të zgjedhësit e rrethon numrim rendor të tij në ekstraktin e Listës zgjedhore dhe zgjedhësi e vë nënshkrimin e vet, ndërkaq nëse është analfabet vë gjurmët e gishtit të madh të djathtë. Nëse zgjedhësi nuk e ka gishtin e madh të djathtë, do ta vë gjurmën e gishtit të madh të majtë, ndërkaq nëse nuk e ka as gishtin e madh të majtë atëherë nuk vë gjurmë gishti.

(6) Pas identifikimit, zgjedhësi merr fletëvotim dhe në gishtin e madh të dorës së djathtë i vihet gjurmë me “ngjyrë e dukshme, përkatësisht në gishtin e madh të dorës së majtë, nëse nuk e ka gishtin e madh të dorës së djathtë, me ç’rast duke u kujdesur që me “ngjyrën e dukshme të përfshihet edhe thoi i gishtit të madh. Nëse zgjedhësi nuk ka gisht të madh në të dy duart, atëherë i shënohet me ngjyrë të dukshme gishti tregues i djathtë, përkatësisht gishti tregues i majtë nëse nuk ka gisht tregues në dorën e djathtë.

“Neni 108-a

(1) Zgjedhësit votojnë një nga një.

(2) Kur zgjedhësi voton këshilli zgjedhor kontrollon nëse zgjedhësi është në vendvotimin përkatës.

(3) Kur zgjedhësi voton, këshilli zgjedhor e kontrollon identitetin e tij personal.

(4) Kontrolli i identitetit personal kryhet përmes sistemit elektronik të përbërë nga kompjuteri, lexues i letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtimi me të dhëna biometrike dhe skener me sensor biometrik, të vendosur në vendin zgjedhor.

(5) Kontrolli nga paragrafi (4) i këtij neni, fillon me futjen e letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtitimit me të dhënat biometrike të zgjedhësit në lexuesin e letërnjoftimeve ose dokumenteve të udhëtitimit, me ç’rast zgjedhësi e vendos gishtin përkatës në skenerin me sensor biometrik.

(6) Shenja nga gishti i zgjedhësit e marrë nga skeneri, përmes sistemit elektronik, krahasohet me të dhënën për shenjën e gishtit të zgjedhësit, të marrë përmes lexuesit të letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtitimit.

(7) Nëse të dhënat biometrike të marra nga lexuesi dhe nga skeneri nga paragrafi (6) i këtij neni, përputhen, konsiderohet se identiteti personal i zgjedhësit është përcaktuar.

(8) Këshilli zgjedhor, pas verifikimit të identitetit të zgjedhësit e rrethon numrin e tij rendor në ekstraktin e Listës zgjedhore dhe zgjedhësi e vë nënshkrimin e vet, ndërkaq nëse është analfabet vë gjurmë të gishtit tregues të djathtë. Nëse zgjedhësi nuk e ka gishtin tregues të djathtë, do ta vë

gjurmën e gishtit tregues të majtë, ndërkaq nëse nuk e ka as gishtin tregues të majtë atëherë nuk vë gjurmë.

Pas identifikimit, zgjedhësi merr fletëvotim dhe i shënohet me ngjyrë të dukshme gishti i madh i dorës së djathtë, përkatësisht gishti i madh i dorës së majtë, nëse nuk e ka gishtin e madh të dorës së djathtë, me këtë rast duke u kujdesur që me ngjyrë të dukshme të përfshihet edhe thoi i gishtit të madh. Nëse zgjedhësi nuk ka gisht të madh në të dyja duart, atëherë i shënohet me ngjyrë të dukshme gishti tregues i djathtë, përkatësisht gishti tregues i majtë nëse nuk ka gisht tregues në dorën e djathtë

11. Mënyra e votimit

Neni 109

- (1) Votimi bëhet me një fletëvotim për çdo lloj zgjedhjesh të përcaktuara me këtë kod.
- (2) Fletëvotimi këputet nga ama sipas numrit rendor, i vihet vulë në anën e përparme dhe mandej i jepet zgjedhësit.
- (3) Zgjedhësit i sqarohet mënyra e votimit dhe i mundësohet të votojë.
- (4) Zgjedhësi voton njëkohësisht kur mbahen dy ose më shumë lloje të zgjedhjeve ose shpallja e referendumit.

Neni 110

Zgjedhësi, votimin e bën në atë mënyrë që e rrethon numrin rendor para parashtruesit të listës, përkatësisht numrin rendor para kandidatit për të cilin është përcaktuar të votojë dhe fletëvotimit të palosur para se ta hedhë në kutinë për votim.

Votimi i personit të paaftë apo të sëmurë

Neni 111

(1) Zgjedhësi i cili nuk është në gjendje të votojë në vendvotim (person i paaftë apo i sëmurë sipas udhëzimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve) ndërsa dëshiron të votojë, për këtë do ta njoftojë Komisionin komunal të zgjedhjeve përkatësisht Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit me së voni **shtatë** ditë para ditës së caktuar për votim. “

(2) Njoftimi i dhënë nga paragrafi (1) i këtij neni, ka të bëjë edhe me rrethin e parë edhe me rrethin e dytë të votimit.”

- (3) Njoftimi nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të bëhet edhe përmes personit të autorizuar.
- (4) Këshilli zgjedhor, personit nga paragrafi (1) i këtij neni, do t'i mundësojë që të votojë në shtëpinë e tij, një ditë para se të mbahen zgjedhjet, në mënyrë që të sigurohet sekreti i votimit.
- (5) Këshilli zgjedhor për votimin nga paragrafi (3) i këtij neni, siguron kuti të veçantë votimi e cila dërgohet e zbrazët në shtëpinë ku ndodhet zgjedhësi.
- (6) Votimin nga paragrafi (3) të këtij neni, këshilli zgjedhor e shënon në procesverbal.
- (7) Për ditën dhe orën e votimit nga paragrafi (3) i këtij neni, kryetari i Komisionit komunal të zgjedhjeve përkatësisht Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit, me shkrim i njofton përfaqësuesit e paraqitësve të listave.

Votimi i personit të paaftë apo të sëmurë

Neni 112

(1) Zgjedhësi, i cili ka të meta fizike apo është analfabet dhe për këtë nuk mund të votojë në mënyrë të përcaktuar me këtë Kod, ka të drejtë që me vete të marrë një person i cili do t'i ndihmojë gjatë votimit.

(2) Nëse zgjedhësi nga paragrafi (1) i këtij neni, me vete nuk merr një person i cili do t'i ndihmojë gjatë votimit, atëherë këshilli zgjedhor do të caktojë një person tjetër nga radhët e zgjedhësve.

(3)Personi i cili do t'i ndihmojë personit tjetër gjatë votimit nuk guxon të jetë nga radhët e anëtarëve të këshillit zgjedhor, nga radhët e përfaqësuesve të paraqitësve të listave apo mbikëqyrësve.

(4)Një person i njëjtë mund t'u ndihmojë gjatë votimit më së shumti dy zgjedhësve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5)Këshilli zgjedhor personit nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, do t'ia bëjë me dije se me ndihmën e ofruar nuk guxon të ndikojë mbi vendimin e zgjedhësit.

(6) Votimin nga paragrafi (1) të Këtij neni, këshilli zgjedhor e evidenton në procesverbal.

Neni 112-a

Zgjedhësi i cili është me të meta fizike, i cili nuk mund të hyn në vendvotim dhe të voton në pajtim me këtë Kod “Këshilli zgjedhor është i obliguar t’i mundëson të voton në pajtim me Udhëzimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

Votimi i zgjedhësve të cilët ditën e votimit vuajnë dënimin me burg ose janë në paraburgim, përkatësisht paraburgim shtëpiak.

Neni 113

- (1) Votuesit të cilët ditën e votimit gjenden në vuajtje të dënimit me burg ose janë në paraburgim ose në paraburgim shtëpiak, enteve ndëshkuese-korrigjuese përkatësisht vendin ku gjenden në vuajtje të masës të paraburgimit shtëpiak.
- (2) Komisioni zgjedhor komunal është i obliguar pas pranimit të listave për zgjedhësit të cilët ditën e votimit gjenden në vuajtje të dënimit me burg ose janë në paraburgim, menjëherë do t’i dorëzon deri te entet ndëshkuese-korrigjuese ku votuesit janë në vuajtje të dënimit me burg ose janë në paraburgim.
- (3) Zgjedhësit të cilët ditën e votimit ndodhen në vuajtje të masës paraburgim shtëpiak, të cilët dëshirojnë të votojnë, nëpërmjet ndihmësit të autorizuar do ta lajmërojnë Komisionin zgjedhor komunal përkatësisht Komisionin zgjedhor të Qytetit të Shkupit më së voni tre ditë para ditës së përcaktuar për votim.
- (4) Për zgjedhësit nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, zgjedhjet i realizon këshilli zgjedhor nga pika më e afërt e vendvotimit ose një këshill i veçantë zgjedhor në përputhje me këtë Kod dhe udhëzimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, një ditë para ditës së caktuar për zgjedhje, ndërkaq për votimin njoftohen edhe përfaqësuesit e paraqitësve të listave për shkak të pranisë së tyre në procesin e votimit.
- (5) Zgjedhësit nga paragrafi (3) i këtij neni, këshilli zgjedhor do t’i mundëson të voton në vendin ku e vuan masën paraburgim shtëpiak, një ditë para mbajtjes së zgjedhjeve në mënyrë në të cilën sigurohet sekretin e votimit.
- (6) Këshilli zgjedhor për votim nga paragrafi (5) i këtij neni siguron kuti të veçantë për votim që bartet e zbrazët në vendin ku zgjedhësi gjendet në vuajtje të masës paraburgim shtëpiak.
- (7) Për votuesit e zgjedhësve nga paragrafi (3) i këtij neni, komisioni kompetent zgjedhor e lajmëron organin kompetent që e ka shpallur dënimin paraburgim shtëpiak dhe organin kompetent që ta realizon të njëjtën.
- (8) Për votimin e këtyre zgjedhësve, këshilli zgjedhor përmban procesverbale të veçanta.
- (9) Procesverbalet dhe materiali zgjedhor pas përfundimit të votimit dërgohen deri te komisionet përkatëse zgjedhore komunale.

Neni 113-a

- (1) Votuesit të cilët në ditën e votimit janë në punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit votojnë në MDK, përkatësisht zyrat konsullore një ditë para mbajtjes së zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë.
- (2) Votimi jashtë vendit, realizohet në PDK **përkatësisht zyra konsullore** ose në zyrat konsullore të

Republikës së Maqedonisë jashtë vendit:

- Republika e Shqipërisë – Tirana;
 - Republika e Austrisë – Vjena që e përfshinë Republikën e Sllovakisë dhe të Japonisë;
 - Australia – Kamberra dhe Melburn;
 - Mbretëria e Belgjikës – Brukseli që e përfshinë Principatën e Madhe të Luksemburgut;
 - Bosnja dhe Hercegovina – Sarajevë;
 - Republika e Bullgarisë – Sofje që e përfshinë edhe Republikën e Molldavisë;
 - Kanada – Otava dhe Toronto;
 - Republika Popullore e Kinës – Pekini që e përfshinë Republikën Popullore Demokratike të Koresë, Mongolinë dhe Republikën Socialiste të Vietnamit;
 - Republika e Kroacisë – Zagreb;
 - Mbretëria e Danimarkës – Kopenhagë;
 - Republika Arabe e Egjiptit – Kajro;
 - Republika e Estonisë – Talin;
 - Republika e Francës – Parisi dhe Strasburgu që e përfshinë edhe Republikën e Portugalisë;
 - Republika Federale e Gjermanisë – Berlin, Bon dhe Mynih;
 - Republika e Greqisë – Athina dhe Selaniku;
 - Republika e Hungarisë Budimpestë;
 - Indi – Nju Delhi;
 - Italia – Roma dhe Venecia që e përfshinë Maltën;
 - Shteti i Izraelit – Tel Aviv;
 - Selia e Shenjtë e Vatikanit;
 - Mbretëria e Holandës - Haga;
 - Republika e Polonisë – Varshavë;
 - Rumania – Bukuresht;
 - Federata Ruse – Moskë e përfshinë edhe Republikën e Bjellorusisë;
 - Republika e Serbisë – Beograd;
 - Republika e Sllovenisë – Lublanë;
 - Mbretëria e Spanjës - Madrid;
 - Mbretëria e Suedisë – Stokholm që e përfshinë edhe Republikën e Finlandës;
 - Konfederata Zviceriane – Bern dhe Gjenevë që e përfshinë Principatën e Lihtenshtajnit;
 - Republika e Turqisë – Ankara dhe Stambolli që e përfshinë Arabinë Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Republika e Kazakistanit, Republika e Kirgizit, Republika e Azerbajxhanit dhe Republika e Uzbekistanit.
 - Ukraina – Kiev;
 - Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore – Londra e përfshinë Irlandën dhe Republikën e Islandës;
 - ShBA – Uashington, Detroid, Çikago dhe Nju-Jork;
 - Shteti i Katarit – Doha;
 - Mali i Zi – Podgoricë;
 - Republika e Çekisë – Pragë
 - Republika e Kosovës – Prishtinë dhe
 - Mbretëria Norvegjeze - Oslo.
- (3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është i obliguar menjëherë pas pranimit të materialit zgjedhor ta dorëzon te MDK nëpërmjet Ministrisë për Punë të Jashtme.
- (4) Për zgjedhësit nga paragrafi (1) i këtij neni, votimet i realizojnë këshillet zgjedhore për votim në

MDK.

- (5) Këshillet zgjedhore për votim në PDK **përkatësisht zyra konsullore** përbëjnë procesverbale.
- (6) Fletëvotimet përbëhen në zarfe të veçanta në të cilat janë emërtuar selitë e MDK **përkatësisht zyra konsullore** dhe njësi zgjedhore dhe vulosen.
- (7) Procesverbalet, zarfet e mbyllura, dhe materiali tjetër zgjedhor pas përfundimit të votimeve për këshilltarë zgjedhor nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme i dërgojnë deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.
- (8) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve kryen mbledhje dhe konfirmim të rezultateve nga votimet në shtete të huaja.

“Neni 113-b

(1) Anëtarët e këshillave zgjedhorë për votim në PDK, përkatësisht në zyrat konsullore votojnë në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve tri ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë.

(2) Zgjedhjet për zgjedhësit nga paragrafi (1) i këtij neni i zbaton këshilli zgjedhor për votim në KSHZ.

(3) Për votimin nga paragrafi (2) i këtij neni sigurohet kuti e posaçme për votim e cila pas përfundimit të votimit ruhet e vulosur në hapësirat e KSHZ-së dhe hapet pas përfundimit të votimit në Republikën e Maqedonisë.

(4) Për votimin e këtyre zgjedhësve, Këshilli zgjedhor përpilon procesverbal të posaçëm.

(5) Procesverbali dhe materiali zgjedhor pas përfundimit të votimit në Republikën e Maqedonisë dorëzohen në komisionet përkatëse komunale të zgjedhjeve.

12. Mbledhja dhe verifikimi i rezultateve nga votimi në vendvotimet

Neni 114

Rezultatet e votimit në vendvotim nga ana e këshillit zgjedhor mblidhen dhe verifikohen në këtë mënyrë:

- numërohen fletëvotimet e papërdorura dhe pas numërimit, së pari shkëputet këndi i djathtë i anës së poshtme dhe pastaj futen në zarf të veçantë i cili mbyllet, vuloset dhe mbi të shënohet numri i vendit zgjedhor dhe numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të papërdorura;
- hapet kutia e votimit dhe fillon numërimi i votave;
- verifikohet numri i përgjithshëm i votuesve të cilët kanë votuar dhe janë nënshkruar ose që kanë vënë vetëm shenjën e gishtit në ekstraktin e Listës së zgjedhësve;
- me short caktohet një anëtar i cili do t'i nxjerrë dhe hapë fletëvotimet një nga një nga kutia e votimit dhe do t'ia japë kryetarit të këshillit të zgjedhjeve;
- fletëvotimi u tregohet të gjithë anëtarëve të këshillit të zgjedhjeve;
- këshilli i zgjedhjeve verifikon nëse fletëvotimi është i vlefshëm ose jo dhe për cilën listë të kandidatëve përkatësisht për cilin kandidat është votuar; dhe
- regjistrohet vota e dhënë, ndërkaq fletëvotimi vihet në vend përkatës dhe mandej nga kutia e votimit nxirret fletëvotim i ri.

Fletëvotimi i vlefshëm

Neni 115

- (1) Fletëvotimi është i vlefshëm nëse është në përputhje me nenin 110 të këtij Kodi.

(2) Për fletëvotim të vlefshëm konsiderohet edhe ai fletëvotim nga i cili në mënyrë të sigurt dhe pa mëdyshje mund të konstatohet se për cilën listë të kandidatit përkatësisht listë të kandidatëve ka votuar zgjedhësi.

(3) Fletëvotimi është i pavlefshëm nëse nuk është i mbushur apo nëse janë rrethuar më shumë lista të kandidatëve apo kandidat.

(1) Procesverbali për votim

Neni 116

(1) Këshilli i zgjedhjeve në procesverbalin për votim i regjistron të dhënat si vijojnë: numrin rendor të vendit zgjedhor; numrin e aktvendimit për formimin e këshillit të zgjedhjeve; kohën e fillimit dhe përfundimit të votimit; numrin e përgjithshëm të zgjedhësve në vendin zgjedhor sipas ekstraktit nga Lista e zgjedhjeve; numrin e përgjithshëm të zgjedhësve të cilët kanë votuar; numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të hedhura në kutinë e zgjedhjeve; numri i përgjithshëm i personave të sëmure dhe të pafuqishëm që kanë votuar, numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve që nuk janë përdorur dhe numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të pavlefshme dhe numrin e përgjithshëm të votave të cilat i ka marrë çdo listë e kandidatëve veç e veç.

(2) Procesverbali ka një pjesë të veçantë tabelore në të cilën mblidhen dhe verifikohen rezultatet e vendvotimit.

(3) Në procesverbal regjistrohen edhe vërejtjet eventuale të bëra nga anëtarët e këshillit të zgjedhjeve.

Neni 117

(1) Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e këshillit të zgjedhjeve.

(2) Procesverbali është i vlefshëm nëse është i nënshkruar nga shumica e anëtarëve të këshillit të zgjedhjeve nënshkrimet e të cilëve janë të deponuara.

(3) Kryetari i këshillit të zgjedhjeve duhet t'i shënojë shkaqet për mosnënshkrimin e procesverbalit nga ndonjë anëtar i këshillit.

(4) Nëse procesverbali nuk është i nënshkruar nga shumica e anëtarëve të këshillit të zgjedhjeve, procesverbalin e përpilon dhe e nënshkruan Komisioni komunal i zgjedhjeve përkatësisht Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit, në bazë të materialit të përgjithshëm zgjedhor.

(5) Kryetari i këshillit të zgjedhjeve e ka për detyrë që përfaqësuesve të pranishëm të paraqitësve të listave, nëse kanë vërejtje t'u mundësojë që të evidentohen në procesverbal dhe ato të jenë bazë në procedurën për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes.

(6) Nëse vërejtjet e përfaqësuesve të paraqitësve të listave nga paragrafi (5) i këtij neni, nuk janë evidentuar në procesverbal, ato kanë të drejtë t'i parashtrajnë pranë Komisionit komunal të zgjedhjeve përkatësisht Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit brenda pesë orësh nga përpilimi i procesverbalit dhe këto vërejtje mund të jenë bazë për kundërshtim.

“(7) Nëse procesverbali nga votimi në PDK, përkatësisht zyrat konsullore nuk është nënshkruar nga shumica e anëtarëve të këshillit zgjedhor procesverbalin e përpilon dhe nënshkruan komisioni shtetëror i zgjedhjeve në bazë të materialit të përgjithshëm zgjedhor.”

(8) Mbikëqyrësit akreditiv nëse kanë vërejtje, kanë të drejtë që t'i evidentojnë në ditarin e vendit zgjedhor.

Dorëzimi i materialit zgjedhor pranë Komisionit komunal të zgjedhjeve

Neni 118

(1) Procesverbalet dhe materialin tjetër zgjedhor, këshilli i zgjedhjeve e dorëzon pranë Komisionit komunal të zgjedhjeve përkatësisht Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit, brenda pesë orësh pas përfundimit të votimit.

(2) Një ekzemplar nga procesverbalet të bëra kopje me letër kopjative i jepet ç'do përfaqësuesi të parashtruesit të listës dhe mbikëqyrësve akreditiv, kurse mbikëqyrësve të autorizuar vendor një ekzemplar nga pjesa tabelore e procesverbalit. Ekzemplari origjinal i cili paraprakisht e ka vulën e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve i dërgohet Komisionit komunal të zgjedhjeve përkatësisht Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit .

(3) Këshilli i zgjedhjeve menjëherë pas përfundimit të procedimeve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, i shpall dhe kumton rezultatet nga votimi i kryer në atë vendvotim.

(4) Materialin zgjedhor deri te Komisioni komunal i zgjedhjeve përkatësisht Komisioni zgjedhor i Qytetit të Shkupit e dorëzon kryetari i këshillit të zgjedhjeve i shoqëruar me anëtarët e interesuar të këshillit të zgjedhjeve apo me përfaqësuesit e paraqitësve të listave dhe me përfaqësues të policisë nëse për këtë ka nevojë.

(5) Për dorëzimin e materialit nga paragrafi (1) i këtij neni, përpilohet procesverbal i veçantë.

Neni 118-a

(1) Procesverbalet dhe materialin tjetër zgjedhor nga votimi në PDK **përkatësisht zyra konsullore**, këshilli zgjedhor ia dorëzon personit kompetent nga PDK **përkatësisht zyra konsullore** të cilin e përcakton Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtutjeshëm: personi kompetent nga PDK **përkatësisht zyra konsullore** në afat prej pesë orëve pas mbarimit të votimit. Për këtë dorëzim përbëhet procesverbal i veçantë.

(2) Ekzemplarë nga procesverbalet e votimit në PDK **përkatësisht zyra konsullore** të bëra si kopje në letër kopjative pranon secili përfaqësues i parashtruesit të listës dhe mbikëqyrësit e akredituar. Ekzemplari origjinal që paraprakisht e ka vulën e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dërgohet te personi kompetent i PDK.

(3) Personi kompetent i PDK është i obliguar që procesverbalin e votimit në MDK, materialin e përgjithshëm zgjedhor nga votimi në PDK **përkatësisht zyra konsullore** dhe një ekzemplarë nga procesverbali i veçantë nga paragrafi (1) i këtij neni, menjëherë me postë diplomatike t'i dërgon deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

13. Mbledhja dhe verifikimi i rezultateve nga votimi për zgjedhjen e kryetarit të Republikës

Neni 119

(1) Komisioni komunal i zgjedhjeve brenda pesë orësh nga pranimi i materialit të përgjithshëm zgjedhor nga këshillat e zgjedhjeve i mbledh rezultatet e votimit për listën e kandidatëve nga vendet zgjedhore për të cilat është kompetente dhe i dorëzon pranë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

(2) Për punën e vetë Komisioni zgjedhor komunal përbën procesverbal.

(3) Në procesverbalin për votim futen të dhëna për përmbledhjen e votave nga votimi, numri rendor i vendvotimeve në njësinë zgjedhore për të cilën është kompetente, numri i përgjithshëm i zgjedhësve për ato vendvotime të regjistruara në certifikatat e Listës zgjedhore, numri i përgjithshëm i zgjedhësve që kanë votuar, numri i përgjithshëm i personave të sëmurë dhe të pafuqishëm që kanë votuar, numri i përgjithshëm i listave të pavlefshme të votimit dhe numri i përgjithshëm i votave që i ka marrë secila listë e kandidatëve nga vendvotimet për të cilat është obliguese ai Komision zgjedhor komunal.

(4) Në procesverbal janë futur edhe vërejtjet e dhëna nga anëtarët e Komisionit zgjedhor komunal.

Neni 119-a

(1) Procesverbali nga neni 119 i këtij kodi e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e Komisionit zgjedhor komunal.

(2) Procesverbali është i vlefshëm nëse është nënshkruar nga shumica e anëtarëve të Komisionit zgjedhor

komunal.

- (3) Kryetari i Komisionit zgjedhor komunal është i obliguar që t'i shënojë arsyet që të mos nënshkruhet procesverbali nga anëtari i komisionit.
- (4) Kryetari i Komisionit zgjedhor komunal është i obliguar që përfaqësuesve të pranishëm të parashtruesve të listave nëse kanë vërejtje, t'u mundësohet të evidentohen në procesverbal dhe ato të janë në bazë të procedurës për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.
- (5) Ekzemplarë nga procesverbali fiton edhe çdo përfaqësues i parashtruesit të listës dhe mbikëqyrësit të akredituar.

Rrethi i parë

Neni 120

Për President të Republikës zgjidhet kandidati i cili e ka marrë shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Listën e zgjedhësve.

Rrethi i dytë

Neni 121

(1) Nëse në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët për kryetar të Republikës nuk e ka marrë shumicën e nevojshme të votave, në rrethin e dytë do të votohet për dy kandidatë të cilët në rrethin e parë kanë marrë shumicën e votave.

(2) Rrethi i dytë brenda 14 ditësh, nga përfundimi i rrethit të parë të votimit.

(3) Për Kryetar është zgjedhur kandidati që ka marrë shumicën e votave nga zgjedhësit që kanë votuar, në qoftë se kanë votuar më shumë se 40% e zgjedhësve.

Përsëritja e votimit

Neni 122

(1) Në qoftë se edhe në balotazh asnjëri nga kandidatët nuk e ka marrë shumicën e nevojshme të votave, do të përsëritet e tërë procedura e votimit.

(2) Në qoftë se për President të Republikës është propozuar një kandidat, ndërkaq në rrethin e parë të votimit nuk e ka marrë numrin e nevojshëm të votave, do të përsëritet e tërë procedura e votimit.

Deklarata

Neni 123

(1) Para se ta marrë detyrën, më së voni brenda 10 ditësh nga dita e shpalljes së rezultateve përfundimtare, por jo para ditës së pushimit të mandatit të Presidentit paraprak, Presidenti i Republikës jep dhe nënshkruan deklaratë solemne para Kuvendit, si vijon:

"Deklaroj se funksionin Kryetar i Republikës së Maqedonisë do ta ushtroj me ndërgjegje dhe përgjegjësi, do ta respektoj Kushtetutën dhe ligjet dhe do ta mbroj sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë e Republikës së Maqedonisë".

(2) Deklaratën nga paragrafi (1) të këtij neni, Kryetari i Republikës së Maqedonisë i zgjedhur në bazë të zgjedhjeve presidenciale për shkak të pushimit të mandatit, e jep brenda tre ditësh nga dita e shpalljes të rezultateve përfundimtare.

14. Mbledhja dhe verifikimi i rezultateve të votimit për zgjedhje të deputetëve

Neni 124

Komisioni komunal i zgjedhjeve brenda pesë orësh nga pranimitë e materialit të përgjithshëm zgjedhor nga këshillat e zgjedhjeve për të cilat është kompetent i mbledh rezultatet e votimit për listat e kandidatëve nga vendvotimet e njësisë përkatëse të zgjedhjeve.

Procesverbal për votimin

Neni 125

(1) Për punën e vet Komisioni komunal i zgjedhjeve përpilon procesverbal.

(2) Në procesverbalin për votim, evidentohen të dhëna për votat e mbledhura nga votimi edhe atë numri rendor i vendeve zgjedhore në njësinë e zgjedhjeve për të cilën është kompetente, numri i përgjithshëm i zgjedhësve për ato vende zgjedhore të regjistruar në ekstraktin e Listës së zgjedhjeve, numri i përgjithshëm i zgjedhësve të cilët kanë votuar, numri i përgjithshëm i personave të sëmurë dhe të pafuqishëm që kanë votuar, numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pavlefshme dhe numri i përgjithshëm i votave të cilat i ka marrë çdo listë e kandidatëve në nivelin e njësisë zgjedhore nga vendet zgjedhore për të cilat ky Komision komunal i zgjedhjeve është kompetent.

Neni 126

(1) Procesverbalin nga neni 125 të këtij Kodi, e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e Komisionit komunal të zgjedhjeve.

(2) Procesverbali është i vlefshëm nëse është i nënshkruar nga shumica e anëtarëve të Komisionit komunal të zgjedhjeve.

(3) Kryetari i Komisionit komunal të zgjedhjeve duhet t'i shënon shkaqet për mosnënshkrimin e procesverbalit nga ndonjë anëtar i komisionit.

(4) Nëse përfaqësuesit e pranishëm të parashtruesve të listave kanë vërejtje, kryetari i Komisionit komunal të zgjedhjeve e ka për detyrë që përfaqësuesve të pranishëm të parashtruesve të listave nëse kanë vërejtje, t'u mundësojë që vërejtjet të evidentohen në procesverbal dhe ato të jenë bazë në procedurën për mbrojtjen e së drejtës zgjedhore.

(5) Një ekzemplar nga procesverbali i jepet ç'do përfaqësuesi të parashtruesit të listës dhe mbikëqyrësve të akredituar.

15. Verifikimi i rezultateve dhe sistemimi i mandateve për zgjedhje të deputetëve

Neni 127

(1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i mbledh dhe i verifikon rezultatet e përgjithshme nga votimi në njësitë zgjedhore.

(2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, rezultatet e votimit i verifikon në bazë të procesverbaleve me rezultatet e mbledhura nga Komisioni kompetent komunal i zgjedhjeve dhe nga materiali i përgjithshëm i zgjedhjeve.

(3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, rezultatet i verifikon veç e veç për çdo njësi zgjedhore, sipas numrit të votave të përgjithshme të cilat i kanë marrë listat e kandidatëve veç e veç në bazë të rezultateve të mbledhura nga Komisioni komunal i zgjedhjeve për vendet zgjedhore në njësinë zgjedhore për të cilën është kompetente.

(4) Verifikimi i rezultateve të zgjedhjeve bëhet me zbatimin e formulës së D'Hondit.

(5) Pas përcaktimit të numrit të përgjithshëm të votave të dhëna për atë numër të kandidatëve në njësinë zgjedhore (e ashtuquajtura masë zgjedhore), secila listë veç e veç përpjesëtohet me vargun e pjesëtuesve 1, 2, 3, 4 etj. dhe kështu derisa nuk sistemohen sipas principit të përcaktuar të gjitha vendet për deputetë në njësinë e zgjedhjeve.

(6) Herësit nga përpjesëtimi i paragrafit (5) të këtij neni, radhiten sipas madhësisë me ç'rast relevant janë aq herës më të mëdhenj sa deputetë zgjidhen në njësinë e zgjedhjeve.

(7)Lista e kandidatëve e merr atë numër të vendeve të deputetëve sa është edhe numri i herësve më të mëdhenj nga numri i herësve të paragrafit (6) të këtij neni.

(8) Nëse gjatë përcaktimit të vendit të fundit për deputet paraqiten dy herës identik, mandati do të përcaktohet me short.

(9)Gjatë sistemimit të vendeve për deputetë si të zgjedhur konsiderohen aq kandidatë sa vende ka marrë lista.

(10) Nga lista e kandidatëve janë zgjedhur kandidatët e shënuar në listë sipas radhës së caktuar.

Neni 127-a

(1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i përmbledh dhe i konfirmon rezultatet e plota të votimit në tre njësitë zgjedhore në Evropë dhe Afrikë, në Amerikën Veriore dhe Jugore dhe në Austarli dhe Azi.

(2) Për deputet është zgjedhur kandidati që ka fituar numër më të madh të votave nga votuesit që kanë votuar, por jo më pak se 2% nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në njësinë zgjedhore.

Neni 128

(1)Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për verifikimin e rezultateve të votimit në njësinë e zgjedhjeve përpilon procesverbale veç e veç për secilën njësi të zgjedhjeve.

(2) Në procesverbalin regjistrohen të dhënat e rezultateve të votimit, edhe atë:

- numri i përgjithshëm i vendeve zgjedhore;
- numri i përgjithshëm i zgjedhësve të evidentuar në ekstraktet e listave zgjedhore për njësinë zgjedhore;
- numri i përgjithshëm i personave të sëmurë dhe të pafuqishëm dhe
- numri i përgjithshëm i zgjedhësve që kanë votuar;
- numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pavlefshme;
- numri i përgjithshëm i votave që i ka marrë secila listë e kandidatëve veç e veç;
- numri i vendeve të fituara për deputetë nga lista e kandidatëve, dhe
- emri dhe mbiemri i kandidatëve të zgjedhur.

Neni 129

SHLYHET

16. Mbledhja, verifikimi i rezultateve të votimit për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit dhe sistemimi i mandateve

Neni 130

(1) Komisioni komunal i zgjedhjeve i përlogarit rezultatet e përgjithshme të votimit në komunë.

(2) Komisioni komunal i zgjedhjeve, rezultatet e votimit i përlogarit në bazë të procesverbaleve me rezultatet e mbledhura nga këshillat e zgjedhjeve dhe nga materiali i përgjithshëm i zgjedhjeve.

(3) Komisioni komunal i zgjedhjeve, rezultatet i verifikon sipas numrit të votave që i kanë marrë listat e kandidatëve për anëtarë të këshillit veç e veç mbi bazë të rezultateve të mbledhura nga këshillat zgjedhorë.

(4) Komisioni i zgjedhjeve i Qytetit të Shkupit rezultatet e votimit për anëtarë të Këshillit i verifikon sipas numrit të votave që i kanë marrë listat e kandidatëve për anëtarë të Këshillit veç e veç, mbi bazë të rezultateve të mbledhura të pranuar nga komisionet komunale të zgjedhjeve në rajonin e Qytetit të Shkupit.

(5) Verifikimi i rezultateve të zgjedhjeve bëhet me zbatimin e formulës së D'Hondtit.

(6)Pas verifikimit të numrit të përgjithshëm të votave të marra për secilën listë të kandidatëve (e

ashtuquajtura masë zgjedhore), secila listë veç e veç përpjesëtohet me vargun e pjesëtuesve 1, 2, 3, 4 etj. deri në numrin e anëtarëve të këshillit të cilët zgjidhen në komunën e Qytetit të Shkupit.

(7) Herësit e përpjesëtimit të paragrafit (6) të këtij neni, radhiten sipas madhësisë me ç'rast relevant janë aq herës më të mëdhenj sa zgjidhen anëtarë të këshillit.

(8) Lista e kandidatëve për anëtarë të këshillit fiton atë numër të vendeve të këshilltarëve sa ka herës më të mëdhenj nga numri i herësve të paragrafit (6) të këtij neni.

(9) Nëse gjatë përcaktimit të vendit të fundit për këshilltar paraqiten dy herës identik, mandati do të përcaktohet me short.

(10) Gjatë sistemimit të vendeve për këshilltarë, si të zgjedhur konsiderohen aq kandidatë sa vende ka marrë lista.

(11) Nga lista e kandidatëve për anëtarë të këshillit janë zgjedhur kandidatët e cekur në listen sipas radhës së përcaktuar.

Neni 131

(1) Komisioni komunal i zgjedhjeve për verifikimin e rezultateve të votimit përpilon procesverbal.

(2) Në procesverbal shënohen të dhënat për rezultatet e votimit, edhe atë:

- numri i përgjithshëm i vendeve zgjedhore në komunë dhe në Qytetin e Shkupit;

- numri i përgjithshëm i zgjedhësve të evidentuar në ekstraktet e Listës së zgjedhjeve për komunën dhe

Qytetin e Shkupit;

- numri i përgjithshëm i personave të sëmurë dhe të pafuqishëm që kanë votuar,

- numri i përgjithshëm i zgjedhësve që kanë votuar;

- numri i fletëvotimeve të pavlefshme;

- numri i përgjithshëm i votave që i ka marrë secila listë e kandidatëve veç e veç;

- numri i vendeve të fituara për këshilltarë nga lista e kandidatëve, dhe

- emri dhe mbiemri i kandidatëve të zgjedhur.

(3) Një ekzemplar nga procesverbali i jepet edhe secilit përfaqësues të parashtruesit të listës dhe mbikëqyrësit e akredituar.

17. Verifikimi i rezultateve për zgjedhje të kryetarit të komunës

Rrethi i parë

Neni 132

(1) Në rrethin e parë të votimit për kryetar të komunës zgjidhet ai kandidat, i cili ka marrë shumicën e votave të zgjedhësve që kanë votuar, në qoftë se në zgjedhjet kanë dalë një e treta e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve të evidentuar në ekstraktin e Listës së zgjedhjeve për komunën përkatëse.

“(2) Nëse në rrethin e parë nga votimi për zgjedhje të kryetarit të komunës, përkatësisht të kryetarit të Qytetit të Shkupit nuk dalin një e treta nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në ekstraktin nga Lista zgjedhore për komunën përkatëse, përkatësisht Qytetin e Shkupit, përsëritet e tërë procedura zgjedhore për komunën përkatëse.”

(3) Komisioni i zgjedhjeve i Qytetit të Shkupit, rezultatet e votimit për kryetar të komunës i verifikon sipas numrit të votave që i kanë marrë listat e kandidatëve për kryetar të komunës veç e veç, mbi bazë të rezultateve të mblëdhura të pranura nga komisionet komunale të zgjedhjeve në rajonin e Qytetit të Shkupit.

(4) Në qoftë se për kryetar të komunës është propozuar një kandidat, ndërkaq në rrethin e parë të votimit nuk e ka marrë numrin e nevojshëm të votave nga paragrafi (1) i këtij neni, do të përsëritet e tërë procedura e votimit.

Rrethi i dytë

Neni 133

(1) Nëse në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët për kryetar të komunës nuk e ka marrë shumicën e nevojshme të votave në përputhje me nenin 132, paragrafi (1) të këtij Kodi, në rrethin e dytë do të votohet për dy kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë marrë më së shumti vota.

(2) Rrethi i dytë i votimit mbahet brenda 14 ditësh nga dita e përfundimit të rrethit të parë të votimit.

(3) Në rrethin e dytë të votimit, kryetar i komunës zgjidhet ai kandidat i cili ka fituar shumicën e votave.

Emërimi i personit të besuar deri në zgjedhjet e reja

Neni 134

- (1) Nëse edhe pas rrethit të dytë, për çfarëdo shkaqesh nuk zgjidhet kryetari i komunës, komisioni i zgjedhjeve brenda 15 ditësh prej përfundimit të zgjedhjeve e njofton Qeverinë.
- (2) Pas pranimit të njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni, Qeveria brenda 15 ditësh do të emëroj person të besuar për ushtrimin e punëve që janë në kompetencë të kryetarit të komunës.
- (3) Qeveria, më së voni brenda 15 ditësh pas ditës së emërimit të personit të besuar, e njofton kryetarin e Kuvendit për shkak të shpalljes së zgjedhjeve për kryetar të komunës.

18. Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

Neni 135

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, rezultatet e para të zgjedhjeve të pranuar përmes rrugës elektronike i shpall në mënyrë suksesive, ndërsa rezultatet mbi bazë të të dhënave nga procesverbalet e Komisioneve komunale të zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda 12 orësh, pas përfundimit të zgjedhjeve.
- (2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve i shpall menjëherë, dhe më vonë se 24 orë nga dita e përfundimit të tyre.

Komisioni komunal i zgjedhjeve

Neni 136

(1) Komisioni komunal i zgjedhjeve rezultatet e para të zgjedhjeve për anëtarë të këshillit, përkatësisht për kryetar të komunës i shpall brenda 7 orësh pas përfundimit të zgjedhjeve, mbi bazë të të dhënave nga këshillat e zgjedhjeve dhe i publikon në tabelën e shpalljeve në komunë dhe ua kumton mjeteve të informimit publik.

(2) Komisioni i zgjedhjeve i Qytetit të Shkupit, rezultatet e para të zgjedhjeve për anëtarë të këshillit, përkatësisht për kryetar i shpall brenda 10 orësh pas përfundimit të zgjedhjeve, mbi bazë të të dhënave të komisioneve komunale të zgjedhjeve për Qytetin e Shkupit dhe i publikon në tabelën e shpalljeve në Qytetin e Shkupit dhe ua kumton mjeteve të informimit publik.

(3) Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për anëtarë të këshillit dhe për kryetar, komisionet komunale të zgjedhjeve përkatësisht Komisioni i zgjedhjeve i Qytetit të Shkupit i shpallin më së voni brenda 24 orësh nga përfundimi definitiv i zgjedhjeve.

19. Zgjedhjet për Kryetar të Republikës për shkak të pushimit të mandatit

Shpallja e zgjedhjeve

Neni 137

- (1) Kur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë do të nxjerrë akt me të cilin do ta verifikojë krijimin e kushteve për pushimin e funksionit Kryetar i Republikës së Maqedonisë në përputhje me nenin 81 paragrafi 8 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, në afat prej 24 orësh ia dërgon kryetarit të Kuvendit dhe do ta shpallë në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

- (2) Kryetari i Kuvendit, në afat prej 48 orësh nga shpallja e aktit nga paragrafi (1) i këtij neni, nxjerr akt për shpalljen e zgjedhjeve për zgjedhjen kryetarit të Republikës.

Procedura për grumbullimin e nënshkrimeve

Neni 138

Grumbullimi i nënshkrimeve në procedurën për kandidimin për kryetar të Republikës dhe shikimi publike në Listën e zgjedhjeve zbatohen para Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe fillojnë ditën e pestë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve për kryetar të Republikës për shkak të pushimit të mandatit dhe zgjasin 10 ditë.

Paraqitja e listës së kandidatit

Neni 139

- (1) Lista e kandidatëve për Kryetar të Republikës i paraqitet Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, me së voni ditën e gjashtëmbëdhjetë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.
- (2) Kandidati mund të heqë dorë nga kandidatura, më së voni në afat prej 17 ditësh nga dita e shpalljes së zgjedhjeve

Kompetenca e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve

Neni 140

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në afat prej 24 orësh pas pranimit të listave të kandidatëve për Kryetar, verifikon nëse ato janë paraqitur brenda afatit të paraparë me nenin 139 paragrafin (1) të këtij kodi.
- (2) Nëse Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni pas pranimit të listës konstaton se janë bërë lëshime të caktuara, përkatësisht parregullsi, do t'i thërrasë paraqitësit e listave që menjëherë, por më së voni në afat prej 24 orësh nga paraqitja e listës t'i mënjanojnë lëshimet ose parregullsitë e konstatuara.
- (3) Nëse Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni konstaton se listat janë paraqitur në afatin e paraparë dhe janë përpiluar në përputhje me këtë kod, përkatësisht lëshimet dhe parregullsitë e konstatuara paraqitësit e listave i kanë mënjeluar në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, listat e paraqitura do t'i konfirmojë me aktvendim në afat prej 24 orësh nga pranimi i listave, përkatësisht mënjanimi i lëshimeve ose parregullsive.

Neni 141

- (1) Nëse Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se listat nuk janë paraqitur me kohë, përkatësisht nëselëshimet dhe parregullsitë e konstatuara paraqitësit e listave nuk i kanë mënjeluar në afatin e paraparë në nenin 140 paragrafi (2) të këtij kodi, Komisioni listën e paraqitur në afat prej 24 orësh do ta hedhë poshtë me aktvendim.
- (2) Kundër aktvendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve mund të paraqitet padi në Gjykatën Administrative në afat prej 24 orësh pas pranimit të aktvendimit.
- (3) Gjykata Administrative është e obliguar të marrë vendim sipas padisë në afat prej 24 orësh pas pranimit të padisë.
- (4) Padia nga paragrafi (2) i këtij neni paraqitet nëpërmjet Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, kurse dërgimi i padisë me postë nuk lejohet.

Shpallja e listave

Neni 142

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve listat e verifikuara do t'i shpallë në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" më së voni në ditën e njëzetënjëtë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.

Fushata e zgjedhjeve

Neni 143

Fushata e zgjedhjeve fillon në ditën e njëzetë e dytë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 144 Shlyhet

Neni 145 Shlyhet

Neni 146

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve një ekzemplar të aktvendimit për përcaktimin e numrit dhe përshkrimin e secilit vend zgjedhor do t'ia dërgojë komisionit komunal të zgjedhjeve më së voni dhjetë ditë para ditës së përcaktuar për zgjedhje.
- (2) Komisioni komunal i zgjedhjeve më së voni pesë ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve në vend të dukshëm do t'i shpallë përshkrimet e vendeve zgjedhore, të cilat janë përcaktuar për votim me shënim se prej cilit rajon zgjedhësit do të votojnë në vendin e caktuar zgjedhor.

VIII. MBROJTJA E SË DREJTËS ZGJEDHORE

Neni 147

- (1) Procedura për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore është urgjente.
- (2) Shkresat (kundërshtimet dhe ankesat) për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore u dërgohen organeve kompetente nëpërmjet organeve të cilat paraprakisht kanë vendosur.
- (3) kundërshtimet dorëzohen në format të shkruar dhe përmbajnë:
 - vend, kohë, përshkrimin cenimit të bërë, kryersin dhe provat në të cilat thirret parashtruesi;
 - emri, mbiemri dhe nënshkrimi i parashtruesit të kundërshtimit, përkatësisht të përfaqësuesit të autorizuar dhe
 - sandëku elektronik për pranim e dokumenteve.
- (4) Dërgimi i kundërshtimit dhe padisë me postë nuk lejohet.
- (5) Kundërshtimet mund të dorëzohen edhe në formularë të veçantë, të përshkruara nga ana e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, të publikuara në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë” dhe në internet faqen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (6) Dorëzimi i kundërshtimeve dhe ankesave për votim në njësitë zgjedhore në Evropë dhe Afrikë, Amerikën Veriore dhe Jugore dhe Australi dhe Azi nuk është i lejuar me postë, por kryhet nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar në Republikën e Maqedonisë.
- (7) Vendimet e Gjykatës Administrative janë të plotfuqishme dhe kundër tyre nuk mund të paraqitet padi ose lloj tjetër i mbrojtjes juridike.

1. Procedura për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore e paraqitësve të listave

Neni 148

- (1) Secili paraqitës i listës së kandidatëve në procedurën për votim, mbledhjen dhe verifikimin e rezultateve të votimit mund të paraqesë kundërshtim Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- (2) Kundërshtimi nga paragrafi (1) i këtij neni, paraqitet në afat prej 48 orësh pas përfundimit të votimeve, përkatësisht publikimit të rezultateve fillestare.
- (3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është i obliguar në afat prej 48 orësh pas pranimit të kundërshtimit të marrë vendim.
- (4) Vendimi nga paragrafi (3) i këtij neni dërgohen në sandëkun elektronik për pranim me shkrim dhe vendimi konsiderohet si e dorëzuar në afat prej pesë orëve nga dorëzimi në sandëkun elektronik.
- (5) Kundër vendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, komisionit komunal të zgjedhjeve dhe komisionit të qytetit të zgjedhjeve, mund të paraqitet padi pranë Gjykatës Administrative në afat prej 48 orësh pas pranimit të aktvendimit.
- (6) Padia pranë Gjykatës Administrative, paraqitësi e mbështet në bazën dhe në konstatimet e theksuara në kundërshtim sipas të cilit është marrë vendimi fuqiptotë.

2. Procedura për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore të zgjedhësve

Neni 149

- (1) Secili zgjedhës, të cilit i është cenuar e drejta zgjedhore në procedurën e zbatimit të votimit, mund të paraqesë kundërshtim pranë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në afat prej 24 orësh.
- (2) Secili zgjedhës të cilit i është konfirmuar e drejta zgjedhore në procedure për realizim të votimit jashtë vendit mund të dorëzon kundërshtim deri Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në afat prej 24 orësh me postë të shpejtë, ndërsa koha e dorëzimit të kundërshtimit konsiderohet nga koha e dorëzimit të dërgesës.
- (3) Organi i shkallës së parë është i detyruar që në afat prej 24 orësh pas pranimit të kundërshtimit të marrë vendim.
- (4) Kundër vendimit të organit të shkallës së parë, përkatësisht Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve mund të dorëzohet padi deri te Gjykata Administrative, në afat prej 24 orësh pas pranimit të aktvendimit.
- (5) Nëse vendimi nga paragrafi (2) i këtij neni i dedikohet veprimit të caktuar të këshillit zgjedhor, ndërsa procesi i votimit është në rrjedhim, zgjedhësit do t'i mundësohet realizimi i të drejtës zgjedhore.

3. Vendimi i Gjykatës Administrative

Neni 150

- (1) Gjykata Administrative sipas ankesave të neneve 148 dhe 149 të këtij kodi, vendos në këshill prej pesë gjyqtarësh të zgjedhur me short në seancën publike për të cilën i informon përfaqësuesit e autorizuar sipas të cilave ankesa vendoset.
- (2) Gjykata Administrative është e obliguar që të marrë vendim në afat prej 48 orësh pas pranimit të padisë.
- (3) Gjykata Administrative mund ta konfirmon ose ta ndryshojë vendimin.
- (4) Vendimet sipas kundërshtimit dhe padisë me vetë marrjen, shpallen në internet faqen e Gjykatës Administrative, Komisionit Shtetëror Zgjedhor, komisionit të qytetit të zgjedhjeve dhe të komisionit komunal të zgjedhjeve dhe në mënyrë tjetër përkatëse.

IX. PRISHJA DHE PËRSËRITJA E VOTIMIT

Neni 151

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve me obligim zyrtar, ose sipas kundërshtimit të dërguar, me aktvendim e zhvleftëson votimin në vendvotim në rastet vijuese, nëse:
 - këshilli zgjedhor nuk e zbaton votimin në mënyrën e përcaktuar me këtë kod,
 - është zbuluar fshehtësia e votimit,
 - votimi është ndërprerë më gjatë se 3 ore,
 - policia nuk i është përgjigjur kërkesës për intervenim nga ana e këshillit zgjedhor, kurse për këtë ka pasur nevojë dhe ka ndikuar në zbatimin e votimit në vendin zgjedhor,
 - numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit është më i madh se numri i zgjedhësve që kanë votuar, dhe
 - ndonjë person ose persona kanë votuar për persona të tjerë.
- (2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në rastet nga paragrafi (1) alinetë 1, 2, 5 dhe 6 të këtij neni, gjatë vendimit të kundërshtimeve nëse faktet në të cilat drejtohet në ato, janë futur në Procesverbal, është e obliguar që të kryen inspektim të materialit të plotë zgjedhor.
- (3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, i qytetit, gjegjësisht komisioni komunal i zgjedhjeve me aktvendim do ta përsërisë votimin në vendvotime në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni ku votimi është prishur vetëm nëse numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në ato vendvotime në nivel të njësisë zgjedhore, të qytetit, përkatësisht të komunës ndikon në rezultatet e përgjithshme.

- (4) Kundër aktvendimit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, në afat prej 24 orësh prej pranimit të aktvendimit, mund të paraqitet padi deri te Gjykata Administrative nëpërmjet Komisionit Shtetëror Zgjedhor.
- (5) Gjykata Administrative është e obliguar që të veprjë sipas padisë në afat prej 72 orësh pas pranimit të saj.
- (6) Votimi në vendvotimin i cili është prishur do të përsëritet pas 14 ditësh nga dita e votimit.

X. ZGJEDHJET E PËRSËRITURA

1. Pushimi i mandatit dhe zgjedhjet plotësuese për deputetë

Neni 152

- (1) Deputetët i pushon mandati para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur, nëse:
 - paraqet dorëheqje,
 - është dënuar për vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesëvjetësh,
 - ndodh rasti i jokoherencës me funksionin deputetit,
 - në rast vdekjeje, dhe
 - me aktvendim të plotfuqishëm është privuar nga aftësia për punë.
- (2) Nëse deputeti paraqet dorëheqje, Kuvendi në seancën e parë të ardhshme konstaton se deputetët i pushon mandati prej ditës së mbajtjes së asaj seance.
- (3) Mandati deputetët i pushon në ditën e krijimit të kushteve nga paragrafi (1), alinetë 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni, kurse Kuvendi këtë e konstaton në seancën e parë të ardhshme.

Neni 153

- (1) Nëse deputetët i cili është zgjedhur nga lista e kandidatëve i pushon mandati sipas njërës nga bazat e përcaktuara në nenin 152 të këtij kodi, atëherë për mandatin e mbetur, deputetët i Kuvendit bëhet kandidati vijues në listë.
- (2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve e lajmëron kandidatin vijues nga lista në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, në afat prej tri ditësh nga pushimi i mandatit të deputetët.
- (3) Nëse kandidati vijues prej listës nga paragrafi (2) i këtij neni nuk e lajmëron Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve në afat prej tetë ditësh për pranimin e mandatit, kjo e drejtë i bartet kandidatin vijues të listës.
- (4) Në rastin kur është shterur lista e kandidatëve në përputhje me paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, realizimi i kësaj të drejte fillon përsëri nga fillimi i listës së kandidatëve, në qoftë se në listë ka kandidatë.

“Neni 153-a

(1) Me përjashtim nga neni 153 i këtij kodi, nëse është femër deputetët i cili është zgjedhur nga lista e kandidatëve, e të cilit i është ndërprerë mandati sipas njërës nga bazat e përcaktuara në nenin 152 të këtij kodi, atëherë për pjesën e mbetur të mandatit, deputetët në Kuvend bëhet kandidati i ardhshëm nga lista femër.

(2) Komisioni shtetëror i zgjedhjeve e njofton kandidatin e ardhshëm femër nga lista në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, në afat prej tri ditësh nga ndërprerja e mandatit të deputetët.

(3) Nëse kandidati i ardhshëm femër nga lista nga paragrafi (2) i këtij neni nuk e njofton Komisionin shtetëror të zgjedhjeve në afat prej tetë ditësh për pranimin e mandatit, kjo e drejtë i

bartet kandidatit të ardhshëm femër nga lista.

(4) Në rast kur është shterur lista e kandidatëve në pajtim me paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, realizimi i kësaj të drejte bëhet në pajtim me nenin 153 të këtij kodi.”

Neni 154

- (1) Nëse në listën e kandidatëve nuk ka kandidatë dhe nëse janë shterur bazat për fitimin e mandatit të deputetit të përcaktuara në nenin 153 të këtij kodi, shpallen zgjedhje plotësuese për zgjedhjen e deputetëve në njësinë zgjedhore nga e cila është zgjedhur deputeti.
- (2) Nëse deputetit, i cili është zgjedhur nga lista e kandidatëve nga tre njësitë zgjedhore në Evropë dhe Azi dhe në Amerikën Jugore dhe në Australi dhe Azi i pushon mandati sipas njëres nga bazat e vërtetuara në nenin 152 të këtij kodi, përshkruhen zgjedhje plotësuese të deputetëve në njësinë zgjedhore në të cilin është zgjedhur deputeti.

2. Pushimi, marrja e mandatit dhe zgjedhjet plotësuese

Neni 155

- (1) Nëse anëtarit të këshillit i pushon ose i merret mandati për shkak të njërit nga shkaqet e përcaktuar në Ligjin për vetëadministrimin lokal dhe këtë kod, atëherë anëtar i këshillit për pjesën e mbetur të mandatit bëhet kandidati vijues i listës.
- (2) Komisioni komunal i zgjedhjeve, përkatësisht Komisionin zgjedhor të Qytetit të Shkupit e lajmëron kandidatin vijues nga lista në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, në afat prej 3 ditësh pas pushimit të mandatit të këshilltarit.
- (3) Kandidati nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar që me shkrim ta lajmërojë komisionin komunal të zgjedhjeve përkatësisht Komisionin zgjedhor të Qytetit të Shkupit, nëse e pranon mandatin në afat prej 8 ditësh prej ditës së pranimit të lajmërimit nga paragrafi (2) i këtij neni.
- (4) Nëse kandidati, në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni nuk e pranon mandatin, kjo e drejtë i bartet kandidatit vijues të listës.

“Neni 155-a

(1) Me përjashtim nga neni 155 të këtij kodi, nëse është femër anëtari i këshillit të cilit i është ndërprerë ose i hiqet mandati për njërin prej shkaqeve të përcaktuara në Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe këtë kod, atëherë për pjesën e mbetur të mandatit, anëtar i këshillit bëhet kandidati i ardhshëm nga lista femër.

(2) Komisioni komunal i zgjedhjeve përkatësisht Komisioni i zgjedhjeve i Qytetit të Shkupit e njofton kandidatin e ardhshëm femër nga lista në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, në afat prej tri ditësh nga ndërprerja e mandatit të deputetit.

(3) Nëse kandidati i ardhshëm femër nga lista nga paragrafi (2) i këtij neni nuk e njofton Komisionin komunal të zgjedhjeve përkatësisht Komisionin e zgjedhjeve të Qytetit të Shkupit në afat prej tetë ditësh për pranimin e mandatit, kjo e drejtë i bartet kandidatit të ardhshëm femër nga lista.

(4) Në rast kur është shterur lista e kandidatëve në pajtim me paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, realizimi i kësaj të drejte bëhet në pajtim me nenin 155 të këtij kodi.

Neni 156

(1) Në rastet kur është shterur lista e kandidatëve në përputhje me nenin 155 të këtij kodi, realizimi i kësaj të drejte fillon përsëri nga fillimi i listës së kandidatëve, në qoftë se në listë ka kandidatë.

(2) Nëse në listën e kandidatëve nuk ka kandidatë dhe nëse janë shterur bazat për fitimin e mandatit të anëtarit të këshillit, zbatohen zgjedhje plotësuese për anëtar të këshillit në komunën, gjegjësisht në Qytetin e Shkupit.

(3) Zgjedhjet plotësuese i shpall kryetari i Kuvendit në afat prej 15 ditësh nga pushimi, përkatësisht nga marrja e mandatit.

3. Zgjedhjet për zëvendësimin e anëtarëve të këshillave

Neni 157

(1) Nëse me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor konstatohet se gjatë procedurës zgjedhore, parti politike, koalicion ose grup zgjedhësish si mjet për fitimin e votave kanë përdorur ryshfet dhe mjete nga vepra të kryera ndëshkuese, vendet (mandatet) që i kanë fituar paraqitësit e listave prishen nga ana e komisionit komunal të zgjedhjeve përkatësisht Komisionit zgjedhor të Qytetit të Shkupit dhe për këto vende zbatohen zgjedhje për zëvendësim.

(2) Zgjedhjet për zëvendësim nuk mund të shpallen gjashtë muaj para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur këshilli.

(3) Mandati i anëtarit të këshillit në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, përkatësisht të zgjedhurit në zgjedhjet për zëvendësim zgjat deri në skadimin e kohës për të cilën është zgjedhur anëtar i këshillit, të cilit i ka pushuar, përkatësisht i është marrë mandati.

(4) Zgjedhjet për zëvendësim i shpall kryetari i Kuvendit me propozimin e komisionit kompetent komunal të zgjedhjeve.

4. Zgjedhjet e parakohshme për kryetar të komunës dhe anëtarë të këshillave

Neni 158

(1) Nëse kryetarit të komunës i pushon mandati për shkak të njërit nga shkaqet e përcaktuar në Ligjin për vetëadministrim lokal dhe këtë kod dhe nëse kryetarit të komunës s i është votuar mosbesim në pajtim me këtë ligj, shpallen zgjedhje të parakohshme për kryetar komune.

(2) Zgjedhjet e parakohshme nga paragrafi (1) i këtij neni nuk do të shpallen nëse deri në zgjedhjet e rregullta për kryetar komune ka më pak se gjashtë muaj.

Neni 159

Zgjedhje të parakohshme për anëtarë të këshillit para skadimit të mandatit shpallen nëse paraqitet njëri nga kushtet e përcaktuara në Ligjin për vetëadministrim lokal dhe këtë kod.

5. Zgjedhjet e përsëritura për anëtarë të këshillave

Neni 160

Nëse seanca e këshillit nuk mbahet deri në ditën e tridhjetë e një nga dita e përfundimit të zgjedhjeve, në përputhje me nenin 37, paragrafët (2) dhe (3) të Ligjit për vetëadministrim lokal, mbahen zgjedhje të përsëritura për anëtarë të këshillit, të cilat i shpall kryetari i Kuvendit.

XI. MBIKËQYRJA E ZGJEDHJEVE

Neni 161

(1) Zgjedhjet dhe procedurën zgjedhore mund t'i mbikëqyrin:

- shoqatat e vendit dhe organizatat e huaja, të cilat janë regjistruar në pajtim me Kodin, së paku një vit

para ditës së mbajtjeve të zgjedhjeve, por në statutet e të cilëve janë futur parimet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut,

- organizata ndërkombëtare, dhe
- përfaqësues të vendeve të huaja.

(2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve e përcakton procedurën për kryerjen e misionit mbikëqyrës.

Neni 162

- (1) Organizatat dhe personat nga neni 161 i këtij kodi, mund të bëjnë mbikëqyrje të tërë procesit zgjedhor pas marrjes së autorizimit nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.
- (2) Kërkesat për mbikëqyrje me dokumentet e nevojshme për identifikim dërgohen pranë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve prej ditës së shpalljes së zgjedhjeve, e më së voni dhjetë ditë para ditës së votimit.
- (3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve u lëshon autorizime mbikëqyrësve më së voni shtatë ditë pas pranimit të kërkesës.
- (4) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka të drejtë t'ua marrë autorizimin për mbikëqyrje subjekteve nga neni 161 i këtij kodi, nëse fillojnë t'i shprehin përkrahje ndonjë kandidati, partie ose koalicioni.

Neni 162-a

Vetëm mbikëqyrësit e akredituar mund të informojnë gjatë procesit zgjedhor dhe aktivitetet e ndërlidhura me mbikëqyrjen e tij.

XII. VENDET ZGJEDHORE

Neni 163

Me vendvotim, sipas këtij kodi, kuptohet vendbanim ose pjesa e vendbanimit ku zgjedhësit e atij rajoni e realizojnë të drejtën e tyre zgjedhore.

1. Kriteret për përcaktimin e vendeve zgjedhore

Neni 164

- (1) Vendvotimet përcaktohen për vendbanime, ose për pjesët e vendbanimeve në të cilat ka zgjedhës të regjistruar në ekstraktet e listave zgjedhore për vendbanimet ose për pjesët e vendbanimeve.
- (2) Vendet zgjedhore përcaktohen në suazat e kufijve të komunës.
- (3) Në PDK **përkatësisht zyra konsullore** të Republikës së Maqedonisë për votim në jashtë vendit përcaktohen vende të veçanta për zgjedhje.

Neni 165

- (1) Numri i zgjedhësve që votojnë në vendvotime u përcaktuan në mënyrë me të cilën mundësohet që votimi të rrjedh pa ndërprerje në kohën e caktuar për votim.

“(2) Numri i zgjedhësve që votojnë në vendin zgjedhor nuk mund të jetë më i madh se 1 000 zgjedhës.”

- (3) Vendi zgjedhor nuk mund të përcaktohet për vendbanim në të cilin jetojnë më pak se dhjetë zgjedhës dhe në PDK **përkatësisht zyra konsullore** ku ka paraqitur më pak se dhjetë zgjedhës për votim.

Neni 166

- (1) Vendi zgjedhor sipas rregullit nuk guxon të jetë më larg se 3 km nga adresa më e largët në lagjet urbane dhe më shumë se 5 km në lagjet rurale

- (2) Rregulli i verifikuar në paragrafin (1) të këtij neni nuk zbatohet për vendet zgjedhore në PDK përkatësisht zyra konsullore.

2. Procedura për përcaktimin, ndërrimin dhe shpalljen e vendeve zgjedhore

Neni 167

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve më bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, punon me organin kompetent për punët në sferën e urbanizmit dhe të ndërtimitarisë, organin kompetent për punët e matjes dhe kadastrës dhe organizatën drejtuese kompetente për punët në sferën e statistikës e obliguar për përpunimin organizativo-teknik dhe metodologjik të të dhënave nga Lista zgjedhore, i përpunon përshkrimet profesionale-teknike të vendeve zgjedhore. Përshkrimi profesional-teknik i vendeve zgjedhore përmban: komunën, numrin e njësisë zgjedhore, numrin e vendit zgjedhor, vendbanimin dhe lokacionin e vendit zgjedhor (objektin dhe adresën e objektit në të cilin do të votohet, vendbanimin), nëse vendi zgjedhor është vendbanim i tërë, rrugën (emrin), indikatorin e shpërndarjes së numrit të shtëpisë (prej-deri).

Neni 168

- (1) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në bazë të përshkrimeve profesionale-teknike të vendeve zgjedhore të përpiluara në përputhje me nenin 167 të këtij kodi, merr aktvendim me të cilin e përcakton numrin dhe përshkrimin për çdo vend zgjedhor veç e veç, me shënimin e vendbanimeve, përkatësisht të rrugëve dhe numrave shtëpiakë të cilët hyjnë në vendet zgjedhore dhe objektin e votimit.

Neni 169

- (1) Ndryshimi i përshkrimit të vendit zgjedhor bëhet gjatë ndryshimit të emrave të rrugëve, përkatësisht të numrave shtëpiakë dhe në qoftë se rritet numri i zgjedhësve ose largësia hapësinore për vendin e caktuar zgjedhor.
- (2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve merr aktvendim me të cilin e përcakton ndryshimin e përshkrimit të vendit zgjedhor.
- (3) Ndryshimi i përshkrimeve të vendeve zgjedhore mund të bëhet më së voni 30 ditë para ditës së përcaktuar për zgjedhje, përkatësisht për votimin në referendum.

Neni 170

(1) Komisioni komunal i zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit më së voni 15 ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve, përkatësisht të votimit në referendum do t'i shpallë në vend të dukshëm përshkrimet e vendeve zgjedhore, të cilat janë përcaktuar për votim me shënim se nga cili rajon zgjedhësit do të votojnë në vend të caktuar zgjedhor.

(2) Shpallja e përshkrimeve të vendeve zgjedhore mund të bëhet edhe nëpërmjet mjeteve lokale për informim publik.

(3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve detyrimisht do të organizojë informimin e zgjedhësve me shpalljen e përshkrimeve të vendeve zgjedhore në shtyp dhe në mjetet tjera për informim publik.

3. Kushtet për funksionimin e vendeve zgjedhore

Neni 171

- (1) Çdo vendvotim ka numër rendor.
- (2) Numri rendor i vendvotimit vihet në objektin në të cilin bëhet votimi për atë vend zgjedhor, e nëse në një objekt bëhet votimi në dy ose më shumë vendvotime, numri rendor i vendvotimit shënohet edhe në çdo lokal që është përcaktuar për votim në atë vendvotim.

Neni 172

Lokali në të cilin bëhet votimi nuk guxon të përcaktohet në objekt në të cilin ka seli partia politike ose i cili shfrytëzohet për aktivitetet e partive politike.

Neni 173

- (1) Votimi bëhet në lokal të mbyllura, i cili i përmbush kushtet për realizimin e votimit personal, të lirë dhe të fshehtë të zgjedhësve.
- (2) Në lokalin në të cilin bëhet votimi, shënohen emrat e vendbanimeve dhe të pjesëve të vendbanimeve (rrugët dhe pjesët e rrugëve), të cilat i përfshin vendi zgjedhorë (përshkrimi).
- (3) Lokali i përcaktuar për votim është i pajisur me kabina, përkatësisht me paravane ose me perde ashtu që të mos mund të shihet se si e plotëson zgjedhësi fletëvotimin.
- (4) Çdo vendvotim doemos duhet të jetë i pajisur me laps kimik për nevojat e zgjedhësve gjatë votimit.
- (5) Në lokalin për votim vendosen kuti për votim të përpunuara nga materiali i fortë, të cilat këshillave zgjedhore u dorëzohen me procesverbal të vulosur.
- (6) Lokalet e përcaktuara për votim duhet doemos të jenë të rregulluara në mënyrë përkatëse profesionale-teknike për shkak të mbylljes dhe vulosjes së tyre me dyllë.

XIII. NJËSITË ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJEN E DEPUTETËVE NË KUVEND

Neni 174

- (1) Njësitë zgjedhore i përbëjnë (përfshijnë) vendvotimet në suazat e kufijve të komunave ku qytetarët e realizojnë të drejtën zgjedhore.
- (2) Njësitë zgjedhore për votim jashtë vendit i përbëjnë vendvotimet, gjegjësisht PDK **përkatësisht zyra konsullore** në kornizat e njësisë zgjedhore ku qytetarët e realizojnë të drejtën zgjedhore në pajtim me këtë Kod.

Neni 175

- (1) Në Republikën e Maqedonisë përcaktohen nëntë njësi zgjedhore:

NJËSIA ZGJEDHORE NUMËR 1
Komuna e Karposhit vendet zgjedhore 2592 deri 2653
Komuna e Karposhit vendet zgjedhore 2597/1 deri 2597/1,
Komuna e Karposhit vendet zgjedhore nga 2601/1 deri në 2601/1,
Komuna e Karposhit vendet zgjedhore nga 2614/1 deri në 2614/1,
Komuna e Karposhit vendet zgjedhore nga 2617/1 deri 2618/1,
Komuna e Karposhit vendet zgjedhore nga 2626/1 deri 2626/1,
Komuna e Karposhit vendet zgjedhore nga 2644/1 deri në 2644/1,
Komuna e Karposhit vendet zgjedhore nga 2649/1 deri në 2649/1,
Komuna e Karposhit vendet zgjedhore nga 2651/1 deri në 2653/1”;
“Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2425/1 deri në 2426/1,“

“Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2654 deri në 2672“
“Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2667/1 deri në 2667/1,
Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2669/1 deri në 2669/1,
Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2671/1 deri në 2671/1“;
“Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2739 deri në 2751“
Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2748/1 deri në 2748/1,
Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2751/1 deri në 2751/1“
Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2761 deri në 2771
“Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2762/1 deri në 2762/1“;
“Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2774 deri në 2795”
: “Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2781/1 deri në 2782/1,
Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2784/1 deri në 2784/1,
Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2789/1 deri në 2789/1,
“Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2793/1 deri në 2793/1,
Komuna e Kisella Vodës vendet zgjedhore nga 2795/1 deri në 2795/1“;
Çairit vendet zgjedhore nga 2819 deri në 2821
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2819/1 deri në 2819/1
: “Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2823 deri në 2827,,
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2826/1 deri në 2826/1
Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2829 deri në 2829“
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2829/1 deri në 2829/1“;
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2869 deri në 2869”
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2869/1 deri në 2869/1“;
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2872 deri në 2898“
Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2873/1 deri në 2874/1,
Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2876/1 deri në 2877/1,
Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2884/1 deri në 2884/1,
“Komuna e Aerodromit vendet zgjedhore 2673 deri në 2738“
“Komuna e Aerodromit vendet zgjedhore nga 2679/1 deri në 2680/1,
Komuna e Aerodromit vendet zgjedhore nga 2682/1 deri në 2684/1,

Komuna e Aerodromit vendet zgjedhore nga 2714/1 deri në 2717/1 ,
Komuna e Aerodromit vendet zgjedhore nga 2719/1 deri në 2721/1,
Komuna e Aerodromit vendet zgjedhore nga 2730/1 deri në 2730/1,
“ Komuna e Aerodromit vendet zgjedhore nga 2732/1 deri në 2733/”;
“Komuna e Aerodromit vendet zgjedhore nga 2772 deri në 2773
: “Komuna e Aerodromit vendet zgjedhore nga 2772/1 deri në 2772/1”;
“Komuna e Aerodromit vendet zgjedhore 2673 deri në 2738“
Komuna e Sarajit vendet zgjedhore nga 2428 deri në 2461”
“ Komuna e Sarajit vendet zgjedhore nga 2428/1 deri në 2428/1
Komuna e Sarajit vendet zgjedhore nga 2430/1 deri në 2431/1,
Komuna e Sarajit vendet zgjedhore nga 2433/1 deri në 2435/1,
Komuna e Sarajit vendet zgjedhore nga 2438/1 deri në 2438/1,
Komuna e Sarajit vendet zgjedhore nga 2447/1 deri në 2447/1,
Komuna e Sarajit vendet zgjedhore nga 2451/1 deri në 2452/1,
Komuna e Sarajit vendet zgjedhore 2458/1 deri në 2458/1
Komuna e Sarajit vendet zgjedhore nga 2460/1 deri në 2460/1;
“Komuna e Makedonski Brodit vendet zgjedhore nga 0224 deri në 0274”
”Komuna e Makedonski Brodit vendet zgjedhore nga 0247/1 deri në 0 248/1”;
“Komuna e Sopishtës vendet zgjedhore nga 2412 deri në 2424
“Komuna e Sopishtës vendet zgjedhore nga 2423/1 deri në 2423/1,;
“Komuna e Studeniçanit vendet zgjedhore 2341 deri në 2361
“Komuna e Studeniçanit vendet zgjedhore nga 2341 deri në 2361”
“Komuna e Studeniçanit vendet zgjedhore nga 2341/1 deri në 2341/1,
Komuna e Studeniçanit vendet zgjedhore nga 2345/1 deri në 2351/1,
Komuna e Studeniçanit vendet zgjedhore nga 2353/1 deri në 2353/1,

“NJËSIA ZGJEDHORE 2”

Komuna e Gazi Babës vendet zgjedhore nga 2332 deri në 2332
“Komuna e Gazi Babës vendet zgjedhore nga 2476 deri në 2552”
“Komuna e Gazi Babës vendet zgjedhore nga 2476/1 deri në 2476/1,
Komuna e Gazi Babës vendet zgjedhore nga 2493/1 deri në 2493/1,

Komuna e Gazi Babës vendet zgjedhore nga 2499/1 deri në 2499/1,
Komuna e Gazi Babës vendet zgjedhore nga 2503/1 nga 2503/1,
Komuna e Gazi Babë vendet zgjedhore nga 2507/1 deri në 2507/1,
Komuna e Gazi Babës vendet zgjedhore nga 2509/1 deri në 2511/1,
Komuna e Gazi Babës vendet zgjedhore nga 2514/1 deri në 2515/1,
Komuna e Gazi Babës vendet zgjedhore nga 2531/1 deri në 2531/1,
Komuna e Gazi Babës vendet zgjedhore nga 2538/1 deri në 2540/1“;
“Komuna e Gjorçe Petrovit vendet zgjedhore nga 2553 deri në 2591“
”Komuna e Gjorçe Petrovit vendet zgjedhore nga 2553/1 deri në 2554/1,
Komuna e Gjorçe Petrovit vendet zgjedhore nga 2560/1 deri në 2560/1,
Komuna e Gjorçe Petrovit vendet zgjedhore nga 2571/1 deri në 2572/1,
Komuna e Gjorçe Petrovit vendet zgjedhore nga 2574/1 deri në 2574/1,
Komuna e Gjorçe Petrovit vendet zgjedhore nga 2576/1 deri në 2576/1,
Komuna e Gjorçe Petrovit vendet zgjedhore nga 2579/1 deri në 2582/1,
Komuna e Gjorçe Petrovit vendet zgjedhore nga 2587/1 deri në 2588/1,
Komuna e Gjorçe Petrovit vendet zgjedhore nga 2590/1 deri në 2590/1”;
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2899 deri në 2903”
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2900/1 deri në 2900/1”;
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2916 deri në 2917“
Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2916/1 deri në 2917/1“;
”Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2922 deri në 2922
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2922/1 deri në 2922/1“;
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2934 deri në 2945“
“Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2934/1 deri në 2937/1,
”Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2939/1 deri në 2939/1,
Komuna e Çairit vendet zgjedhore nga 2941/1 deri në 2941/1”
“Komuna e Shuto Orizarës vendet zgjedhore nga 2955 deri në 2973“
“Komuna e Shuto Orizarës vendet zgjedhore nga 2955/1 deri në 2967/1,
”Komuna e Shuto Orizarës vendet zgjedhore nga 2969/1 deri në 2972/1
“Komuna e Butelit vendet zgjedhore nga 2904 deri në 2915“

“Komuna e Butelit vendet zgjedhore nga 2904/1 deri në 2905/1 ,
Komuna e Butelit vendet zgjedhore nga 2907/1 deri në 2907/1,
Komuna e Butelit vendet zgjedhore nga 2909/1 deri në 2909/1,
Komuna e Butelit vendet zgjedhore nga 2911/1 deri në 2911/1,
Komuna e Butelit vendet zgjedhore nga 2914/1 deri në 2915/1”;
“Komuna e Butelit vendet zgjedhore nga 2918 deri në 2921”
“Komuna e Butelit vendet zgjedhore nga 2918/1 deri në 2921/1
“Komuna e Butelit vendet zgjedhore nga 2946 deri në 2954”
“Komuna e Butelit vendet zgjedhore nga 2948/1 deri në 2948/1,
Komuna e Butelit vendet zgjedhore nga 2950/1 deri në 2951/1”;
“Komuna e Haraçinës vendet zgjedhore nga 2333 deri në 2340“
: “Komuna e Haraçinës vendet zgjedhore nga 2333/1 deri në 2337/1”;
“Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 0995 deri në 1104“
“Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 0995/1 deri në 0995/1,
”Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1000/1 deri në 1001/1,
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1006/1 deri në 1006/1,
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1008/1 deri në 1011/1,
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1013/1 deri në 1014/1,
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore 1017/1 deri në 1017/1,
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1020/1 deri në 1020/1,
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1026/1 deri në 1026/1,
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore 1040/1 deri në 1042/1,
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1047/1 deri në 1051/1,
]Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1055/1 deri në 1055/1,
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore 1057/1 deri në 1061/1, Komuna e Kumanovës
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1078/1 deri në 1080/1,
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1086/1 deri në 1087/1,
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1091/1 deri në 1091/1, Komuna e
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1101/1 deri në 1103/1“;
]“Komuna e Likovës vendet zgjedhore nga 1105 deri në 1130“

“Komuna e Likovës vendet zgjedhore nga 1111/1 deri në 1113/1,
Komuna e Likovës vendet zgjedhore nga 1119/1 deri në 1121/1,
Komuna e Likovës vendet zgjedhore nga 1125/1 deri në 1125/1,
Komuna e Likovës vendet zgjedhore nga 1128/1 deri në 1130/1.“
“Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 0995 deri në 1104“
“Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 0995/1 deri në 0995/1,
“Komuna e Staronagoriçani vendet zgjedhore nga 1156 deri më 1186
Komuna Çuçer-Sandevë vendet zgjedhore nga 2462 deri më 2475

NJËSIA ZGJEDHORE NUMËR 3

Komuna e Berovës vendet zgjedhore prej 0001 deri më 0016
Komuna e Velesit vendet zgjedhore nga 2135 deri në 2203“
Komuna e Velesit vendet zgjedhore nga 2138/1 deri në 2138/1,
Komuna e Velesit vendet zgjedhore nga 2143/1 deri në 2144/1,
Komuna e Velesit vendet zgjedhore nga 2146/1 deri në 2146/1,
Komuna e Velesit vendet zgjedhore nga 2153/1 deri në 2153/1,
Komuna e Velesit vendet zgjedhore nga 2159/1 deri në 2159/1,
Komuna e Velesit vendet zgjedhore nga 2170/1 deri në 2170/1
Komuna e Velesit vendet zgjedhore nga 2172/1 deri në 2173/1,
Komuna e Velesit vendet zgjedhore nga 2201/1 deri në 2201/1“
Komuna e Velesit vendet zgjedhore nga 2207 deri në 2210“
Komuna e Velesit vendet zgjedhore nga 2210/1 deri në 2210/1";
Komuna e Vinicës vendet zgjedhore prej 0303 deri në 0332"
Komuna e Vinicës vendet zgjedhore prej 0310/1 deri në 0311/1,
Komuna e Vinicës vendet zgjedhore prej 0315/1 deri në 0315/1";
Komuna e Dellçevës vendet zgjedhore prej 0572 deri në 0604"
Komuna e Dellçevës vendet zgjedhore prej 0577/1 deri në 0577/1,
Komuna e Dellçevës vendet zgjedhore prej 0582/1 deri në 0583/1
Komuna e Zelenikovës vendet zgjedhore nga 2362 deri më 2376
Komuna e Zërnovcit vendet zgjedhore nga 0888 der më 0891
Komuna e Ilindenit vendet zgjedhore prej 2393 deri në 2411
Komuna e Ilindenit vendet zgjedhore prej 2393/1 deri në 2397/1,

Komuna e Ilindenit vendet zgjedhore prej 2399/1 deri në 2399/1
Komuna e Karbincit vendet zgjedhore nga 2316 deri më 2331
Komuna e Koçanit vendet zgjedhore prej 0830 deri në 0874"
Komuna e Koçanit vendet zgjedhore prej 0834/1 deri në 0834/1,
Komuna una e Koçanit vendet zgjedhore prej 0836/1 deri në 0838/1,
Komuna e Koçanit vendet zgjedhore prej 0857/1 deri në 0857/1,
Komuna e Koçanit vendet zgjedhore nga 0892 deri më 0902
Komuna e Kratovës vendet zgjedhore nga 0903 deri më 0937
Komuna e Kratovës vendet zgjedhore prej 0903 deri në 0937"
Komuna e Kratovës vendet zgjedhore prej 0931/1 deri në 0932/1
Komuna e Kriva Pallankës vendet zgjedhore prej 0938 deri në 0981"
Komuna e Kriva Pallankës vendet zgjedhore prej 0945/1 deri në 0947/1
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1131 deri më 1141
Komuna e Kumanovës vendet zgjedhore nga 1144 deri më 1150
Komuna e Llozovës vendet zgjedhore nga 1704 deri më 1712
Komuna e Makedonska Kamenicës vendet zgjedhore prej deri në 0618
Komuna e Makedonska Kamenicës vendet zgjedhore prej 0610/1 deri në 0612/1
Komunauna e Petrovecit vendet zgjedhore prej 2377 deri në 2392"
Komuna e Petrovecit vendet zgjedhore prej 2377/1 deri në 2378/1,
Komuna e Petrovecit vendet zgjedhore prej 2382/1 deri në 2382/1
Komuna e Pehçevës vendet zgjedhore nga 0017 deri më 0025
Komuna e Probishtipit vendet zgjedhore prej 1530 deri në 1573
Komuna e Probishtipit vendet zgjedhore prej 1539/1 deri në 1539/1,
Komuna e Probishtipit vendet zgjedhore prej 1566/1 deri në 1566/1
Komuna e Rankovcit vendet zgjedhore nga 0982 deri më 0994
Komuna e Sveti Nikollës vendet zgjedhore prej 1671 deri në 1703
